Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 3 (155) / 2019. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Big market

Së shpejti në Peshkopi...

Me oferta dhe mijëra artikuj...

Profil

Nderimi i një artisti polivalent

Nga **HALIL RAMA**



8

Turizëm

Festat tradicionale, vlerë e shtuar e turizmit kulturor

Nga **FATBARDH CENA**



4

Profil

Filantropi Faik Bruçi

Nga **HEKURAN VLADI**



9

Rruga e Arbërit, dëshmitë historike nga Tirana në Bulqizë

Me hapjen e rrugës trashëgimnia historike e kulturore do të pësojë një ringjallje, duke i dhënë hov zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë

Me hapjen e rrugës trashëgimnia historike e kulturore do të pësojë një ringjallje, duke i dhënë hov zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë

Nga **AZIZ KETA - FAQE 6-7**



Mjedisi i pastër, një sfidë për një jetë të shëndetshme dhe zhvillim të qëndrueshem

Mbajtja e një mjedisi të pastër është përgjegjësi e përbashkët e qytetarëve dhe administratës publike. Njerëzit duhet të të ndërgjegjësohen se mbeturinat e hedhura anës lumenjve, nuk ndotin oborret e shtëpive të tyre, por shëndetin e fëmijëve pas pak vitesh. Ndaj një mjedis i pastër mbetet një sfidë jo vetëm për një jetë të shëndetshme, por edhe për për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të zonës së Dibrës.

FAQE 3

Intervistë



AGRON TUFA: Historia e letërsisë

sonë më mirë të mos shkruhet njëherë

Sepse është e sigurtë që do të manipulohet, cilidoqoftë kriteri, qasja, metoda. Përsëri do të thirreshin kumbarët e kumbareshat, xhaxhot e byrazerët, nunat e ndrikullat që i prekin thuajse të gjitha punët, duke i ndotur ato. Le të presim them dhe nja 20 a 30 vjet të tjera... dhe le t'i bëjnë këto detyra të tjerë njerëz, të shpëlarë nga zgjyra e shijes, koniukturat, hatëret e tarafet. Ne e kemi humbur besimin. Dhe akoma më keq: kemi humbur respektin për punën e tjetrit. Dallojmë veç të zezën tek përpjekja e tjetrit. E nëse nuk ka të zezë, e nxijmë vetë më zi se kukudhi. - LEXONI NË FAQEN 13-15

NË BRENDËSI: ■ **Ç'kemi** asaj Dibre ■ Si Dibra s'ka tjetër ■ **Guidë:** Turi i qytetit të Peshkopisë ■ Kundërshtimi i banorëve për HEC-et, "bllokon" Këshillin Bashkiak në Bulqizë ■ **Miranda Shehu - Xhilaga**, poetja me një "penel" të hollë ■ Duart e florinjta të **Ramazan Miftarit** ■ **Kontributi i Ali Maliqit** në Luftën Antifashiste ■ Kronikë e disa jetëve të humbura ■ "Një jetë maleve" ■ **Anekdoda**: me krejt nuk ban me u zanë ■ **Legjenda**: Plaka në bjeshkë ■ **Fjalë e frazeologjizma** të rralla ■ **Bashkimi shqiptar** në ritin e festimeve të Nevruzit ■ **Arsimi** në rrjedhën e viteve për qëndresë dhe përparim ■ Mallkimi i sheh **Murat Begut** ■ **Hafiz Xhemal Dibra**, intelektual, teolog dhe patriot i shquar ■ Si e kam njohur **Moisi Murrën**? ■ Një jetë që ua përkushtoi të sëmurëve ■ Elegji për një mik, Asllanin e Kambereve të Zimurit të Dibrës

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 3 (155). Mars 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Prill 2019.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Violeta MURATI
Hajri SHEHU
Nehat DACI
Sulejman MATO
Bashkim LLESHI
Astrit DACI
Besnik ALKU

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Ç’kemi asaj Dibre

Nga **BUJAR KAROSHI**

Enisëm marsin me protesta nxënësish. Na hoqën mësuesen e anglishtes më 7 mars dhe protestat mbushën mediat dhe portalet. Dhe rezultati i protestës ishte rikthim në punë paradite, pushim për së dyti pasdite. Por, 7 marsi iku dhe nuk kishte mv arsye për protestë. Sepse për aq na duhej, sa për lajm...

Protestat vazhdojmë t’i bëjmë. Diku për ujin, diku për pyllin, diku për prodhimet që s’po shiten... Si bëjmë edhe ne: rron njeriu edhe pa ujë, edhe pa pyje, edhe pa i shitur mollët e patatet. Se kështu thotë qeveria, përderisa nuk e vë “ujin në zjarr”... Pastaj duron njeriu derisa atë që Zoti e nxjerr nga nëntoka në male, njeriu ta fusë në tubacione për ca lekë, dhe pastaj populli ka të drejtë ta pijë ujin te burimi te hidrocentrali... Sepse uji që lëviz pihet në natyrë, ndërsa në shtëpi pihet nga bidoni...

Lëviz dhe uji i Drinit të Zi, por për të pirë pihet në burim. Se plehrat që hedhim nuk e filtrojnë rrugës. Janë plehrat tona, jo të qeverisë...

Dolën kandidatët për kryetar komune në Dibër të Madhe: Dy doktorë të nderuar të qytetit. Ata tani do të luftojnë, do të premtojnë e shpirtin do ta japin se si do ta “ndrisin” Dibrën. Sepse doktorët e ndritën qeverisjen në këtë anë, tani mbeten ta ndrisin edhe në anën tjetër...

Meqë jemi te mjekët, në Peshkopi i arrestuam dy pse “dhunuan” një mjek. Por se mjeku është pensionist, qejfli i rakisë dhe që nuk e kanë pranuar ca spitale të tjera në vend, nuk e bën lajm kush...

Me zjarret i kemi punët shumë mirë. Ia kemi nisur që për dit’vere dhe po vazhdojmë akoma... Qeveria, ngaqë nuk thotë dot se janë “njerëzit e opozitës”, thotë janë zjarrvënës dhe do të marrin dënimin e merituar... Nuk na lanë zjarrvënësit rehat: ca duan t’i vënë flakën qeverisë, ca pasurive tona. Por shtëpinë e vet asnjë zjarrvënës nuk e djeg...

Meqë jemi te pyjet, i mbani mend ato protestat në Bulqizë për mbrojtjen e tyre. Ata që ia kanë vënë syrin atyre, meqë nuk ia arritën ta merrnin dot prej protestave, tani po përpiqen ta marrin me “mjete ligjore”: ndërrim pronësie nga bashkia në qeveri, që kjo e fundit ta japë me PPP (Privatizim e Prerje të Pyjeve).

Meqë e nisëm me mësuesit, ta mbyllim me nxënësit: 11 prej tyre shkuan në spital ne Bulqizë për një sapun 15 lekësh. Kështu është kur mësuesi e ble diplomën, blen punën dhe pastaj blen edhe orët e mësimit... Dikur thuhej “mos e ha sapunin për djathë”, por tani mësuesi e ha “sapunin për plastelinë”, sepse ka bërë një barrë shkollë me meritë...



Pylli në Sheshe Bulqizë
Foto: S. Curri

Kundërshtimi i banorëve për HEC-et, “bllokon” Këshillin Bashkiak në Bulqizë

Nga: **SAMI CURRI**

Kundërshtimi i banorëve të Fushë-Bulqizës për të lejuar nxjerrjen e një pjese të pyllit të kësaj zone nga fondi pyjor i Bashkisë Bulqizë për t’i hapur rrugë projekteve për HEC-e, çoi në dështimin për të tretën herë të mbledhjes së Këshillit Bashkiak ku do shqyrtohej kjo çështje.

Kundërshtimi dhe protesta e banorëve të Fushë-Bulqizës për të lejuar nxjerrjen e një pjese të pyllit të kësaj zone nga fondi pyjor i Bashkisë Bulqizë për t’i hapur rrugë projekteve për HEC-e, çoi në dështimin për të tretën herë të mbledhjes së Këshillit Bashkiak ku do shqyrtohej ky çështje.

Bashkia Bulqizë i kërkoi Këshillit Bashkiak në një projekt-vendim të disa ditëve më parë të miratojë heqjen nga fondi i saj pyjorë e kullosor i disa pyjeve në zonën e Fushë Bulqizës, por mbledhja e Këshillit Bashkiak dështoi të martën, ndërsa një pjesë e mirë e këshilltarëve nuk u paraqitën dhe të tjerë u shprehën kundër vendimit.

Gazmend Kenga, kryetar i Këshillit Bashkiak Bulqizë i tha BIRN se këshilli kishte refuzuar të shprehej pa dëgjuar banorët e zonës. “Transferimi i pronësisë së këtij fondi pyjor dhe kullosor nga pronë e Bashkisë Bulqizë në pronë të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, ka dështuar për të tretën herë sepse ne kemi refuzuar që të shprehemi për këtë çështje pa marrë më parë mendimin e banorëve të zonës”, tha Kenga.

Nga 22 anëtarë të Këshillit Bashkiak vetëm 8 ishin të pranishëm në seancë, ndërsa për korumin duhen të paktën 11 këshilltarë.

Por salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Bulqizë ishte mbushur me banorë të fshatrave që e kundërshtojnë vendimin e Bashkisë Bulqizë, i cili sipas tyre i hap rrugë ndërtimit të HEC-ve në këtë zonë. BIRN mësoi se në zonë ishin projektuar 3 HEC-e, që kundërshtohen paraprakisht nga banorët. Këta të fundit shpresojnë se duke ndaluar heqjen e fondit pyjor nga bashkia, do të bllokojnë edhe ndërtimin e HEC-ve në zonë.

Banorët të cilët kundërshtuan për 4 vjet me rradhë dhënien e pyjeve të zonës me koncesion për shfrytëzim dhe ia dolën mes protestave të merrnin një premtim nga ministri i Mjedisit Blendi Klosi për pezullim të koncesionit, ishin të inatosur me përpjekjen e re për të miratuar HEC në zonë, projekt që po ashtu cënon pyjet për të cilat ata protestuan dhe morën mbështetje se nuk do të prekeshin.

Një prej banorëve Bajram Disha u shpreh gjatë fjalës në mbledhjen e Këshillit Bashkiak se kjo është “prerje në besë” për së dyti herë që i bëhet kësaj zone. “Kemi vujtur shumë me pyjet, tani po doni me ja nis me ujin. Ndaluni sa jeni në kohë. Pyjet dhe uji janë jeta jonë. Nuk do ju lejojmë që ta merrni.”, u shpreh Disha.

Disha ishte një ndër organizatorët e protestave kundër dhënies me koncesion për shfrytëzim të pyjeve në zonën e tij dhe në korrik të vitit që shkoi u shoqërua nga policia në atë që ai e cilësoi përpjekje për t’i bërë presion.

Kreu i Bashkisë Bulqizë Melaim Damzi, i kontaktuar me telefon nga BIRN për këtë çështje refuzoi të fliste. Ndërkohë anëtarë të këshillit të të tre forcave politike shprehën rezerva për vendimin. Kreu i Këshillit Kenga, ndërsa nuk u shpreh kundër kërkoi më shumë informacion. Ai tha se vetëm 8 këshilltarë ishin paraqitur në mbledhjen e rradhës, ndërsa tha se kjo çështje nuk do jetë më në rend dite pa pasur informacion të plotë dhe mendimin e banorëve të zonës.

“Ne do presim një relacion të plotë të kësaj çështje nga Bashkia Bulqizë dhe kompania që kërkon të investojë. Gjithashtu edhe një mendim nga banorët e zonës. Pa marrë një relacion të plotë dhe të detajuar nuk do të futet më në rendin e çështjeve që do të trajtohen nga Këshilli Bashkiak”, tha ai.

Nga ana tjetër ai nuk u shpreh kundër projektit apriori, ndërsa i tha BIRN se çështja ishte shumë sensitive dhe nëse Këshillit Bashkiak do votonte kundër kjo do pengonte procedurat e marrjes së lejes nga kompania për ndërtimin e HEC.

Halil Jakimi, anëtarë i Këshillit Bashkiak nga radhët e Partisë Demokratike u shpreh në një bisedë telefonike për BIRN se ai nuk do të votojë asnjë propozim që bie ndesh me vullnetin e banorëve të zonës, që e kanë treguar edhe më parë ndjeshmërinë ndaj natyrës. “Pa dakordësinë e banorëve, të kryepleqve të fshatrave dhe pushtetit vendor nga ana ime nuk do të ketë votë pro transferimit të pronësisë që i hap rrugë ndërtimit të HEC-ve”, deklaroi për BIRN Jakimi.

Po ashtu Veap Halili, anëtarë i Këshillit Bashkiak nga radhët e Lëvizjes Socialiste për Integrim po ashtu tha se nuk do të miratonte vendimin. “Do jemi kundër vendimit për transferimin e pronësisë. Ashtu siç bashkë me këshilltarët e tjerë e kundërshtuam edhe në mbledhjen e parë një vendim të tillë për transferimin e pronësisë nga Bashkia Bulqizë tek Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, pa marrë më parë një mendim të banorëve të zonës”, u shpreh Halili për BIRN.

Shkrimi është marrë nga reporter.al.

aktualitet

Mbajtja e një mjedisi të pastër është përgjegjësi e përbashkët e qytetarëve dhe administratës publike. Njerëzit duhet të të ndërgjegjësohen se mbeturinat e hedhura anës lumenjve, nuk ndotin oborret e shtëpive të tyre, por shëndetin e fëmijëve pas pak vitesh. Ndaj një mjedis i pastër mbetet një sfidë jo vetëm për një jetë të shëndetshme, por edhe për për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të zonës së Dibrës.

Mjedisi i pastër, *një sfidë për një jetë të shëndetshme dhe zhvillim të qëndrueshem*



Rafting në Dri, një nga burimet e reja ekonomike të turizmit në Dibër, i pashfrytëzuar akoma, por i rrezikuar nga mbetjet urbane. Foto: "North Green Association

"Mendo për mbrojtjen e mjedisit, para se të printoni në letër!", nënvizon me ngjyrë jeshile një ftesë e organizatës "North Green Association" drejtuar nga Edmir Truka. Dhe kur është fjala për mjedisin, nuk flitet vetëm për drurin që bëhet letër, por edhe për ta mbrojtur e mbajtur pastër atë.

Më 11 mars 2019, "North Green Association" zhvilloi në Peshkopi një tryezë të rrumbullakët me temë "Parandalimi i ndotjes së rrjedhave kryesore që derdhen në lumin Drin, për një jetë më të shëndetshme dhe mundësi zhvillimi të qëndrueshëm në Bashkinë Dibër". Kjo tryezë debati ishte në kuadrin e projektit "Gjurmë të gjelbërta për Dibrën", i cili është drejt fundit, nismë e "North Green Association" e mbështetur nga "Lëviz Albania" dhe synonte ngritjen e zërit mbi problematikën e ndotjes mjedisore, dhe njëkohësisht promovimin e bukurisë natyrore të basenit të lumit Drin në Bashkinë Dibër.

SI LINDI IDEJA?

"Projekt "Gjurmë të gjelbërta për Dibrën", ka lindur papritur, tregon për gazetën Edmir Truka. "Kohë më parë sëbashku me kolegun Ilir Hysa, themelues i organizatës 'Outdoor Albania Association', organizuam disa zbritje me rafting në lumin Drin i Zi për të promovuar turizmin. Nisjen e bëmë në fshatin Potgorcë, pak më sipër urës së Topojanit, sepse në vëzhgimet që bëmë në terren ishte vendi më i përshtatshëm për nisjen e grupeve. Një udhëtim i këndshëm në valët e lumit të qetë, ku grupet këndonin dhe njëkohësisht vozisnin lopatat për të kaluar dredhimet e ujit. Një natyrë përrallore e pa shkelur ndonjëherë, falë gomoneve bëhet e mundur të shijohet. Por, nga e gjithë kjo bukuri në disa momente çfarë të shikoje, mbeturina nga më të ndryshmet, ndër më kryesoret që të binin në sy ishte plastika të cilat valëviteshin si flamuj. Kryesisht në degëzimet që derdheshin në lumin Drin kishte masa të mëdha plastike të ngecura në shelgje dhe gurë. Pas përfundimit të raftingut, të gjithë grupet dukeshin të magjepsur nga udhëtimi, por në fytyrat e tyre lexohej qartë se ndotja nga plastika e kthente atë bukuri përrallore në një shëmti, e cila ishte ashtu prej egoizmit të njerëzve".

Edi, siç i thërrasin shkurt bashkëpunëtorët dhe kolegët e tij, tregon se kjo panoramë e udhëtimit të parë në lumin Drin, u bë shkak për të hartuar një projekt ide.

North Green si organizatë, është themeluar me një vizion, ndërtimin e një strukture shkencore, e cila do të ndihmojë në dhënien e përgjigjeve të ndryshimeve klimaterike që po ndodhin vitet e fundit dhe ndihmën për një zhvillim të qëndrueshëm të zonave rurale dhe urbane, në respekt të mjedisit dhe mbrojtjes së natyrës.

Ata konkurruan me këtë ide pas një thirrje të hapur të "Lëviz Albania", e cila i mbështeti të realizonim një projekt të tillë për zonën.

NGA IDEJA TE REALIZIMI: SHUMË PUNË PËR MJEDISIN

Edi thotë se "ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i të gjithë aktorëve për situatën e krijuar në lumin Drin brenda territorit të Bashkisë Dibër, do të ishte hapi kryesorë që duhej të ndërmerrej sa më parë". Sëbashku me grupin e punës filluam zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, duke filluar nga evidentimi e monitorimi i vendeve, ku ndotja apo hedhja e mbeturinave ishte prezente në tetë degëzimet kryesore që derdhen në lumin Drin si në Pocest, Gradec, Peshkopi, Çetush-Ushtelenxë, Murrë, Vrenjt, Setë dhe Radomirë.

Gjithashtu, gjatë realizimit të projektit është krijuar harta GIS e vend-depozitimeve të mbeturinave më të mëdha në rrjedhat e degëzimeve, krijimin e info-grafiqeve, të cilat krijojnë lehtësi perceptimin e situatës, krijimin e disa materialeve multimediale për të pasqyruar realitetin, aktivizim me nxënës të shkollave për të sensibilizuar mbi problematikat "duke pastruar oborrin e e shkollës", por gjithashtu edhe në bashkëpunim me Bashkinë Dibër, Prefekturën e Dibrës dhe DLDP - një program që ka asistuar institucionet vendore për planifikimin e menaxhimin e mbeturinave, gjithashtu, zbritjen në lumin Drin për të parë nga afër ndotjen dhe njëkohësisht aksion pastrimi aty ku ishte e mundur, por edhe për të lartësuar zërin mbi zhvillimin ekonomik me anë të turizmit të raftingut në Bashkinë Dibër.



Foto nga tryeza e debatit

Të gjithë këto veprimtari tashmë janë të njohura për publikun pasi janë shpërndarë në rrjetet multimediale dhe sociale. Gjithkush që ka një telefon, po të kërkojë në motorët e kërkimit në internet me emrin "North Green Association" do të gjejë të gjitha veprimtaritë mbi këtë projekt nën hashtagun **#perdibren**.

"Jemi munduar që të lartësojmë zërin edhe në radio kombëtare si, radio RASH, mbi këtë problematikë, tregon Truka. Ai thekson se "kjo lëvizje është për të advokuar dhe lobuar te të gjithë aktorët për të mbrojtur lumin Drin i Zi, i cili ka një potencial të madh në zhvillimin e turizmit dhe ekonomik të banorëve të zonës".

DEBATI

Në Bashkinë Dibër, problematikat në menaxhimin e mbetjeve janë nga më të ndryshmet, të cilat kërkojnë sa më parë të ndërmerren hapa konkrete në zgjidhjen e situatës. Hedhja e mbeturinave jashtë vendeve përkatëse është kthyer si diçka normale për banorët. Papërgjegjshmëria dhe jo-sensibilizimi i çdokujt mbi efektet negative në mjedis dhe vetë shëndetin, është e patolerueshme.

Të gjitha ato mbetje që nuk arrihen të menaxhohen përfundojnë në rrjedhat kryesore që derdhen në lumin Drin. Ndotja e tyre shkakton një dëm të madh jo vetëm në florën dhe faunën e pasur të basenit të Drinit, por edhe në shëndetin e njeriut, duke menduar që gjithçka është një cikël i mbyllur. Çdo gjë "nuk zhduket por transformohet".

Aktivistë dhe përfaqësues të organizatave mjedisore shfaqën pakënaqësi gjatë debatit. "Shumë organizata që merren me mjedisin i kalojnë problematikat perciptazi, jo të thelluar dhe shpesh nuk gjenden zgjidhja".

"Ky është një konstatim që uk na vjen mirë kur e dëgjojmë, thotë Edmir Truka, por për "North Green Association" ky ishte projekti parë që po zbaton dhe puna jonë si organizatë mbi problematikën e ndotjeve të rrjedhave kryesore në projektin, e ka tejkaluar atë se çfarë kishim parashikua. Mund të themi që me dëshirë kemi bërë vullnetarisht më shume se planifikimi".

Truka nuk harron të falënderojë stafin, Drejtorinë Arsimore Dibër, Pace Corps-Dibër, nxënësit dhe mësuesit, aktivistët, rininë dhe organizatat partnere, të cilët i janë bashkuar veprimtarive tonë, duke treguar se në vend ka potenciale njerëzore për t'i gjetur zgjidhjen këtij problemi.

"Në i falënderojmë të gjithë ata që na mbështetet, dhe te mbështetja e tyre ne kemi parë se në Dibër ka njerëz që mendojnë se me çdo çmim Dibra mund të ndryshojë".

"Situata e mjedisit nuk është e mirë, thotë gjatë debatit Durim Kaba, ekspert mjedisor. Ai shtoi që duhen ndërgjegjësuar më shumë i gjithë komuniteti mbi rrezikun dhe ndikimin negativ në mjedis. Gjithashtu, ai thekson se "një menaxhim i mirë, një ndarje e mbeturinave në burim dhe një riciklim mund të rigjenerojë ekonominë lokalë". Ai propozon që në ato zona, ku gjendja është rënduar, duhet të ndërhyhet me sa më shpejt për një rehabilitim të zonës dhe njëkohësisht të mbillen fidanë në mënyrë që, nëse dikur aty hidhnin mbeturinat, sot nuk mund ta bëjnë më një gjë të tillë. Një ndërhyrje mjaft e mirë, e cila përkon me qëllimin e projektit "advokim dhe lobim" duke ndërgjegjësuar dhe sensibilizuar për situatën e ndotjes dhe njëkohësisht potencialin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik që ka Bashkia Dibër".

Ajo që propozojnë ekspertët mjedisorë nuk mund të bëhet pa përfshirjen e institucioneve qeveritare, qendrore dhe lokale. Përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve të ngurta është Bashkia Dibër, por ajo nuk ka asnjë përfaqësues në këtë tryezë debati.

"U është dërguar ftesa bashkisë Dibër që t'i bashkoheshin kësaj tryeze, por në të dy takimet tona prezenca e tyre mungoi", thotë Edmir Truka.

"Duke mos e parë si tabelë qitjeje Bashkinë për keqmenaxhim, edhe pse përgjegjësitë kryesore i takojnë, ne jemi munduar që këtë fenomen, hedhjen e mbeturinave pranë rrjedhat ujore, ta luftojmë me aktivizim dhe ndërgjegjësim të shoqërisë dibrane me të gjitha instrumentet e mundshme që kemi patur në dispozicion", thotë Truka.

MBËSHTETJA QË VJEN NGA MEDIAT DHE RRJETET SOCIALE

Ekipi i "North Green Association" ka shfrytëzuar maksimalisht mundësitë e komunikimit që të ofrojnë sot mediat sociale. Përveç radios kombëtare "Radio RASH" dhe gazetën lokale "Rruga e Arbërit", për hapësirën që i kanë dhënë kësaj organizate për të shpërndarë zërin e tyre mbi problematikat të ndryshme, në rrjetet multimediale dhe sociale (Facebook, Instagram, Twitter, Linkedin), janë publikuar disa klipeve ndërgjegjësuese të shkurtra si, rafting në lumin Drin, apo edhe disa imazhe me dron në vendet ku anëtarët e organizatës nuk arrinin dot të shkonin, për të pasqyruar situatën reale të të gjitha degëzimeve kryesore që derdhen në lumin Drin. Gjithashtu janë publikuar disa spote sensibilizuese nga zëri i rinisë dibrane (shih faqen në Facebook të organizatës).

* * *

Mbajtja e një mjedisi të pastër është përgjegjësi e përbashkët e qytetarëve dhe administratës publike. Njerëzit duhet të të ndërgjegjësohen se mbeturinat e hedhura anës lumenjve, nuk ndotin oborret e shtëpive të tyre, por shëndetin e fëmijëve pas pak vitesh. Ndaj një mjedis i pastër mbetet një sfidë jo vetëm për një jetë të shëndetshme, por edhe për për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të zonës së Dibrës.

BUJAR KAROSHI

Më shumë mund të ndiqni:
Faqen zyrtare në internet: **www.northgreen.org**
Faqen në Facebook të organizatës
https://tinyurl.com/y49uatr4
Më shumë video:
https://tinyurl.com/y65clksl

Disa nga aktivitetet kryesore që zhvillohen çdo vit janë: Oda Dibrane, dita e Verës, dita e Nevruzit, dita e Shënkollit, festa e të Vjelave, festa e Drinit, festa e Korabit, festa e Shëngjergjit, panairi i Qershive etj. Ndër aktivitetet më të mëdha është festivali folklorik "Oda Dibrane".

Festat tradicionale, vlerë e shtuar e turizmit kulturor



Nga Fatbardh CENA

TRASHËGIMIA KULTURORE E DIBRËS.

Trashëgimia kulturore përbëhet nga vlera materiale dhe jomateriale, të cilat janë pjesë e pasurisë kombëtare. Trashëgimia kulturore materiale përfaqëson një bashkësi vlerash kulturore dhe historike të trashëguara, të shprehura përmes tipologjive të ndryshme arkeologjike, arkitekturore, historike, artistike etj. Trashëgimia shpirtërore përfaqësohet nga folklori i pasur gojor, muzikor dhe koreografik, festat lokale, artizanati, zejet e ndryshme etj.

Meqenëse është popullur që në lashtësi, Dibra zotëron një pasuri të madhe kulturore materiale dhe shpirtërore. Trashëgimia materiale në këtë rajon përfaqësohet nga larmia e objekteve historike si: kalatë, banesat karakteristike të zonës, muzetë historikë, objektet e kulteve të ndryshme fetare dhe një sërë objektesh apo rrënojash arkeologjike. Një pjesë e madhe e tyre janë shpallur monumente të kulturës. Dibra përbëhet gjithashtu edhe nga një trashëgimi shpirtërore e pasur që përfaqësohet nga këngët dhe vallet tradicionale, festat e shumta lokale, kuzhina tradicionale e shumëllojshme dhe e shijshme, lojërat popullore etj. Kjo pasuri dëshmon aftësinë krijuese të popullit dibran në shekuj, marrëdhëniet me vendet fqinje si dhe shkëmbimet apo ndikimet e kulturave të ndërsjellta. Pasuritë kulturore përbëjnë edhe një potencial të madh për zhvillimin e turizmit kulturor në vendin ku ndodhen apo manifestohen.

Vlerat jomateriale të trashëgimisë kulturore janë: përdorimi i gjuhës shqipe në veprat letrare; folklori gojor i ruajtur në kujtesë, i shkruar ose i regjistruar; folklori vokal, koreografik dhe instrumental; zakone dhe doke tradicionale; besime dhe besëtytni të traditës dhe zejet e ndryshme tradicionale. Trashëgimia kulturore shpirtërore në rrethin e Dibrës përfaqësohet nga folklori i pasur gojor, muzikor dhe koreografik (këngë dhe valle), festat lokale, artizanati, zejet e ndryshme etj. Në punimet artizanale dallohet për prodhimin e kostumeve tradicionale të njësive administrative të ndryshme, qilimat e punuara me dorë, mbulesat e leshta, punën me shtiza, instrumentat muzikore si çiftelia, fyelli, daullja etj. Gjithashtu pasuri më vete paraqesin këngët dhe vallet tradicionale të cilat janë të shumëllojshme dhe manifestohen kryesisht në raste gëzimi. Banorët dibranë kanë njohuri të mira rreth historisë dhe trashëgimisë së tyre, dinë gojëdhëna të shumta, kanë njohuri mbi kanunin e zonës etj. Gatimet tradicionale dibrane janë mjaft të njohura në gjithë vendin. Mikpritja është një nga vlerat që e bën mjaft dallues këtë rajon.

Trashëgimia materiale në këtë rajon përfaqësohet nga larmia e objekteve historike si: kalatë, banesat karakteristike të zonës, muzetë historikë, objektet e kulteve të ndryshme fetare dhe një sërë objektesh apo rrënojash arkeologjike. Një pjesë e madhe e tyre janë shpallur monumente të kulturës.

FESTAT TRADICIONALE

Festat tradicionale dëshmojnë më së miri pasurinë e gjallë kulturore të Dibrës në të gjitha aspektet. Ato shprehen në formën e festimeve apo ngjarjeve historike, ku banorët lokalë dëshirojnë që t'i ndajnë me komunitetin e zonës si dhe me vizitorët. Disa nga aktivitetet kryesore që zhvillohen çdo vit janë: Oda Dibrane, dita e Verës, dita e Nevruzit, dita e Shënkollit, festa e të Vjelave, festa e Drinit, festa e Korabit, festa e Shëngjergjit, panairi i Qershive etj. Ndër aktivitetet më të mëdha është festivali folklorik "Oda Dibrane".


FOTO NGA FESTIMET PËR DITËN E VERËS

FESTIVALI FOLKLORIK "ODA DIBRANE".
E ka nisur jetën e tij në vitin 1994, i konceptuar në fillim si takim i rapsodëve popullorë. Në të morën pjesë kryesisht grupe e shoqata kulturore nga Shqipëria e Maqedonia, si dhe artistë që bënin jetë të pavarur artistike. Ky lloj aktiviteti pati jehonë, si ndër të parët e këtij lloji dhe u mirëprit. Ishte një iniciativë e përbashkët e artistëve dibranë dhe Kryesisë së Shoqatave Kulturore Artistike të shqiptarëve të Maqedonisë, që kishin nevojë për më shumë hapësira për jetën e tyre artistike. Që nga viti 1997, ky festival është zhvilluar pa ndërprerje, duke u konsoliduar vazhdimisht dhe duke krijuar një emër të padiskutueshëm në të gjithë Shqipërinë dhe më gjerë. Është ky emër i mirë dhe vlerat që solli, që Ministria e Kulturës e ka planifikuar në aktivitet kombëtar dhe vazhdon ta mbështesë financiarisht. Kjo veprimtari artistike zhvillohet në qytetin e Peshkopisë edhe për arsye simbolike. Duke qenë një qytet afër kufijve politikë, përfaqëson një trevë lidhëse të kulturës shpirtërore të krahinave të ndryshme, u krijon mundësinë grupeve të mbajnë gjallë këngën dhe vallen shqipe që të mos e harrojnë atë. Që në fillimet e veta të para, ky bashkëpunim ishte shumë i rëndësishëm për të dy palët.

Në këtë festival paraqiten rite të lashta si dhe vegla karakteristike muzikore. Festivali krijon mundësinë për një rizbulim të tyre. Tashmë është bërë tradicional dhe, duke qenë i përvitshëm, u jep mundësi grupeve, shoqatave, individëve nga treva të ndryshme të kërkojnë, zbulojnë dhe paraqesin vlerat karakteristike të tyre në këtë fushë. Specialistët më të mirë në këtë fushë e kanë quajtur këtë festival një zbulim dhe kontribut të çmuar në kulturën e traditën shqiptare. Kërkesat për pjesëmarrje nga e gjithë Shqipëria dhe trevat ku banojnë shqiptarë janë të shumta dhe krijojnë mundësinë e seleksionimit të vlerave që paraqiten në të. Festivali krijon një atmosferë të rrallë në qytet jo vetëm për artdashësit e tij, por edhe për artistët pjesëmarrës dhe vetë zonat nga vijnë ata. Këtë e tregojnë jo vetëm kërkesat e grupeve pjesëmarrëse, por edhe kërkesat e artdashësve nga Shqipëria dhe jo vetëm, për t'u krijuar mundësinë e ndjekjes së tij. Kjo ka bërë që veç konkurrimit në sallën e Pallatit të Kulturës, të planifikohen dhe shfaqje jashtë në shesh, ku numri i shikuesve është tepër i madh.

Ky festival ka arritur të bashkojë artistët shqiptarë, kudo që ndodhen, me idenë brilante dibrane që "Oda Dibrane" do të jetë mikpritëse e gjithë "Odës Shqiptare". Është një festival shumë origjinal në llojin e vet, i cili ndër të tjera ka synuar dhe synon të rizgjojë edhe vlerat e papërsëritshme të trashëgimisë sonë shpirtërore, duke paraqitur rite të lashta dhe vegla karakteristike muzikore, të mikpritjes tradicionale që dibranët ju bëjnë të ftuarve në odën karakteristike të tyre, si dhe të promovimit të vlerave turistike të qytetit e zonave përreth tij, duke e kthyer këtë veprimtari në festë të madhe të kulturës dhe qytetarisë dibrane, por edhe të turizmit kulturor.

Kjo jetëgjatësi dhe vazhdueshmëri tregon qëndrueshmërinë e tij, vlerat që sjell, tregon domosdoshmërinë e zhvillimit të një festivali të tillë. Kjo argumentohet dhe me kërkesat në rritje të grupeve të ndryshme, jo vetëm nga të gjithë trevat shqiptare brenda dhe jashtë kufijve për të qenë pjesëmarrëse në festival, por dhe me kërkesën e shumë studiuesve dhe specialistëve të folklorit si nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, por dhe nga vise të tjera ballkanike. Është një takim specifik, original në llojin e vet jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë. Është takim i valles popullore humoristike, ritit, alegorisë dhe lojërave popullore. Qëllimi i tij është t'i rizgjojë këto vlera të papërsëritshme të kulturës sonë, t'i sjellë në kohë dhe t'i bëjë të asimilueshme për shikuesit.

Oda dibrane, në gjuhën popullore, simbolizon dhomën e pritjes së mikut. Është simbol i vatrës së bujarisë, qëndresës e trimërisë shqiptare, ku bëhen kuvende, ceremoni në raste gëzimesh e fatkeqësish, ku shpaloset mençuria dhe urtësia e popullit. Ka shërbyer ndërkohë edhe si vendi ku thureshin e mernin udhë këngët e bukura epike e lirike, ku festohej e gëzohej, ku këndonte kënga apo niste gjëma, ku pritej apo përcillej miku i shtëpisë, ku përdoreshin fjalë të urta dhe dialogu alegorik. Në këto oda fjala kishte peshë shumë të rëndë. Aty buruan edhe melodité e bukura të këngëve tona, ritet, humori i këndshëm dhe satira therëse, fjala e urtë, mendimi alegorik. Mësimet e para burrat dibranë i merrnin në odat dibrane, të njohura e të përmendura me breza, të cilat ishin shkolla të vërteta për të rinjtë. Në oda nuk flitej pa radhë dhe nuk thuheshin fjalë të kota, por fjalë të kursyera e të mençura. Aty flitej për punët e qeverisë, për politikë, për bujqësi, tregoheshin sidomos histori të vërteta, lartohej vepra e patriotëve, mësohej të qëllohej me armë dhe edukoheshin të rinjtë të flisnin kur, dhe si duhej.

Në ditë të shënuara, në shtëpinë që kishte rastin, në ndonjë dhomë të miqve ose në konak, veçmas rrinin burrat. Ata ishin kryefamiljarët, të cilët zakonisht ishin të moshuar e pleq. Aty flitej sipas moshës dhe cilido, po të dëshironte mund të shfaqte mendimin e tij të lirë. Pranë oxhakut, që i thonë edhe kryevendi, ulej më plaku, i cili përfaqësonte një përvojë jetësore të madhe, të cilën, kur binte fjala, e transmetonte tek të tjerët. "Unë kam mbaruar Universitetin e Oksfordit, por mbarova edhe një universitet të dytë, atë të Dibrës", ka shkruar studiuesi anglez Riginald Hibbert në gazetën "Albania life". Në këtë "shkollë" u rritën breza të tërë burrash e grash që, veç trimërisë e zgjuarsisë, trashëguan në shekuj atë kulturë, atë pasuri të madhe të



Pamje nga Lura. Foto MENSUR GASHI

OPINION

Si Dibra s'ka tjetër

Nga **BESNIK ALKU**

Jemi mësuar që këtë slogan ta ndeshim në pjesë të tjera, për të tërhequr vizitorët dhe turistët, por nuk e kemi ndeshur më parë në Dibër, pasi për shumë vite jemi mësuar ta shikojmë Dibrën si vendi ku nuk jetohet dhe nuk ka të ardhme, me probleme sociale, ku papunësia është e lartë, pa infrastrukturë rrugore, pa ujë të pijshëm, me pyje të degraduara dhe ku njerëzit vetëm duan të largohen.

Por Dibrës, zoti i ka falë natyrën, mikpritjen dhe traditën, unike dhe si askund tjetër, vlera që intrigon çdo vizitor për ta vizituar dhe, pasi e ka parë, nuk rrin dot pa ardhur përsëri.

Dibra është kampione dhe më dalluese në Shqipëri, sepse ka:

– Malin më të lartë, Korabin.
– Lumin më të gjatë, Drinin e Zi.
– Vendlindja e Heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu.
– I vetmi territor ku janë 21 liqene akullnajore.
– Ujërat termale më të mirat në Ballkan.
– Kufiri i kulturës dhe qytetërimit romak dhe bizantin.
– Parkun e Lurës dhe Korab-Koritnikun.
– 41 monumente natyrore dhe 24 monumente kulturore dhe arkeologjike.
– Vendi simbol i dhisë së egër.
– Vendi i qershive, mollëve dhe frutave.
– Vendi i origjinës së jufkave.
– Vendi i sheqerpares, dhe llallangijave.
– Vendi i lëngut të mollës dhe rakisë së kumbullës.
– Atje ku mishi dhe bulmeti kanë vlerat dhe aromën e 136 bimëve të rralla mjekësore.
– Popullin, mjeshtër të punës, alegorisë, mençurisë së odës dhe kuvendit.
– Ku vallja dyshe e burrave dhe kënga në korr e grave e bëjnë gëzimin dhe dasmat edhe më mitike.
– Ku vlerat krijuese nga Haki Stërmilli deri tek Agron Tufa pasurojnë mozaikun e vlerave krijuese të dibranëve.
– Ku miku respektohet dhe mikpritja lartësohet me thënien "Shpia është e zotit dhe e mikut",
– Ku rinia e dashuron me shpirt turizmin!

Nëse nuk e ke vizituar ende Dibrën, nuk e ke parë ende Shqipërinë!

Mirë se vini në Dibër!

Autori është koordinator i Projektit D2T (Dibra: Turizëm dhe Traditë)

Trashëgimia kulturore shpirtërore në rrethin e Dibrës përfaqësohet nga folklori i pasur gojor, muzikor dhe koreografik (këngë dhe valle), festat lokale, artizanati, zejet e ndryshme etj. Në punimet artizanale dallohet për prodhimin e kostumeve tradicionale të njësive administrative të ndryshme, qilimat e punuara me dorë, mbulesat e leshta, punën me shtiza, instrumentat muzikore si çiftelia, fyelli, daullja etj.

folklorit në tërë përmasat e tij, duke fituar kështu vlera të veçanta që po i gjallëron për çdo vit "Oda Dibrane".

DITA E VERËS. Është riti më dominant dhe më i përkrahur kalendarik, si në qytet ashtu dhe në fshatra që manifestohet si me interesimin e popullatës, ashtu edhe me pjesëmarrjen e madhe, pasi ka karakterin e një të kremteje të rëndësishme. Në të gjithë rajonin e Dibrës festohet me datën 14 mars. Është një festë pagane që festohet në të gjithë Shqipërinë, por që në këtë zonë ka karakteristikat e veta. Festimet nisin rreth dhjetë ditë më parë me mbushjen e ujit të ri në orët e para të mëngjesit, ku laget pragu i shtëpisë, ndizen zjarre etj. Një ditë më parë përgatiten kuleçë e zihen vezë, duke i ngjyrosur me lëvoret e qepëve ose me ngjyra. Fëmijët dalin në kodrat e fshatit dhe luajnë lojëra të ndryshme popullore si: kala dibrançe, kërcim me litar, top a djegas etj. Zënia e vezëve është një ndër pjesët më interesante, ku fituesi është ai që me vezën e tij thyen më shumë të tilla. Fëmijët, me lëvoret e vezëve patkojnë (zënë) lulet e verës, të cilat i këpusin të nesërmen me 14 mars. Lulet i vendosin në portat e shtëpive, për të lajmëruar ardhjen e pranverës. Gjithashtu, një natë më parë ndizen zjarret për të larguar dimrin. Fëmijët hanë rreth zjarrit, kërcejnë e këndojnë këngë, duke shprehur dëshirën që të kenë zjarrin më të madh.

FESTA E TË VJELAVE. Ky aktivitet zhvillohet zakonisht në muajin tetor dhe zgjat 1 deri në 3 ditë. Zhvillohet në bulevardin e qytetit të Peshkopisë, në të cilin vendosen tendat për ekspozimin e produkteve bujqësore, blegtorale si dhe gatimeve apo punimeve tradicionale të zonës. Në shumë raste zhvillohen njëkohësisht me festivalin folklorik "Oda Dibrane" duke qenë se ka një pjesëmarrje të gjerë si nga dibranët dhe më gjerë. Është panairi i cili dallohet për pjesëmarrjen më të gjerë dhe me produkte më të shumta të ekonomisë bujqësore. Ndër produktet më kryesore janë: mollët, dardhët, ftonjtë, arrat, prodhime blegtorale si djath dhie apo deleje, mjaltë, raki e llojeve të ndryshme, ëmbëlsira të shumëllojshme, turshi, pastërma, jufka etj. Këto produkte të përzgjedhura nga fermerët u ofrohen qytetarëve dhe njëkohësisht promovohen produktet tradicionale të zonës.

DITA E NEVRUZIT. Pavarësisht nga emri persian, duke rënë ngjitas me ditën e ekuinoksit të pranverës, përmbledh në vetvete rite vendëse të ripërtëritjes së natyrës e të jetës së njerëzve. Me burim nga historia e vjetër antike, e mbështjellë me legjenda e mitologji, është ndër festat më të mëdha kombëtare iraniane. Nevruzi është festa që sjell lajmin e mirë të ardhjes së pranverës, të gjelbërimit, bukurinë e jetës, lëvizjen e natyrës. Është një festë e besimit bektashian, por festohet në gjithë zonën e Dibrës. Një pjesë e zonës e festojnë me 22 mars, ndërsa pjesa tjetër, tre ditë më vonë.

DITA E SHËNKOLLIT. Fshatra të njësisë administrative të Selishtës organizojnë me rastin e kësaj feste shfaqje folklorike, festivale të ushqimit, kampe zjarri, gara me kuaj dhe aktivitete të tjera sportive. Festohet në muajin maj në livadhet e shumta të Selishtës. Ka një pjesëmarrje si nga qyteti i Peshkopisë, ashtu edhe nga njësitë administrative të tjera. Problem mbetet rruga Peshkopi-Selishtë e cila përshkohet vetëm me furgona dhe makina të tipit fuoristradë. Por kjo nuk e pengon që të ketë një pjesëmarrje masive në këtë aktivitetet. Ditën e Shënkollit zakonisht e organizon NJA Selishtë.

FESTA E DRINIT. Është aktiviteti festiv që shënon hapjen e sezonit turistik në njësinë administrative Muhurr. Kjo festë ka nisur rreth vitit 2005 dhe nga viti në vit ka njohur një rritje të numrit të turistëve. Aktiviteti ka si qëllim të tij jo vetëm hapjen e sezonit turistik, por edhe promovimin e turizmit në këtë zonë. Festimet janë të shumta si: muzikë, këngë e valle, aktivitete të ndryshme sportive etj. Përgjatë bregut të Drinit të Zi, vizitorët kanë mundësi të shijojnë gatimet tradicionale të zonës në lokalet pranë. Zakonisht sezoni turistik hapet më datën 1 korrik, por kjo edhe në varësi të kushteve klimatike.

FESTA E SHËNGJERGJIT. Një festë e Dibrës, me një rëndësi të veçantë e tepër interesante, në emër e krishterë, po në rite tërësisht e besimit pagan, është Shëngjergji që bie më 23 prill me kalendarin e vjetër dhe me 6 maj, me kalendarin e përditshëm. Kjo e kremte e ringjalljes së natyrës quhej edhe kryeviti, pra si një ditë e një viti të ri. Këtë natë të festës e të nesërmen kryhen rite të shumta e domethënëse. Të rinjtë dikur dilnin natën e ndiznin zjarre në vende të dukshme. Natën haheshin në natyrë ushqime rituale. Me tërë këto ushqime "patkonin" lulet ("i ushqenin ato"), sidomos kukurekun, lule-metimin dhe luleshëngjergjin. Patkonin gjithashtu barin e njomë në një copë vendi në livadh a fushë me bar dhe një gur të bardhë të rrumbullakët e një plis dheu që i vendosnin mbi barin e patkuar. Kjo është një festë pagane, e cila njofton ardhjen e verës, gjelbërimit të të gjithë bimëve dhe shpëtimi i bagëtive prej mungesës së ushqimit. Për këtë ditë nga familjarët ruhet qengji më i mirë për t'u therur.

FESTA E KORABIT. Kjo festë zhvillohet në fund të muajit qershor apo fillim të korrikut, në bjeshkët e Korabit, në pjesën e njësisë administative të Kalasë së Dodës dhe më pak të Sllovës. Është pikërisht kjo periudhë ku mbizotëron gjelbërimi, freskia e klimës, bota e pasur bimore e shtazore etj., prandaj paraqet një interes të madh për vizitorët. Zakonisht ky aktivitet festiv zhvillohet në Fushën e Korabit. Duke qenë se terreni është i vështirë dhe ngjitja bëhet në lartësitë rreth 2000 metër, për transport përdoren kuajt, sidomos për moshën e tretë. Kryhen aktivitete të ndryshme si: valle me curlë e lodër, futboll, lojëra popullore etj. Marrin me vetë edhe gjeneratorë për vënien në punë të fonisë pasi këndojnë e dëgjojnë këngë, sidomos për Korabin, por edhe këngë patriotike të zonës së Dibrës dhe mbarë Shqipërisë.

Meqenëse zona e Kalasë së Dodës merret kryesisht me blegtori, e konkretisht me mbarështimin e dhenve, në këtë festë dominon mishi i qengjit në hell si dhe djathi i zonës mjaft i njohur. Pjesëmarrja është e gjerë si nga banorë të Kalasë së Dodës apo që kanë migruar, nga gjithë zona e Dibrës, Kukësit, si dhe personalitete të ftuar. Aktivitetet fillojnë në mëngjes dhe zgjasin gjithë ditën. Kështu udhëtarëve u duhet që të ngrihen herët në mëngjes për të arritur në kohë, por një pjesë e tyre flenë në çadra apo kampingje një natë më parë. Zbritja bëhet në drejtime të ndryshme, në varësi të preferencave të individëve, për të parë sa më shumë vende gjatë rrugës. Organizohet nga banorë vullnetarë, shoqata, njësi vendore etj. Që nga viti 2010 është një veprimtari që zhvillohet rregullisht. Kjo festë shihet edhe si promovim i potencialeve të turizmit malor që ofron zona e Korabit.

PANAIRI I QERSHIVE. Organizohet çdo vit në periudhën maj-qershor që është edhe koha e vjeljes së qershive. Zhvillohet çdo vit pasi ka një rritje të fermerëve që marrin pjesë në këtë panair, të cilët tregtojnë dhe promovojnë produktin e qershisë dhe në disa raste gjejnë treg për shitje. Vihet re një rritje e konsiderueshme e sipërfaqes së tokës, falë programit të skemës mbështetëse për fermerët.

(Burimet bibliografike të përdorura në këtë shkrim mund t'i konsultoni në versionin olinë)


Ura e Brarit

Rruga e Arbërit, dëshmitë

Me hapjen e rrugës trashëgimnia historike e kulturore do të pësojë një ringjallje, duke i dhënë hov zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë

Dibra nuk i kërkon askujt lëmoshë për këtë rrugë por veç një "borxh të pashlyer" jo vetëm ekonomik, por dhe me kosto gjaku.

Nga **AZIZ KETA**

Të shumta janë njoftimet shpresëdhënëse për ritmet e larta të ndërtimit të Rrugës së re të Arbërit, sidomos në segmentet Ura e Vashës- Qafë Murrizi dhe Ura e Topojanit në Homesh. Për të parë më nga afër këto punime dhe për t'u njohur me anën historike dhe mrekullitë natyrore të kësaj rruge, që do jetë objekt i turizmit të nesërm, një grup dibranësh janë përfshirë në nismën e një guide turistike.

Në vartësi të pjesmarrësve, janë planifikuar dhe masat logjistike.

Ndër to: mjetet për lëvizje janë planifikuar me shkallë të lartë kalueshmërie dhe me drejtues që njohin trasenë e vjetër dhe të re të rrugës. Traseja ku parashikohet të kalojë rruga do vizitohet e gjitha. Aty ku nuk kalojnë mjetet do kalohet në këmbë. Kjo distancë mund të jetë rreth 20 km dhe parashikohet të zgjasë rreth 5-6 orë. Sepse vetëm duke shkelur rrugën e qerreve në këmbë do kuptojmë mrekullinë dhe absurdin e saj.

Vetëm duke e shkelur këtë rrugë me këmbë do kuptojmë pse të parët tanë ishin aq të mençur që bën mbi 20 shekuj këtë rrugë me mushkë, kuaj dhe qerre më shpejt se me makinë. Dhe, duke bërë rrugën të shkurtër, e "zinin lepurin me qerre". Sepse qerrja lëviste në drejtimin e duhur për në Tiranë, jo duke "i rënë nga Kina", për të bërë 70 vjet 100 km më shumë...

Por edhe shkalla e kalueshmërisë do shihet me sy,do kuptojmë se ajo nuk është aq e lartë sa jemi mashtruar 28 vjet. Përkundrazi: do bindemi se rruga që po shkelim nuk ka shumë dallime me grykat e Shkopetit që kishim dhe kemi e po kalojmë në to 70 vjet rrjesht.

ABSURDI

Mendoni sa ditë do na duhej të bënim 157 km "Rrugë Dibre" në këmbë nga Bulqiza....

- Cili fshat i Shqipërisë bëri një rrugë 70 vjet trefish më të gjatë?

- Kush më shumë se Dibra që nxorri dhe eksportoi krom, energji, lëndë drusore e mermer dhe me duart e veta e ndërtoi Shqipërinë, kontriboi edhe për Rrugën e Arbërit?

- Kush më shumë se Rruga e Dibrës, sot e Arbërit, ka magjinë dhe bafasinë të ofroj shumëllojshmërinë e objekteve historike dhe turistike që do të shkelim në vetëm 57 km?

- Kush më shkurt se vetëm me 57 km rrugë Arbëri rilidhim lindjen me perëndimin , Tiranën me Dibrën, Shkupin me Durrësin?

- Kush më shumë se Tirana me Dibrën, historikisht ishin kaq afër dhe u bënë kaq larg vetëm për mungesën e rrugës së Arbërit ?

- Pse Tirana dhe Dibra quheshin "Kërthiza e Arbërisë historike dhe begatia e saj ekonomike"?.

- Sa beteja të mëdha dhe kështjella qytete kishim në rrethina Dibre dhe Tiranë?

- Sa kanione, liqene karstike, kulla, ura si ajo e Vashës, miniera kromi, lumej, pyje që "puthin retë" kishim dhe kemi nga Tirana në Homesh?

- Pse "grykat dhe bigat e Valkhalisë" me rrugën e Dibrës në bosht, vlerësohej si "lugina dhe drejtimi më i rëndësishëm, paralel me "grykat e Shkumbinit", por me një veçori plus: Drejtimi i Dibrës ishte gjithnjë "brenda shtetit të Skënderbeut", në " kërthizë të Arbërisë", 100 km më shkurt për të lidhur lindjen me perëndimin e Arbërisë. Për nga vlerat mbrojtëse, ky drejtim krahasohej vetëm me Kaudinet në Itali të Jugut (Barleti).

Ishin këto arsyet: në bosht të Rrugës Dibrës që fillonte nga "Ohri i Dibrës"dhe këtu kryqëzohej me Egnatian, ajo zgjatohej deri në Rodon. Ishin kështjellat dhe rrugët arsyet që kishim kaq shumë beteja, "vorre të vrame", Bulqiza e shkretë, Rrugë Vrami, gjeksina... etj.

Ishte rëndësia e Dibrës në kufirin lindor të Arbërisë që kishin dy rrugë paralele të Dibrës Dibrës: njëra e kurrizeve (Dibër-Zerqan- Bizë- Tiranë) dhe tjetra për lugine : Dibër- Luginë Bulqize- Guri Bardhë- Qafë Murrizë- Tujan – Tiranë.

Po këtu, kishim stane aq dhe punishte baruti, fusha pjellore dhe farka.

Sepse Dibra dhe Tirana ishin "hambari dhe gonxhet e Arbërisë".

Sepse Dibra dhe Tirana, bashkë me rrugën e tyre, ishin gjithnjë brënda kufive administrative të kastriotëve, kishin dalje në Adriatik dhe kripore qysh në kohë të Gjonit.

Kishin kontrollin dhe doganën mbi rrugët dhe karvanët.

KALAJA KETIN E XIBRIT DHE NIKOLL KETA

Në kalanë KETA të Xibrës, ku ishte dhe qyteza,e lokalizuar në kohën e Perandorisë Romake, derdheshin dhe qarkullonin monedha të gjithë llojeve, sepse kjo kala ishte më e rëndësishmja pas Krujës deri sa u bë Petralba (Guri bardhë). Këtu ishte "kërthiza e rezitencës" së shtetit të Skënderbeut me Valkhalinë në qendër.

Ndaj:

Vetëm duke e shkelur me këmbë,rrugën e Arbërit dhe parë me sytë tanë një segment të kësaj rruge që mban jo pa kuptim emrin "Myslim KETA", e pas saj "kështjellën Ketin në Xibër", dhe po prej këtej togëfjalëshin "popolo Chetta" , që sipas Nikollë KETA (1740- 1803, me origjinë shqiptar Maqedonie dhe 14 vjet Rektor në Palermo),qysh më 1777 ofronte befasinë : Emri i sotëm i Maqedonisë shqiptare vjen nga shqipja: Emathi + Chetta + Dardani = Machedoni. (Tessaro).

Ja pse duke parë me sytë tanë "rrugën e vjetër të qerreve", do kuptojmë pse sot " lepuri ka hypur vetë në qerre" dhe nuk është më nevoja t'i "biem më nga Kina". Sepse me finacimet e buxhetit të shtetit "janë lagur rrotat e qerres" nga të ardhurat e kromit të Bulqizës në 70 vjet dhe Dibra nuk i kërkon askujt lëmoshë për këtë rrugë por veç një "borxh të pashlyer" jo vetëm ekonomik, por dhe me kosto gjaku.

Sepse vetëm Bulqiza dhe Martaneshi me tre miniera të kromi dhe po kaq burgje, në 70 vjet kohë paqe, derdhi gjak në "zgafellat e vdekjes" më shumë se në kohë lufte.

Ja pse rruga e dikurshme e mushkës dhe e qerres, sot po lëviz në drejtimin e duhur". Madje po përmbysen skenat e "teatrit absurd me Rrugë Arbëri", që na mbajtën peng 28 vjet me mashtrime banale. Se gjoja në këtë rrugë "na paskan dalë ujra nëntoksore" të pa parashikuara. Pastaj në "këtë rrugë nuk mund të kalojë as lepuri", ndaj dhe nuk ka efektivitet.

Pastaj: 28 vjet thamë pse nuk bëhet Rruga e Arbërit. Dhe kur filloi e ritmet janë për "URRA" themi: "Ç'janë kanë këta që po e bëjnë rrugën e Arbërit"?

EGNATIA DHE RRUGA E ARBËRIT - NJË VËSHTRIM GJEOSTRATEGJIK

Sepse vetëm nga drejtimi i Dibrës -Bulqizë –Tirane hyhet në Tirane dhe Krujë më shkurt se në çdo drejtim tjetër. Por, nuk ishte vetëm kjo. Për të lidhur kufitë lindore dhe verilindore të Arbërisë me Tiranën, Krujën dhe bregdetin, kishte disa rrugë paralele, por dy ishin më të hershmet në kohë: Egnatia dhe rruga e Dibrës. Këto dy rrugë, kishin këto ngjajshmëri dhe dallime: të dyja ishin rrugë tregëtare dhe ushtarake; lokalizoheshin në kohë me periudhën ilire, bashkë me kështjellat qytete që i siguronin këto rrugë; kishin lidhje, zgjatime dhe kryqëzime kryq e tërthorë me njëra-tjetrën; kishin siguruar vazhdimësi lëvizje në çdo pjesë territori nga kufitë lindorë të Arbërisë (ku pjesë dhe Dibra), deri në perëndim (Adriatiku); si dhe Egnatia ashtu dhe rruga e Dibrës, secila mbulonte drejtimin e vet: njëra drejtimin e Shkumbinit, tjetra të Valkhalisë. Kjo e fundit e lokalizuar: nga "përballë Ohrit" deri në Modriç-Ostren-Okshtun-Valikardhë. Kjo rrugë ishte paralel me Drinin dhe nuk futej në grykë Radike. (Kurmaku).

Për të kaluar Drinin, nëse vije nga Shkupi dhe Pollogu (Gosivari i sotëm) dhe të futeshe në "bigat, ngushticat dhe grykat e Valkhalisë", (Barleti), kishte një urë antike dhe funksionale në Lladomericë. Kjo urë ishte po aq e ngjajshme në anë konstruktive, arktekturore dhe aftësi mbrojtëse sa ajo në urën e Qytetit të Valikardhës dhe të Vashës që ishin në të njejtin segment.

Deri në vitin 1948, tek kjo urë kishim ende doganë me Maqedoninë shqiptare dhe këmbët e saj mund ti shohim dhe sot.

Si Egnatia dhe Rruga e Arbërit, në kohë të ndryshme kishin trase dhe stacione të ndryshme dhe ishin pjesë e zgjatime të njëra-tjetrës. Zëvëndësonin njëra-tjetrën, sidomos kur Perandoria Osmane, bashkë me Venedikun, merrte nën kontroll Egnatian.

Të dyja rrugët patën dëmtime, riparime dhe plotësime në kohë e gjëndje të ndryshme luftarake.Tendenca e tyre vinte duke u zgjeruar dhe rikostruktuar nga rrugë kafshare në rrugë qerresh në vartësi të bujave që viheshin si mjet tërheqie.

Ndaj vetëm në Bulqizë dhe Domosdovë, ku kishim Rrugë Dibre dhe Egnatia, të vetmet të kalueshme nga buajt, ndaj dhe gjejmë toponimet: Fusha e Buallit në Domosdovë dhe Qafa e Buallit në Bulqizë.

LIDHJE URBANE, QËLLIME TREGTARE DHE USHTARAKE.

Ngjashmëritë teknike midis tyre, koha e ndërtimit, llojshmëria e shtresave të trasesë, gjërësia në mal dhe në fushë, shkalla e pjerrësie, cilësisa e veprave të artit (urave) dhe zgjedhja e rrugës më shkurtër, ishin mrekullitë logjistike të kohës.

Të dyja kishin projektim, realizim dhe arkitekturë të përafërt dhe shkallë kalueshmërie të njejtë. Si Egnatia dhe Rruga e Dibrës, fillimisht ishin të kalueshme vetëm në verë – vjeshtë, pastaj edhe për dimër, sigurisht me masa plotësuese. Kjo sidomos nga tregëtarët që kontrollonin këto rrugë. Sepse nga këto rrugë kishin jetën, mbijetesën dhe lulëzimin e tyre. Sepse po ata prijësa që kontrollonin rrugën e Dibrës, po ata kishin kishin kalanë e Xibrit. Një ndër ta ishte dhe Nik KETA (Niketa) Thopia.

Kethydat dhe jo vetëm, kontrollonin kështjallat e rrugës se Dibrës, sigurinë rrugore dhe hanet në to (Xibër hane). Topiasit dhe jonimët, "nuk linin rast pa ngacmuar tregëtarët që kalonin në tokat e tyre". Duhej të ishte dashamirësia e sundimtarëve vendas që kontrollonin Rrugën e Dibrës dhe kështjellat që e mbulonin atë, nëse kërkohej qarkullimi i mallrave në qytetin bregdetar të Durrësit (1393- 1395), që ishte aq e kërcënuar në tokë, sidomos "tregëtarët me karvanë ".

Kaq problematike ishte siguria rrugore


Ura e Vashës

historike nga Tirana në Bulqizë

në tokë, sa të merreshin masa për transport detar nga Durrësi në Shkodër. Por edhe flota pirate vendase ishte nën kontrollin e Kethydasve. Madje, vahet ishin burim të ardhurash për sundimtarët vendas. (Schmitt, Shqipëria Venedikase, 2007: 83-85).

Për këtë arsye, Kalaja e Xibrit quhej dhe shkruhej në kohëe dhe variante të ndryshme: KETIN, Kethion, Kethium dhe "kethyda" (KETA, i Xibrit, AK). Paria e tyre ishin prijës dhe kështjellarë.

Zotëronin malin dhe fushën (Tiranë, Xibër, Shëngjergj, Martanesh, Bulqizë, Cermanikë, Gostivar dhe rrethina. Ky ishte "popolo chetta" që citonte Nikollë KETA.

Po këta mblidhnin taksat dhe kishin flotën e tyre në Adratik ku dominonte Liburna. Po këta sundonin përsëri fushën sa herë lirohej ajo nga ushtritë e huaja. Dhe po këta ngjiteshin në male (popullsia anase, Çabej) sa herë pushtohej fusha. Kështu Kethyda i shpëtuan pushtimit, nderrimit të fesë dhe asimilimit. Ruajtën dhe zgjeraun pronat, mbetën kështjellarë dhe ruajtën idenditetit të tyre:

ARBËR TË PASTËR!

Si për Egnatian dhe Rrugën e Dibrës, si vendasit ashtu dhe pushtuesit u kujdesuan për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe rritjen e shkallës kalueshmërisë së tyre, sidomos për dimër. Sepse rrugët ishin si "arteret e gjakut" që lidhnin midis tyre krahinat, principatat, jo vetëm për normalitet urban.

Mbi të gjitha, këto dy rrugë ishin të domosdoshme për zhvillimin e tregëtisë. Sepse ju shërbenin perandorive të mëdha ekonomike dhe ushtarake, pa të cilat nuk mund të realizonin qëllimet e tyre zhvilluese, mbrojtëse ose pushtuese.

Kur transporti në këto rrugë u zgjeruan masivisht, sidomos për nevoja të ushtrive të huaja, rruga pësoi rikonstruktime dhe zgjerime në vazhdimësi. Mushka dhe kuajt (sidomos nga ushtria perandorake turke), u zëvëndësuan nga qerrja dhe buajt. Por kjo nuk ishte vetëm "domosdoshmëri turke". Madje, edhe se Amerika kishte shpikur makinat dhe synohej të shkohej në hanë me satelit, në konceptet e saj ushtarake deri në vitet '50 –të të shekullit të kaluar, shkruhej: "Fatin e luftës në mal e vendos ajo ushtri që ka zgjidhur rrjetin rrugor dhe transportin me kafshë". (Historia e Artit Ushtrak).

Dy toponimet: fusha e Buallit në Domosdovë ku kishim Egnatian dhe Qafa e Buallit në Bulqizë, ku kishin Rrugën e Dibrës, janë një provë më shumë se vetëm Egnatia dhe Rruga e Dibrës ishin dy rrugët më kryesore të kalueshme të ushtrisë osmane me qerre dhe buaj, që lidhnin lindjen me perëndimin, ku drejtimi i Dibrës ishte më i shkurtri se ai I grykave te Shkumbinit kur vije nga Kalkadreni (Tetova), Ohri, Shkupi dhe Pollogu (Gostivari).

Cilësia e urave që kishte Rruga e Dibrës, ishin të ngjajshme me atë të Vashës, Valikardhës, ç'ka flet për kulturë të lartë zhvillimi. Kjo duket edhe sot si në anën konstruktive të tyre, edhe në arkitekturë, qëllim përdorimi dhe funksion mbrojtës.

Të gjitha këto flasin për një mrekulli logjistike të kohës.Para Egnatias ishte Rruga e Kandavisë dhe quhej e tillë deri në fillim të shekullit të II p.k. Romakët e zgjeruan atë. Kandavija, shtrihej midis Durrësit dhe Matit.

Në letrën e Ciceronit shkruhej: Për të sosur në Epir do të kaloj pa u ngutur nëpër Kundavi.

Pompeu, do shkruante: "Nëpërmjet Kandavisë ju drejtova Maqedonisë".

Straboni, tek "Gjeographica", do shkruante: "Buzë rrugës që shkon për Kundavi, janë liqenet rrotull Lyhnidit që kanë vënde të mjaftueshme për të kripur e për të tharë peshq".

ÇFARË MUND TË SHOHIM RRUGËS SË ARBËRIT?

Në Brarë, Ura e Brarit dhe kanionet fantastike të tij. Aty dhe varri vitit 1201 i Principatës së Arbërve që ishte formuar më 1190 dhe ishte i pari shtet feudal shqiptarë që është dokumentuar dhe ekzistoi deri në fund të shekullit të XIII, ku ndodhet mbishkrimi: "Kujto o Zot shërbetorin tend, Mihal Zeguri me bashkëshorten dhe nipërit".

Në këtë varrë, janë 5 kryqe dhe 5 harqe, shenjë e 5 pjestarëve të familjes së sundimtarit Arbër. (By "Një Komb", June,19, 2018).

Pikturat shkëmbore 5000 vjeçare mund t'i shohim në Bovillë, që janë vetëm 15 km larg Tiranës. Sipas Korkurtit, këto shkrime i përkasin periudhës së neolitit (rreth 2000-3000 vjet para krishtit). Këto shkrime ndodhen në një shkëmb me gjatësi 30-40 m dhe në lartësi 2-3 m. Shkrimet janë me bojra, ruhen deri sot dhe aty pasqyrohen ritet e njerzve të kohës neolitit ose bronxit.

Mbasi të kalojmë rrënojat e kalasë Tujanit, Kalanë e Xibrit, Gurin e Bardhë të Budit, urën e Vashës në Dars të Gavril Darës, mund të shohim dhe Qafën e Bues, luginën e Ebusë ose Bulqizën e sotme, pjesë dhe në kërthizë të " bigave dhe ngushticave të Vaklhalisë.

Po këtu, qafa e Bulqizës. Lugina e Ebusë = lugina e Bulqizës. Gjin Bue = Gjin Bulqiza, zot i Artës. Zerqani do quhej Artë.

Ashtu si Pal Gropa ishte Zot i Ohrit edhe Gjini i Bues ishte Zot i Moresë, ku evidentohen në Peloponez : Merkur Bue Shpata qysh në vitin 1333.

Gjon Muzaka tek" Memoria" na thotë: "Gjin Bua ishte degë e Skurajve" ndërsa Ch. Hoph tek "Cronicues Greco- Romans", Berlin 1873, shkruan: " Principata e Buajve pati shtrirje të gjërë dhe lulëzoj pas rënjes së Perandorisë Serbe më 1354. Më i dëgjueri Gjin Bue shpata, i biri i Petro Nikollë Buas, sundojë Despotin e Artës deri më 1399".

Përshkruhet: "i bukur, i pashëm, i guximshëm dhe i urtë në fisin arbnorë".

QYTEZA E XIBRES, ishte vendbanim i madh ku, përveç kalasë Xibrit lokalizuar afër fshati KETA, përfshinte: Shkallë, Xibër Hane, Xibër Murrize, Dars dhe Fushat (Fshat). Të gjitha këto ishin pjesë të qytezës Xibrit. Në kuotën 963 m ishte pika më e lartë e kalasë së qytezës.


Rrënojat e Kalasë së Xibrit

Në Kalanë e Xibrës, studiuesit, duke vlerësuar anën konstruktive, teknikën ndërtimore, trashësinë e mureve të saj; sasinë dhe shumëllojshmërinë e monedhave dhe sendeve të ndryshme të luksit të gjetura në të, e lokalizojne ate te periudhes Ilire..

* * *

Kur ra Xibri dhe u zëvëndësua me Gurin e Bardhë, Nik KETA Thopia kërkoi ta ringrej atë, por duket, lartësia e madhe e Xibrës dhe shkalla e lartë e vështirësisë për karvanet me buaj nxorrën nevojën për lartësi më të buta siç ishte Guri Bardhë dhe Darsi. Ndaj dhe legjenda që flet për bëmat e Skëndrebeut tregon jo vetëm për varret e "Nikës dhe të Petës në Vajkal", por edhe për kalin e Skënderbeut që kur lindte nevoja " fluturonte nga Guri Bardhë në Dars"(Akademia e Shkencave, Gojëdhana për Skënderbeun").

Sot në Xibër kemi fshatin KETA pa KETA sepse: pasi ra Xibri, si kështjellarë që ishin, ata shkuan përsëri aty ku ishin kështjellat: në Guri Bardhë, Valikardhë (Bulqiza e sotme), Crrujë (sot në Shegun, Klos) dhe në territore të Maqedonisë shqiptare .

Sot, në Gostivar dhe në dy fshatra të rrethinave gjejme vendbanimet Cajle dhe Tuçan i madh. Këtu kemi KETA dhe Kita, pra identifikojmë "popolo Chetta" të fisit shqiptar nga Tirana në Gostivar, ashtu siç e shkruante para 4 shekujsh Nikollë KETA tek Tesaro (1777).

Nikollë KETA ishte i biri i Kolës dhe e informonte Princeshën KATERINE se të parët e tij ishin "arbër i pastër Maqedonie".

Nga ekspeditat e sotme në terren, identifikohet plotësisht lokalizimi i "popolo Chetta" që fillon nga Tirana e Vogël tek Ura e Brarit (Rruga Myslim KETA) dhe kjo pjesë vlerësohej si "gonxhja e Arbërisë".

Befasitë që ofron kalaja e Xibrit, Kënga e Sprasme e Balës, kryevepra e Nikollë KETES dhe ditari në dorëshkrim (original) i Mulla Baki KETES, të tria në kohë te ndryshme , qysh në perudhë ilire e deri në ditët tona, të vërtetuara në terren, mund të jenë pjesë e të panjohurave që do prezantohen në këtë Guide Turistike.

Dilaver Kurti na informon se kalaja e Xibrit emërtohej Ketron sepse ngrihej afër fshatit KETA dhe daton në kohë në periudhën e parë të hekurit. Lulëzimin e saj e jep në shek.IVp.e.s dhe rindërtimin e saj në kohë të Justinianit. Fundin e saj e daton me mundjen e Gjon Kastriotit prej turqëve.

Selami Islami, pasi kundërshton datimin në kohë, jep të dhëna për pozicionin e saj në një sipërfaqen 4 ha. Islami e ndan kalanë e Epërme nga sheshi i kalasë dhe jep pjesën e qytezës në një mjedis natyrorë tepër të mbrojtur. Po ky autor jep edhe teknikën e ndërtimit, popullsinë që strehohej në kala dhe qytezë dhe rezistencën që kjo kala bënte ndaj pushtuesëve maqedonë dhe romake.

Banorët e vendbanimeve malore, në kohë paqe zbrisnin në lartësi më të ulta deri në fushë Tiranë ku kishin mashnat (kullotat) dhe arat e bukës.

Sot në Bulqizë kemi të identifikuar 4 fise KETA, Gjergj Mirëshpinë, Plakun Balë, Nikën, Petën, të Bukurën e Lalës, etj.që përmenden edhe tek Kënga e sprasme e Balës, edhe tek Barleti, edhe tek Nikollë KETA edhe tek studimet e Shaban Sinanit. Mbi të gjithë është kryezbulimi i Mandalasë dhe Altimarit. Janë këta autorë që na informojnë: "Këngën e Sprasme të Balës nuk e shkroi as Dara plaku, as i riu , por vetë Plaku Balë, që nuk është personazh i sajuar por bashkëkluftëtarë i Skënderbeut. Madje, Shaban Sinani shkon më tej: Kënga e Sprasme e Bales duhet lexuar edhe historikisht!

Presidenti i Republikës, në 75-vjetorin e ditëlindjes i akordoi Prof.Dr.Bujar Kapexhiut dekoratën e lartë "Nderi i Kombit"

profil

Nderimi i një artisti polivalent

Nga **Halil RAMA**



Nderimi nga kreu i shtetits, me dekoratën e lartë, është para së gjithash vlerësim i arritjeve të spikatura të Prof.Dr.Bujar Kapexhiut në fushën e regjisurës, karikaturës e të interpretimeve të paharrueshme kinematografike, të cilat kanë karakterizuar veprimtarinë e tij profesionale të shumanshme artistike si dhe për vlerat e çmuara në edukimin, formimin dhe përgatitjen e disa brezave artistësh të rinj.

BUJAR KAPEXHIU, "DIAMANTI" I ARTIT DHE KULTURËS KOMBËTARE

Listës së personaliteve të shquara dibrane, të vlerësuara nga Kreu i Shtetit iu shtua edhe Kryetari i Shoqatës "Bashkësia Dibrane". Në 75-vjetorin e ditëlindjes së tij, më 22 Mars, Presidenti i Republikës, Ilir Meta i akordoi Prof.Dr.Bujar Kapexhiut dekoratën "Nderi i Kombit". Nderimi nga kreu i shtetits, me dekoratën e lartë, është para së gjithash vlerësim i arritjeve të spikatura të Prof.Dr.Bujar Kapexhiut në fushën e regjisurës, karikaturës e të interpretimeve të paharrueshme kinematografike, të cilat kanë karakterizuar veprimtarinë e tij profesionale të shumanshme artistike si dhe për vlerat e çmuara në edukimin, formimin dhe përgatitjen e disa brezave artistësh të rinj. Më së miri këto arritje të këtij artisti polivalent u evidentuan në dokumentarin e regjisorit Ilir Harxhi, që u shfaq në darkën me rastin e 75-vjetorit të ditëlindjes së tij, ku mes qindra miqve ishin dhe ikona e artit skenik e kinematografik Robert Ndrenika, shefi i opozitës shqiptare Lulzim Basha, nënkryetari i LSI Luan Rama, Z.Ylli Asllani-Këshilltar i Presidentit Meta, Sekretari i Përgjithshëm i SHBD, Dr.Saimir Shatku – "Mjeshtër i Madh", përfaqësues të Senatit akademik të UET, etj. Një dokumentar ky, që ndonëse i realizuar në një kohë rekord, nëpërmjet fjalës artistike të skenaristit dhe intervistave të miqve të tij të shumtë, e prezanton Bujar Kapexhiun para publikut si një ikonë të artit e kulturës sonë kombëtare, të mishëruara këto në "laboratorin e tij krijues" si siregjisor, skenarist dhe aktor i mirënjohur shqiptar. Kështu miqtë dhe kokegët e vlerësojnë atë si një artist polivalent, shumëdimensional, i cili ka pasur si udhërrëfyes të krijimtarisë së tij, pse jo, edhe më gjerë, Njeriun.

Kapexhiu, që ka lindur më 22 mars 1944 studioi për aktor në shkollën e lartë pranë Teatrit Kombëtar, si edhe kursin e lartë pasuniversitar për regjisor po aty. Më 1968 filloi punë si regjisor në Teatrin e Estradës së Tiranës ku shkroi shumë skeçe, parodi, kuplete si edhe u mor me karikaturë për organet e shtypit. Pas një periudhe dy vjeçare largimi nga Tirana, për shkak të "shfaqjeve liberale dhe moderniste" në Festivalin e 11 të Këngës në RTSH, ku ishte autor teksti dhe konferencier, u rikthye më 1975 si regjisor dhe piktor në sektorin e sapo ngritur të filmit vizatimor pranë Kinostudios "Shqipëria e re". Filmi "Zhgarravinat" (1977) ku Kapexhiu krijoi vizatimet, skenarin dhe regjinë u vlerësua me çmimin e Parë të Festivalit të III-të të filmit Ballkanik të organizuar në Stamboll, Turqi, 1979 ; me Kupën e Festivalit të III të Filmit Shqiptar, 21-28 prill 1979 si dhe me çmim në Napoli të Italisë në 1984. Deri në vitin 1985 xhiroi rreth 20 filma vizatimorë në shumicën e të cilëve është skenarist ose bashkëskenarist, regjisor dhe piktor; mes tyre spikat edhe Pipiruku, personazhi i dashur për fëmijët i ndërtuar prej tij. "Pipiruku pret 2 miq" u vlerësua me çmim të dytë në Festivalin e VI të filmit dokumentar e vizatimor. Pas vitit '85 iu përkushtua zhanrit të kinokomedisë duke u shquar për individualitetin e spikatur. Në një kohë mjaft të shkurtër xhiroi katër filma artistikë : "Dy herë mat", 1986, "Tela për violinë", 1987, "Stolat në park", 1988, "Edhe ashtu, edhe kështu", 1989.

Vizionin perëndimor të tij e gjejmë të shpalosur shumë kohë përpara triumfit të demokracisë në vitet '90-të. Në vlerësimin si interpretues me nivel të lartë artistik, do të na mjaftonte qoftë edhe vetëm filmi "Dueli i Heshtur, kur Bujar Kapexhiu, në vitin 1967, interpretoi rolin e tij të parë në kinema, atë të një të riu të pakënaqur, që kërkon të arratiset përtej detit. Këtu na del para syve një personazh mjaft interesant, i vërtetë, me "look" perëndimor dhe ide kundrarevolucionare. Një rol shumë impresionues, në kohën kur ishim mësuar të shihnim heronj të realizmit socialist, të fortë, të paepur, me bindje të pastra... Aq mirë është mishëruar ky rol sa të duket që vetë Bujari ka qenë i tillë, njëri prej atyre njerëzve që donin të kapërcenin kufirin.



Presidenti Meta me Bujar Kapexhiun dhe Saimir Shatkun

NDËR PËRFAQËSUESIT MË DINJITOZË TË BOTËS AKADEMIKE

Në harkun kohor të tri dekadave, Bujar Kapexhiu është nderuar me titutujt dhe dekoratat më të larta që jepen në Republikën e Shqipërisë, që nga "Artist i Merituar" (para 30 vitesh më 1989), "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut" e "Mjeshtër i Madh", por dekorata e lartë "Nderi i kombit", që Presidenti Meta ia akordoi në 75-vjetorin e ditëlindjes, me propozimin e Shoqatës "Bashkësia Dibrane" dhe Senatit Akademik të UET, është vlerësim real dhe objektiv i kontributit të tij si artist dhe pedagog e profesor, prej më shumë se pesë dekada.

Si një ndër përfaqësuesit më dinjitozë të botës akademike, Prof.Dr.Bujar Kapexhiu është nga themeluesit e Degës së Komunikim-Dizajnit në UET, si dhe pedagog për një kohë të gjatë, duke ndarë eksperiencën dhe dijet e tij me shumë studentë që sot janë të suksesshëm në profesionin e tyre. Këto merita në fushën akademike e shkencore gjatë ceremonisë së dhënies së dekoratës "Nderi i Kombit", i evindetuan, jo vetëm z.Arben Cici, Drejtor i Kabinetit të Presidentit Meta, por edhe Presidenti i Universitit Europian të Tiranës, prof. dr.Adrian Civici dhe themeluesi i këtij universitetit, publicist, analisti dhe politologu i mirënjohur Henri Çili.

"Presidenti i Republikës, i jep Z.Bujar Kapexhiu dekoratën "Nderi i Kombit" në vlerësim të kontributit të tij të spikatur si artist i guximshëm me vlera të rralla, në fushën e artit pamor, në skenën dhe kinematografinë shqiptare dhe në jetën publike e mediatike",-tha ndër të tjera përfaqësuesi i Presdentit të RSH që i dorëzoi dekoratën. Ndërsa vetë Kapexhiu, mes emocionesh të këtij çasti solemn u shpreh se: "Pa dyshim të vlerësohet një punë e madhe, aq më tepër nga Presidenti i Republikës është një nga nderet më të mëdha që të bëhet dhe të bën krenarë e të mobilizon akoma më tepër për të punuar akoma më shumë".

KAPEXHIU SI KARIKATURIST

Në vigjilje të 75-vjetorit të ditëlindjes së tij, Mjeshtri i Karikaturës B.Kapexhiu prezantoi në Hollin e UET ekspozitën "Me ndërkombëtarët", ndërsa qindra pjesëmarrësit në këtë ekspozitë, jo vetëm familjarë dhe miq të tij, por edhe politikanë, morën "dhuratë" librin e tij "Rreth e rrotull".

Në veprat e ekspozuara në ekspozitë si dhe në këtë libër gjejmë një gërshetim veprash që kanë si subjekt jo vetën aktorët kryesorë vendas të jetës politike por edhe ndërkombëtarët, ku thumbon, ironizon, madje guximshëm edhe provokon me anë të krijimtarisë së tij, momente të rëndësishme, kur ndërkombëtarët mund të jenë bërë palë me "të pandëshkuarit" për aferat e tyre korruptive e kriminale.

Bujar Kapexhiu, aktori i mirënjohur shqiptar vjen kësisoj kësaj here për publikun me një tjetër zhanër, me karikaturat për ndërkombëtarët. Por, siç dihet, janë qindra karikaturat e të botuara në shtypin e përditshëm që janë përmbledhur në librat e mëparshëm: "Ngërç / Për një karrige / Kthesë".

Si Mjeshtër i vërtetë i karikaturës, Kapexhiu është i guximshëm në ide, ndaj dhe me një sens të hollë humori ai kritikon me zgjuarsi fenomene të forta negative të jetës politike e shoqërore të vendit.

PROF.DR.BUJAR KAPEXHIU SI VEPRIMTAR SHOQËROR

Si intelektual me vlera të spikatura njerëzore dhe intelektuale, Bujar Kapexhiu, kurrësesi nuk mund të qëndrojë jashtë spektrit të veprimtarive shoqërore. Prej vitesh ai është zgjedhur nga komuniteti dibran në Tiranë (një prej komuniteteve më të konsiderueshëm jo vetëm si numër përfaqësuesish por edhe për intelektulë të mirënjohur), kryetar i Shoqatës "Bashkësia Dibrane", të cilën e drejton me përkushtim e profesionalizëm.

Me talentin e tij të rrallë por edhe me përkushtim qytetar ai e ka vitalizuar e dinamizuar këtë shoqatë, duke e ngritur në nivelin e organizmave akademikë, për nga cilësia e produkti i veprimtarive. Për këtë flasin dhjetra konferencat e sesionet shkencorë, promovime librash e dokumentarësh, tubimet përkujtimorë e botimet kushtuar ngjarjeve e personaliteteve të shquara dibrane që kanë luajtur rol vendimtar për fatet e kombit, që nga periudha e Skënderbeut, shpallja e pavarësisë së Shqipërisë, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare e deri në ditët tona.

Ja, ky është mjeshtri i aktrimit e regjisurës, krijimtarisë letrare e artistike, pedagogu e veprimtari shoqëror B.Kapexhiu, me një bilanc mjaftë pozitiv në kinematografinë shqiptare, në botën akademike e atë shoqërore të vendit.

profil



Filantropi Faik Bruçi

Biznesmeni Faik Bruçi na ka ofruar një model të njeriut të suksesshëm, që suksesin e tij kërkon me ngulm ta ndajë me njerëzit.

Faik Bruçi është një biznesmen intelektual. Ashtu siç jam ndjerë komod në bashkëbisedim me të për çështje të ekonomisë, financës, apo politikave monetare, etj, ashtu jam ndjerë në siklet teksa më ka rastisur të jem i pranishëm në biseda të tij me palë të tjera nga niveli "shkatërrues"i njohjes së fushave të tjera si inxhinieri, energjitikë, mjedis, histori, etj.

Nga **HEKURAN VLADI**

BAMIRËSIA DHE FILANTROPIA

Filantropi do të thotë patjetër dashuri për njerëzit. Një nga përkufizimet konvencionale moderne është "iniciativa private, për të mirën publike, duke u fokusuar në cilësinë e jetës". Kjo gjë kombinon një traditë origjinale humaniste me një aspekt shkencor shoqëror të zhvilluar më vonë në shekullin e 20-të.

Përkufizimi i këtij termi është i rëndësishëm, pasi gjithashtu shërben për të kontrastuar filantropinë me përpjekjet e biznesit, të cilat janë iniciativa private për të mirën private. Në rastin e filantropëve, lehtësisht veprimi përkufizohet si "iniciativë private për të mirën publike".

Në këtë pikë, ndërsa përpiqemi të përkufizojmë filantropinë, duke u mbështetur natyrisht në përkufizimet botërore të këtij termi, duhet të kemi kujdes të mos e ngatërrojmë me bamirësinë.

Kjo, pasi filantropia është një hap më lart bamirësisë e kjo jo thjesht në aspektin kohor, pasi normalisht që bamirësia ka lindur bashkë me lindjen e njerëzimit dhe është zhvilluar me sistemin fetar monoteist prej 2 mijë vjetësh e këtej.

Femomeni që e ndjek bamirësinë, në aspektin kronologjik, është filantropia.

Filantropia ka karakteristika dalluese të ndara nga bamirësia, pra jo të gjitha bamirësitë janë filantropi, ose anasjelltas, edhe pse ekziston një shkallë e pranueshme e mbivendosjes në praktikë.

Një ndryshim i përmendur zakonisht është se bamirësia synon të lehtësojë dhimbjen e një problemi të caktuar shoqëror, ndërsa filantropia përpiqet të adresojë shkaqet rrënjësore të problemit dhe ti zgjidhë ato, ose të ndihmojë në zgjidhjen e tyre.

Teknikisht është dallimi midis dhuratës proverbiale të një peshku ndaj një të urituri, kundrejt mësimit se si i urituri të peshkojë dhe ndihmës paraprake për pajisjet e nevojshme për peshkim.

Kjo është filantropia.

Duket e thjeshtë në përshkrim, por aq e vështirë në praktikë.

FAIKU, OSE MODELI FILANTROP I BIZNESMENIT NË SHQIPËRI

Faik Bruçi është sfidanti i vështirësive, ndaj në këndvështrimin tim, e kam vlerësuar prej shumë kohësh si një model të veçantë bamirësi dhe si një filantrop shumë fisnik.

Duke e njohur që në fillim të viteve '90 kam ndërtuar një profil në mendjen time për të, pra kryesisht duke "vjedhur" informacionin në rrugë relatash shoqërore, por të shoqëruara me një kuriozitet të veçantë nga ana ime.

Nuk do të merrem aspak në këtë shkrim të shkurtër me analizën time se cilat cilësi e dërguan Faikun në shkallën e një biznesmeni të suksesshëm. Jo, se nuk ia vlen si analizë, pasi gjithashtu është një model për t'u ndjekur, por vetëm me përmasën e tij njerëzore, e cila e shkëput cilësisht nga homologët e vet, që e rrethojnë e që na rrethojnë edhe ne në jetën e përditshme.

E kjo, siç e përmenda edhe më lart, është përmasa filantrope e Faik Bruçit.

Kushdo që e provoi, apo dëgjoi për mënyrën se si mund t'i kërkohet ndihmë biznesmenit Faik Bruçi, e kuptoi që bamirësia e këtij biznesmeni nuk ndalon aty. Pra, nuk është thjesht një bamirësi.

Ka një karakteristikë interesante sjellja e këtij biznesmeni me njerëzit, të cilëve iu ofron ndihmën e vet. Ai kërkon me ngulm, që ndihma e tij të mos jetë thjesht një donacion, por një investim. Dhe kjo sjellje, padyshim që është e përshkallëzuar, që nga sjellja me të afërmit e vet të ngushtë, deri tek njerëz që i ka takuar për herë të parë.

Kjo lloj bujarie tregon modelin e një njeriu të suksesshëm, i cili jo vetëm nuk është xheloz për suksesin e të tjerëve, por përkundrazi kërkon ta ndajë suksesin e tij me njerëzit.

Janë të panumërta rastet e donacioneve të tij dhe shumat e parave, që ka dhënë janë të larmishme. Por, ajo që e veçon nga shumica e biznesmenëve donatorë të zakonshëm, është cilësia dhe suksesi, që Faiku kërkon me zgjuarsi nga kërkuesit e donacioneve të tij.

Do ta ilustroj këtë që thashë më lart vetëm me shembullin e kontributit të Faikut për ekipin e futbollit të Korabit, vitin e kaluar, rast në të cilin Faiku dha më shumë se dyfishin e kërkuar me kushtin që ekipi të kishte sukses, një sukses i cili erdhi me kalimin e ekipit në kategorinë superior, gjë që ishte një dhuratë shumë e çmuar për të gjithë dibranët.

Ja pse filantropia është një "sport i vështirë". Dhe Faiku e ka këtë cilësi si biznesmen filantrop.



Në foto: Gaqo Apostoli, Faik Bruçi dhe Defrim Methasani gjatë ceremonisë së nderimit me titullin "Ambasador i Paqes" për z.Bruçi.

Ka një karakteristikë interesante sjellja e këtij biznesmeni me njerëzit, të cilëve iu ofron ndihmën e vet. Ai kërkon me ngulm, që ndihma e tij të mos jetë thjesht një donacion, por një investim. Dhe kjo sjellje, padyshim që është e përshkallëzuar, që nga sjellja me të afërmit e vet të ngushtë, deri tek njerëz që i ka takuar për herë të parë.

QË TË JESH NJË FILANTROP, NUK MJAFTON VETËM TË KESH CA PARA MËNJANË

Kjo është analiza ime e shkurtër, modelin për të cilën e mora tek njohja personale me biznesmenin Faik Bruçi. Padyshim që nuk mjafton vetëm të kesh para.

Së pari, që të jenë të tillë, këto njerëz e kanë të domosdoshme dëshirën për të ndihmuar të tjerët, pra bujarinë, ose përmasën njerëzore të bamirësisë.

Ndoshta, vështirësitë e rinisë së hershme patjetër që kanë ndikuar që Faik Bruçi të spikasë me bujarinë e tij, e cila, siç thashëështë e shumë përmasave.

Së dyti, filantropët janë intelektualë.

Bamirësit mjaftohen me dhënien e një shume parash, apo ndihme tjetër, në rastin më të mirë dhe në rastin më të keq fillojnë edhe të japin "këshilla".

Këshilla, që nuk i hyjnë në punë njeriu, por që shumë bamirës e kanë privilegjin, jo vetëm të japin leksione të gjata, por edhe të shkruajnë libra.

Natyrisht, siç e thashë më parë, që nuk i hyjnë kujt në punë. Pse? Sepse thjesht nuk dinë, pasi është panumërt dhe krejt i zakonshëm rasti i njerëzve që janë bërë milionerë duke shitur sheqer, por nuk e dinëqë kripa bëhet edhe nga guri, jo vetëm merret në det.

Faik Bruçi është një biznesmen intelektual. Ashtu siç jam ndjerë komod në bashkëbisedim me të për çështje të ekonomisë, financës, apo politikave monetare, etj, ashtu jam ndjerë në siklet teksa më ka rastisur të jem i pranishëm në biseda të tij me palë të tjera nga niveli "shkatërrues"i njohjes së fushave të tjera si inxhinieri, energjitikë, mjedis, histori, etj.

NDËRTIMI I MODELEVE DHE PROMOVIMI I TYRE

Modelet janë shumë të vështira për t'u ndërtuar, por të domosdoshme.

Ashtu si në shumë industri, ku prodhimi i një produkti të caktuar duhet paraprirë nga modeli përkatës, edhe në shoqërinë njerëzore ndërtimi i modeleve është domosdoshëm.

Ndryshimi është se në shoqërinë njerëzore modelet bëhen vetë të tillë.

Ajo që të tjerët duhet të bëjnë, është t'i ndjekin këto modele dhe të mundohen t'i perfeksionojnë tek vetja.

Në rastin e modelit human, cilësia e një shoqërie duket kur këto modele njerëzore i promovon sa më shumë. Duke bërë këtë, shoqëria pra, i bën një nder të madh vetes dhe të ardhmes së saj.

Biznesmeni Faik Bruçi na ka ofruar një model të njeriut të suksesshëm, që suksesin e tij kërkon me ngulm ta ndajë me njerëzit. Ja, pra, ku është një shembull, që e kemi kaq afër, që duhet të gjejmë 100 mënyra se si t'a ndjekim.

Kam qenë para ca ditësh në dhënien e titullit ndërkombëtar shumë prestigjoz "Ambasador i Paqes" për Z. Bruçi.

Kam qene para një viti në dhënien e titullit "Qytetar Nderi i Dibrës", gjithashtu, e do shkoj patjetër nëçdo promovim të këtij burri.

Jo thjesht se e kam mik, por se jam i bindur që është një model, që me vlen mua e iu vlen të gjithëve.

Rruga e Arbërit nr. 155

biznes

Tashmë Ramazani është nisur në një rrugë pa kthim në biznesin e tij. Aty poshtë thertores shtrihet deri tek zalli një pyll i bukur me dushk dhe me akacje, që është gati për të shfaqur pranverën. Shumë pranë është dhe rruga e Arbërit, që do t'i hapë mundësi dhe perspektiva të paimagjinueshme të gjithë komunitetit dibran.

Duart e florinjta të **Ramazan Miftarit**

Nga **OSMAN XHILI**

Ramazan Miftari nga Çereneci i Dibrës e nisi që herët shtegëtimin nëpër veprat e kohës që ndërtonte Shqipëria. Sapo kishte mbaruar klasën e tetë, kur filloi punë me ndërtimin në Krumë të Kukësit. Po hidheshin themelet e pallatit të kulturës dhe disa objekte të tjera, që do të formatonin Krumën si një qytet të ri, në listën e shumë të tjerëve të kohës. Në fillim si punëtor, që ndihmonte specialistët e ndërtimit, por shumë shpejt ai do të bëhej vetë një ndërtues i talentuar. Inxhinjerët e pikasën dëshirën dhe aftësitë e tij në këtë drejtim dhe kështu fluturoi ai nëpër veprat e kohës, si një zog shtegëtar, gjithnjë në migrim. Ai la gjurmë në Turizmin e ri të Kukësit, në fabrikën e Kalimashit, më pas në disa vepra në qytetin e Bajram Curit, në Mirditë e shumë qytete të tjerë.

Do të kishte vazhduar akoma dhe për shumë vite të tjerë, por zëri i vendlindjes e thërriste dhe ai nuk nguroi ti bindej. Sërish me ndërtime të kohës, gjithnjë para viteve nëntëdhjetë. U bë mjeshtër i ndërtimit të furrave të bukës, që kërkonin një teknologji mjaft të lartë. Më pas u fiksua në përpunimin e drurit, si mjeshtër në kombinatin e sharrës në kooperativën bujqësore dhe kështu vazhdoi deri në prishjen e sistemit, në vitin 1990.

Pak vite të tjerë, deri në 1996, Ramazani punoi si privat në përpunimin e drurit, me përpunimin e dërrasës, me dyer, dritare e të tjera si këto.

Më vonë mori një vendim për të shkuar në Greqi, siç bënë dhe shumë shqiptarë të tjerë. Fillimisht në Selanik e më pas në Athinë, ai u ndje shumë komod me punën e re. U muar kryesisht me punime dekorative, gdhendje guri, gdhendje druri, punime me mermer, të cilat greku i përfshinte me emrin kozmetiko. Mësoi gjuhën dhe u pajis me të gjitha dokumentet e nevojshme në një kohë shumë të shkurtër.

Ndoshta do të kishte vazhduar gjatë të punonte atje, por në vitin 2002 i ndodhi një incident i vogël në kufi. Teksa prisnin për të kaluar në shtetin fqinj, një fëmijë i vogël qante dhe dridhej nga i ftohti dimëror. Ramazani ndërhyn pranë autoriteteve të kufirit, që të paktën me fëmijën ti përshpejtonin proçedurat. – A do të bësh rolin e avokatit?- i thanë policët e shërbimit dhe kur i erdhi rradha Ramazanit, i vunë një kryq në pashaportë, për të mos kaluar



më për disa vite. Sidoqoftë ai ka kujtime shumë të mira për popullin grek, akoma i ruan lidhjet me ta dhe shkon atje për vizita pune.

Tani Ramazani ishte bërë një mjeshtër i vërtetë. Jo vetëm gurin e drurin që i punonte me shumë merak, por po kaq mirë e njihte dhe mjeshtërine e saldimit dhe çdo lloj pune me hekurin. E thënë shkurt, më mirë duhej të vrisje mendje për diçka që nuk e punonte në ndërtim, se sa të përshkruash vlerat dhe aftësitë e tij në këtë sektor kaq të bukur.

Dituria e tij shtrihej dhe në një fushë tjetër, me shumë vlerë si mjekësia. Ramazani kishte mbaruar një kurs për infermjeri dhe e kishte pasur shumë për zemër. Mësoi të gjitha mënyrat e mjekimit të plagëve, bile dhe hapjen e abseseve.

I njeh të gjitha llojet e injeksioneve, shtuar dhe atë intravenoz. U shërbeu dhe akoma u shërben banorëve të komunitetit, në raste kur kërkohet ndihma e tij Në vitin 1982 ai punësohet si infermjer i fshatit, por vetëm për pak kohë. Një " kleçkë" në biografi, bëri që të mos vazhdojë gjatë në këtë shërbim dhe ti kthehet sërish fushës së ndërtimit.

INVESTIMET E REJA.

Që kur ishte në Greqi, Ramazani ishte habitur me mënyrën si therrej e përpunohej mishi, kushtet higjeno sanitare dhe sigurinë ushqimore. Një dëshirë flinte brenda tij, që të tilla standarte ti aplikonte dhe në Shqipëri. Në vitin 2012, nipi i Ramazanit, që ishte pronar i thertores së Shupenzës, largohet për një jetë më të mirë. Ndoshta kishte ardhur momenti për të bërë hapin e rradhës. Jo vetëm pse ishte daja i tij, por dhe për faktin se e kishte ndërtuar vetë thertoren, në vitin 1996, kohë që shënonte dhe hapjen e saj. Tani që do ta kishte të tijën, mund të bënte gjëra të tjera, akoma më të bukura. E filloi punën me idenë se gjatë kohës do të ndryshonte shumë probleme që linin për të dëshiruar. Vetëm një javë vazhdoi me punën e re, pasi A.K.U ja konstatoi një sërë mangësish, të cilat duheshin rregulluar e korrigjuar. Nuk kishte rrethim, nuk kishte çengela, qentë lëviznin lirshëm. Inspektorët lanë një çek listë dhe tre muaj afat për rihapjen e objektit

Ramazani punon intensivisht për të plotësuar boshllëqet. Bën shtresa të reja të dyshemesë me llustër, bën suvatim të mureve dhe lyerje me bojë plastike, vendos impjantin e therjes manuale, penxhere, rrjeta dhe rrethim. Ndan vendin e therjes me atë të tregëtimit të mishit. Tre muaj më vonë, drejtori i atëhershëm, Maks Hajrullai, i gjen të plotsuara vërejtjet e bëra dhe i jep liçensën për të rinisur punën. Kështu kaluan pesë vite të tjerë, me pune, lodhje, por dhe eksperiencë, që nuk e kishte pasur më parë. Ishte viti 2017. Një urdhër i ministrisë së bujqësisë për të mbyllur të gjitha thertoret që nuk plotësonin kushtet në gjithë republikën, i kalohej autoritetit të A.K.U së për zbatim. Sërish një çek listë e re, që kërkonte një plan të ri masash për zbatim. E përkthyer në gjuhën teknike do të thoshte një sistem që garantonte maksimalisht sigurinë ushqimore të qytetarëve, kurse në gjuhën ekonomike, disa dhjetra mijra euro investime të reja. Për një moment Ramazan Miftari vihet në udhëkryq. Të ecte me guxim përpara, ashtu siç kishte bërë gjithë jetën e tij, apo të shpallte falimentin dhe të vinte një tabelë, ku thuhej "Objekti shitet", duke vënë pak më poshtë numrin e celularit të tij. Nuk ishte thjeshtë ana ekonomike e problemit, por dhe ajo morale. Ramazani kishte qenë gjithnjë një sfidant serioz dhe i pamposhtur. Nuk mund të ulte kokën para një vështirësie, aq më tepër që nuk ishte thjeshtë krenaria për veten e familjen, por dhe për Shupenzën, Bulqizën e Dibrën. Bashkë me familjen përmblodhi dhe njëherë tjetër forcat. U tur një vrap, duke vëzhguar thertoret e tjera në Lezhë, në Shkodër, Tiranë, Librazhd, e të tjera rrethe. Bashkoi dhe njëherë në mendje eksperiencat e tyre, të tijën, ato që kishte parë në Greqi dhe krijoi modelin përfundimtar. Gati nëntë muaj përpjekje për ta vënë planin në zbatim dhe më gjashtë qershor të vitit 2018 e rihapi thertoren dhe ja tek është kjo që, që tashmë e kemi para syve tanë.

THERTORJA SOT

Ndoshta si nëpër dhëmbë, Ramazani i shau në fillim ata që i mbyllën thertoren, por sot i falenderon me gjithë shpirt. Këtu ke të bësh me një model farmacie, saqë të vjen turp nga vetja të hysh brenda me një veshje të parregullt, që kontaminon ambjentin. Habitesh se si aty therret një bagëti dhe nuk sheh asnjë lloj papastërtie. E gjithë procedura është bashkëkohore, që nga pranimi i kafshëve për therje e deri në përfundim të proçesit. Kafshët duhet të kenë patjetër numrin e matrikullit dhe çerifikatën veterinare, që tregon vaksinat e kryera dhe të gjitha masat e tjera teknike, që janë aplikuar në të. Më pas, ajo kalon nën vëzhgimin teknik të mjekut veterinar të thertores dhe lihet për disa orë në observim. Më pas lahet dhe kalon te dhoma e therjes, ku proçedura është normale, pra me thikë, siç ka urdhëruar Zoti dhe jo me shok elektrik, apo mjete të tjera jo hallall. Në mënyrë të rrufeshme para teje hapen disa dyer, që përfundojnë në dhoma të fshehta. Gjaku kalon në njërën nga pesë gropat septike, lëkurra rrjepet dhe përfundon në dhomën e vet. Të brendshmet ndahen në një seksion tjetër, plënci pastrohet dhe mbeturinat bien poshtë në gropën e tyre septike. Karkasa e mishit, e ndarë në katër pjesë, lëviz përpara dhe ventilohet për mpiksjen e gjakut, para se të futet në frigorifer. Mishi vuloset, pajiset me dokumentacionin përkatës dhe është i gatshëm për të lëvizur në dyqanet e zonës, apo më larg akoma, sipas kërkesave të bëra. Një kampion i vogël mishi ruhet në një frigorifer tjetër, për shtatë ditë, për efekte krahasuese, për ndonjë problem që mund të lindë. E theksojmë se transporti përbën një pikë të fortë të thertores së Ramazan Miftarit. Deri në dyqanin e mishit ai përcillet me një mjet frigoriferik të liçensuar, që plotëson të gjitha kushtet higjeno sanitare. Ai e ka dhe vetë një dyqan mishi sipër thertores. E ka të pajisur me të gjithë elementet, që garantojnë sigurinë ushqimore dhe klienti ndihet vërtet si në perëndim, kur kërkon të blejë disa kilogram mish, apo nënprodukte të tij. Duke qenë krejt në rregull me ndërgjegjen e tij dhe me rregullat e shtetit, Ramazani nuk ka më frikë ligjin e shtetit, por përkundrazi, do që ai të jetë akoma më i fortë, që asnjë kokë bagëti të mos theret në rrugë, totalisht jashtë rregullave elementare të higjenës dhe të etikës profesionale.

Tashmë Ramazani është nisur në një rrugë pa kthim në biznesin e tij. Aty poshtë thertores shtrihet deri tek zalli një pyll i bukur me dushk dhe me akacje, që është gati për të shfaqur pranverën. Shumë pranë është dhe rruga e Arbërit, që do ti hapë mundësi dhe perspektiva të paimagjinueshme të gjithë komunitetit dibran. Biznesmeni sheh alternativa të reja. Fare ngjitur, në anën tjetër të rrugës është tregu i Shupenzëa, apo pazari, siç e quan populli për më shkurt. Kafshë të çdo lloji, kuaj, mushka e gomerë, të trasha e të imta hyjnë e dalin nga të katër anët. Produkte ushqimore, pa asnjë lloj çertifikate trgëtohen fare përtokë, apo në tezga që janë të mbuluara me një gisht pluhur. Disa mejhane, pa asnjë lloj liçense e bëjnë akoma më mjerane pamjen e këtij tregu, që rrezikon të shpërthejë sëmundje në çdo rast. Ramazani ka bindjen që mund ta disiplinojë dhe atë, ashtu siç bëri me thertoren e tij në pak kohë. Nëse jo ai, le ta bëjë dikush tjetër, mjafton që gjërat të ndryshojnë e të vihen në rrugë të mbarë.







FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

Marrë nga libri "Toponimia e Çidhnës" i autorëve Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri, Botimet M&B, Tiranë, 2016.



FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

- ***Kamtrupthi:*** *Këmbëtrupthi*. Thuhet për dikë që nuk tregohet i kujdesshëm dhe hyn në një problem pa e gjykuar shumë. *Mos shko kamtrupthi. Filani gjith herësh kështu ka shkuar, kamtrupthim. Mos shko ku të çojnë këmbët.*
- ***Pallajermas***. Nga *jerm*, në tym, kuturu, me përforcim emocional (*si pallë*). Thuhet për dikë që s'tregohet i vëmendshëm, që nxitohet. *Ke shkuar pallajermas*.
- Çilu ***gjur e*** çilu ***dru:*** Çilu *gur'* e çilu *dru*. Thuhet për dikë që nuk flet: *Ai* çilu *gjurë* e çilu *dru*. Nuk e hap gojën.
- ***Hije e duk:*** Híje ***dūk, kllájk*** e trúp: *Hije e duk, kllajk e trup*. Kjo shprehje përdoret për të treguar dikë që në pamje është mjaft i paraqitshëm, por në fakt kur ta njohësh nga afër të lë shije jo të mirë. Ka hije (hijeshi) e duk (pamje), *fuqi e trup*. Për fjalën *kllajk* (fuqi), nuk gjejmë burim.
- ***N'kashtë e n'kallajë / beq e zotnajë:*** *Në kashtë e në kalli beg e zotëri*. Thuhet për dikë që ka vetëm pamjen e jashtme.
- ***Bie fjala e*** çet***' fjalën:*** *Bie fjala e nxjerr fjalën*. Kjo shprehje përdoret në bisedë kur dikush kërkon të ndërhyjë apo të zhvillojë mendimin sipas një teme që preket në bisedë.
- ***E pret maj kallajë:*** *E pret mbi kalli*. Thuhet për dikë që flet pa u menduar.
- ***Si hëxha, xhemati:*** *Si hoxha xhemati (besimtarët)*. Njësoj me *si peni, gëzofi*.
- ***Hasmi i kosharit:*** *Hasmi i kosharit*. Thuhet për një kafshë shtëpiake që nuk kryen asnjë pune, përkundër të ushqyerit me misër. Kjo njësi përdoret edhe për dikë që nuk kryen punë dhe vetëm ulet në sofër.
- ***Shiçir si diç beba e m'la sahatin e unuerin, Shíçir*** sí díç ***béba e m'la*** sáhatin e únuerin***:*** *Shyqyr që vdiq babai e më la sahatin e unorin*. Përdoret për të treguar dikë që zë ose mezi pret të zërë vendin e dikujt.
- ***I erth n'rruk:*** *I erdhi në rrung* ... për ta gjuajtur kiklën, topin. Njësoj me *i erdhi në çark*.
- ***E thau n'kanar:*** *E thau në kandar*. Shprehje që lidhet me një anekdotë popullore. Dikush deshi t'i shiste lesh të lagur dikujt në pazar. I thanë atij që po e peshonte: kij kujdes, se leshi është i lagur. Dhe ai u përgjigj: nuk ka gjë, e *thaj n'kanar*. Thuhet për dikë që ta hedh me shkathtësi.
- En kashnajk': End kashnikë, end shajak. Thuhet për dikë që bën lëvizje të kota, lart e poshtë, që shkon e vjen si shuli ndër liq në endjen e kashnikut. Kam enë (endë) kashnajk nja dy orë dhe pastaj ika.

FJALË TË RRALLA

- ***bushtaj':*** Quhet kështu një vend me shkurre të dendura, që s'kalohet dot, duket *pyll bushi, bushtaj*.
- ***berres:*** Një *varre* prej druri që shërben për të thyer plitat e arës. Ndoshta nga *bjer e rreh*.
- ***bgjajnt'(i/e:*** *I pistë, i fëlliqtë*. Pushka në gra është *pushkë e bgjajntë*. *S. K. i delshin rranjt' / Se ka shtaj' ni pushk' t'bgjajnt'* (pop.). Më është *bgjajë kryet*. Në burim nga lat. *paganus, pagan*, i pakrishteruar. Te Buzuku: *i bëgamë*.
- ***bullesk':*** Një grua e shëndoshë. Në të folmet veriore: *bullë*: *As jam bullë, po jam e kshtenë* / Veç fatkeqe *paskem kenë* (Shkodër). Këtu, me zvogëlim.
- ***bren':*** *Brenë, branë*, lesë për të shkriftuar tokën e pluguar, trinë druri. Një shalcë druri druri e thurur me thupra shkoze dhe që shërbente për të thyer plitat në arat e përgatitura për mbjellje. Përd. dhe figurativisht: *e ka brenuar, e ka rrafshuar* këtë problem; edhe me kuptimin e *ka shtypur* dikë.
- ***brezhd':*** Brazhdë, brezhdë, aq ujë sa duhet për të ujitur. Njësi matëse për *vaden - ditën e ujit*: zakonisht një brazhdë kishte 20-24 litra ujë në sekondë: *kemi shti katër brazhdë ujë për vaditje*. E njëjta në burim (të dyja të ardhura nga sll.) me *brazdë, brazdat*, që Çabej e referon te *hulli***.**
- ***burosk':*** Arkë në të cilën mbahej kripa. Çabej sjell formën *boskë*: *Kral Pashiqi, kraje buroskë* / *Për tefna ka dalë n'Hinoskë* (pop.).
- ***bram:*** Çfarë mbetet në formë lënde nga shkrirja e gjalpit. Për më shumë shih edhe Çabej[234].
- ***bulegj:*** Një tufë flokësh që u lihej fëmijëve në ballë kur qetheshin, *kreshtë, krep*. Në *bulegj* vihej edhe ndonjë pare apo varg me rruaza për t'i mbrojtur nga syri i keq. Çabej e afron me fjalën *bele*, që do të thotë *nishan, shenjë*.

ANEKDOTA E MUAJIT

ME KREJT NUK BAN ME U ZANË

Shkon njëherë ndrikulla tek kumbara, ku po i ankohet se nuk shkonte mirë me njerëzit e shtëpisë.

- Kam një vëlla, kumarë, por me thënë të drejtën si vëlla të vetëm që e kam nuk po shkoj mirë hiç, nuk më respekton sa duhet dhe, e di, fajin ma ka vëllai jo kunata.

- Ndodh, moj ndrikull, ndodh, por bëj durim se ku dihet se çfarë halli ka dhe vëllai yt, - ia ktheu kumbara.

- Po kam dhe dy kunata në shtëpi, bre kumarë, bo bo bo si janë, nuk durohen fare. Shamatë bëjnë me mua dita-ditës.

- Po helbete, kunata janë, moj ndrikull, çfarë do presësh ma shumë prej tyre, - ia ktheu kumbara.

- Po dhe me djalin nuk shkoj shumë mirë, bre kumarë. Edhe ai grindavec i madh, një e dy mua më flet.

- Aaaa, kështu nuk bën ndrikull, jo kështu me u zanë me të gjithë, - ia ktheu kumbara.

(Sh.Skarra)

LEGJENDA

Plaka në bjeshkë

Nga **SHAQIR SKARRA**



Legjenda e bukur e plakës në bjeshkë ka bredhur në të gjitha viset shqiptare. Tregohet në Jug e në Veri. E nuk ka se si të shpëtojë Dibra pa këtë legjendë vërtet të bukur, e cila në vetvete tregon vetë gëzimin që tregonin njerëzit për ardhjen e pranverës pas një dimri të gjatë e të ftohtë.

Tregojnë të moshuarit se në kohë të hershme dhe dimrat kanë ardhur mjaft të ftohtë, me reshje e ngrica akulli. Njerëzit mbylleshin brenda qysh me ardhjen e vjeshtës.

Bagëtitë qëndronin në ahur dhe kështu njerëzit ishin të detyruar të siguronin ushqim jo vetëm për vete, por dhe bagëtitë për muaj me radhë. Të gjithë e prisnin me padurim pranverën, këtë stinë të begatë. Ai vit kishte ardhur me një dimër të ftohtë, borë të shumtë dhe ngrica. Reshjet e borës kishin filluar qysh në vjeshtë. E megjithatë pranvera kishte filluar të vinte edhe pse pak e vonë, si i thonë fjalës.

Lulet kishin çelur dhe bora sapo kishte filluar të shkrinte edhe majë maleve. Megjithatë, asnjë nga fshati nuk guxonte të ngjitej lart në bjeshkë me bagëti, edhe pse ushqim ma nuk kishin. Të gjithë i ruheshin ndonjë të ftohti të madh. Fundja dhe shprehja "kërcuna e madhe, ditën e Shëngjergjit" kishte një domethënie të madhe.

Vetëm një plakë e vetme pa njeri tjetër në shtëpi, nuk po i besonte kësaj thënie të hershme. Ishte një plakë mjaft zevzeke, saqë nuk pyeste njeri në fshat e gjithmonë bënte në kokë të vet. Kur marsi kishte vetëm dy a tre ditë e do t'ia lironte vendin prillit, plaka mori delet, i vuri para dhe u nis për në bjeshkë.

Delet filluan të kullosnin nga pak ndonjë fije bari, i cili sapo kishte filluar të shpërthente e plaka me furkën në dorë duke tjerrë lesh, ironizonte marsin:

- Aha tani nuk se çfarë të më bësh. Ma more të keqen. Kaq e pate! - shfrynte plaka.

Ishin fjalë të rënda këto të plakës për marsin, por e vërteta kështu ishte. Ai nuk kishte më forcë. Edhe pak ditë e ia lëshonte vendin prillit, i cili kishte filluar të trokiste. Zemërimi i kaloi caqet se plaka po bëhej e padurueshme se rrinte sa rrinte e tundte furkën nga qielli, sikur i thoshte marsit:

- Aha, hike o i shkretë, kaq e pate takatin e fuqinë!

Marsi duroi sa duroi dhe iu kthye prillit me të lutur:

"Prajll, o im vëlla, / më jep nja tre dit hua, / ta ngrij plakën me gjithë çka!"

E prilli e dëgjoi lutjen e marsit. Nuk vonoi shumë e qielli u nxi e shkreptimat ia nisën në bjeshkë. Pas pak ia nisën shtruar-shtruar të bien flokë dëbore. Nuk zgjati shumë e bjeshka u mbulua me borë. Plaka u fut poshtë deleve të mbrohej nga i ftohti i madh e delet ishin bërë grumbull bashkë. Nuk qëndroi me kaq inati i marsit. Filloi edhe ngrica e një erë e fuqishme që shkulte dhe drurët nga vendi e jo më plakën. Inati i marsit ra vetëm kur pa se plaka me gjithë delet ishte ngrirë kallkan.

Marrë nga vëllimi "Gurrat e Korabit", Botimet "Email", Tiranë 2012

Dr.ing. Orhan Akil Sakiqi vjen me librin e ri:
"Kronikë e jetëve të humbura"

Kronikë e disa jetëve të humbura

Nga **SULEJMAN MATO**

Sapo mbarova së lexuari një libër me disa tregime befasuese dhe mendova të hedh sa më parë në letër mbresat e mia të para. Tregimet e këtij libri, siç thotë dhe vetë autori, janë mbresa të ruajtura gjatë në memorie e që na jepen me një freski dhe profesionalizëm admirues.

Libri hapet me tregimin "Kolevica kundërshton diktatorin", kushtuar inxhinier Kolevicës, mikut tim poet, me një hije të vjetër trishtimi në sytë e tij të kaltër... Ata që nuk e kanë njohur inxhinier Petraqin, le të lexojnë tregimin e Orhan Sakiqit, i cili trajton një çast ku personaliteti i tij shfaqet në përballje me diktatorin e kohës.

"Mendova që këto tregime t'i përmbledh në një libër për t'i pasur personazhet e mi së bashku, - thotë autori, - pasi vitet shkojnë dhe brezat e rinj duhet të mësojnë nga e kaluara e hidhur". Personazhet e tregimeve janë të vërtetë, - thotë autori, aq të vërtetë, sa ai i ka hedhur në letër jo vetëm kujtime, por edhe emrat e tyre janë të vërtetë. "Nuk kam shtuar asgjë për ta bërë më tërheqës ndodhinë, - thotë autori,- fjalët e tyre të thjeshta janë më bindëse se çfarëdo ilustrim që mund të bëja."

Tregimi që pason, "Ne i heqim, ju i merrni", sipas autorit është nga të paktët tregime bazuar në fjalët e nënës. Ajo e përsëriste shpesh këtë ndodhi, si më e vështira e jetës.

Tregimi "Veza me dy të kuqe" ka një dramë e vërtetë. Të punoje me shpirt, në atë kohë, në respekt të profesionit dhe të kolegëve, dhe më pas të shpërblehesh me frazën. "Sado të punosh, 'biografinë' nuk e përmirëson.''

Personazhi tjetër, është Grigor Zaharia, një i burgosur politik, i urtë dhe i dashur me të gjithë, i cili mbeti në morgun e spitalit derisa doli bamirësi Lulzim Brahja për t'i bërë shpenzimet e varrimit.

Varri i Jorgji Memës gjendej në oborrin e shkollës "Kristoforidhi", shkruan autori. Atje, pranë kufomës së tij, kemi luajtur e mësuar. Atje ai u vra dhe u varros në një kohë me babanë e autorit.

Enveri dhe Skaharim Beqiri ishin dy miqtë e autorit. Njëri intelektual, djalë beu dhe patrioti, tjetri fshatar, ish partizan dhe ish komunist. Bisedat e tyre gjithë humor tregojnë falsitetin e regjimit.

Rexhep Jella dhe Fehmi Beshiri, njëri politikan karriere, tjetri politikan, të dy patën një përfundim tragjik.

Të tillë janë dhe personazhet e tjerë të tregimeve të Orhan Sakiqit, të vërtetë gjer në detaje.

Nganjëherë realiteti është më ireal se fantazia e poetëve, thotë një shkrimtar. Personazhet e këtij autori, edhe pse realë gjer në imtësi, i bën irealë koha ireale, kur kanë jetuar dhe punuar.

* * *

Orhan Sakiqi vjen nga fusha e inxhinierisë, kështu që nuk ka reminishenca, as eksperiencë nga shkollat letrare. Temat që ai trajton , personazhet dhe konciziteti i të treguarit na jep të drejtën të themi që Sakiqi futet në letërsi me një origjinalitet të vet. Sakiqi i qëndron besnik idesë se M. Kunderës kur thotë: "Çdo shkrimtar pi ujë në pusin e vet". Pusi ku e mbush kovën Orhan Sakiqi gjendet në Tiranën e vjetër, në Tiranën e viteve të para të çlirimit. Atje ai i ka njohur personazhet e tij dhe temat që ai trajton në këtë libër, modest për nga faqet por i rëndësishëm për nga prurjet e atyre viteve nga burojnë.

Një ndër tregimet më të bukur është "Koha e triksave". Në këtë tregim të bën përshtypje përshkrimi i imët i personazheve dhe dhënia me besnikëri e atmosferës së kohës. Autori, edhe pse shkruan thjesht, personazhet i vizaton me tiparet më të qenësishme. Kjo gjë vjen nga njohja e personazheve. Këtë veti e gjen te shkrimtarët me përvojë, të cilët nuk i anashkalojnë ato detaje të rëndësishme që përbëjnë karakterin e personazhit, as disa hollësi që tregojnë njohjen e lëndës

Ja si e përshkruan autori Hamdiun.

Hamdi Dizdari ishte komshiu ynë. Kishte qenë tregtar i suksesshëm, me dyqane e shtëpi, sigurisht të shtetëzuara mbas 1944. Tani ishte kthyer në karrocier, që na sillte



drutë e zjarrit. I jepnim triskat e druve dhe ai me karrocën e tij na i sillte në shtëpi. Kjo na kursente kohën për të shkuar në fushën e baltosur të druve. Z Hamdi, - siç i thërriste nëna, ishte një burrë i gjatë, i shëndoshë, faqekuq, mbante një kapele të vjetëruar republike, rripin poshtë barkut të fryrë, xhaketë të shkurtër meshini dhe çizme gome të Durrësit, që i jepnin një pamje groteske midis një karrocieri dhe një tregtari.

Me karrocë e kam filluar tregtinë, thoshte, dhe tani përsëri erdha te ajo, dhe qeshte me gjithë zemër. Kalin e mbante 'dritë', i shndriste qimja me zilka dhe mburojë sysh ai dukej si kalë garash sportive.

Mbasi sillte drutë Hamdiu, vinte Selmani. Një burrë i imët, me mollëza të dala, i parruar dhe i pafjalë, me sa lehtësi e çante trungun e madh duke i dalur damarët. Pazari dihej 100 lekë dhe dreka. Punoj thoshte dhe jo keq. Kishte hallin e triskave ...

Triska ka qenë një fletë e vogël e ndarë në lata, ku shënohej sasia e ushqimeve, e druve, e qymyrit, e artikujve të veshmbathjes etj. Fjala triskë nuk na u nda gjithë jetën.

Me të në dorë paraqiteshim çdo dite te dyqani i bukës, një herë në dy javë te dyqani i ushqimeve, një herë në muaj në fushën e druve, diçka me rrallë te ai i veshmbathjes. Triska e bukës ka qenë një fletë me përmasa 7x7cm, sipër shënohej emri dhe poshtë ishin datat e muajit, që quheshin lata. Radha për burrat mbahej për një dhe fillonte nga Teatri Popullor gati 150 m. Nga ana tjetër ishin gratë, në mes hynin pa radhë familjet e dëshmorëve.

U zgjata pak me citimin e këtij përshkrimi, pasi shumë prej nesh i kanë harruar ato kohë ku njeriu varej nga triska. Ka qenë një kohë e vështirë, në të cilën, nëse humbisje triskën, përfundoje në rrugë.

Një portretizim tjetër, tepër origjinal dhe i besueshëm, i është bërë E.Hoxhës te tregimi "Skaharimi dhe Enveri". Enveri, një njeri i thjeshtë, punëtor, i cili shërbente si ndihmësbanakier. Ishte i gjatë, me faqe e hundë të kuqërremtë, me flokë të rëna, ku mezi dallohesin disa fije, me mustaqe si të Taras Bulbës. Nga hunda e kuqe dallohej se nuk ishte pijetar, por pijanik i thekur, edhe për vetë sjelljen e tij. Mësuam se shërbente aty vullnetarisht, për të kthyer ndonjë gotë ose kur nuk i jepej kjo mundësi të thithte erën e alkoolit.

Po kaq interesant është dhe Skaharimi, rulisti...

Në këto tregime të bën përshtypje moria e detajeve jetësore dhe lakonizmi. Autori shkruan shkurt, fare shkurt. Sikur të kishte parasysh thënien e Çehovit: "Shkruaj e shkurto! Shkruaj e shkurto!"

Autori shkruan jo vetëm shkurt dhe saktë, por edhe qartë, ai hedh në letër vetëm më të rëndësishmet, të tjerat ia lë lexuesit t'i mendojë ... Duke vazhduar leximin e tregimeve të tjera si, "Veshi te dera","Ali Ndroqi..""Dy shokë" "16 nëntori", "Koha as vjen as shkon", "Bariu" etj., bindesh se te tregimet e Orhan Sakiqit të gjitha këto veçori nuk janë një rastësi, por një kërkesë e brendshme, e kuptuar me intuitë, lexuesi do vetëm fakte dhe jetë, personazhe të veçantë, por edhe thënie të autorëve të huaj, të cilat hidhen në letër në vendin e duhur dhe në kohën e duhur.

Historia e fëmijës Sakiqi ishte e projektuar qysh paralindjes, Tregimi "Krushqia me familjen Sakiqi" e ilustron më së miri këtë ide. Tregimet e Orhan Sakiqit sjellin ca të vërteta të thjeshta e të qenësishme. Janë kujtime të ruajtura në memorie, të cilat i lidh fakti që personazhi i tregimeve ka lindur në një familje intelektuale, e që ka njohur peshën e diktaturës qysh në vitet e fëmijërisë. Kudo ndjehet kjo shije e hidhur. Jeta pa baba do të rëndonte mbi supet e një fëmije me prirje të veçanta intelektuale.

Mbresëlënës dhe origjinal është dhe përshkrimi i drejtorit të shkollës te tregimi "Fëshfëshet", kur e thërret për të hetuar se nga i kishte ardhur ajo fëshfëshe.

"Mbante gjyslykë me numër shumë të madh, që bënte që sytë e tij të zmadhoheshin, – shkruan autori. - I shkurtër, i shëndoshë, me flokë të rëna në ballë që qarkoheshin me flokë të bardha anash, veshë të mëdhenj, sikur donin të dinin gjithçka."

Por, në këtë botë plot vështirësi kishte persona që u qëndronin pranë dhe u jepnin kurajë për të ecur përpara në jetë. I tillë ishte Fehmi Beshiri, djali i tezes së nënës.

"E mbaj mend, - tregon autori, - në dimër me një pallto të madhe të gjatë deri në fund të këmbëve, ndërsa në verë gjithmonë me xhaketë. Sa vinte, i hapte dollapët, shihte poshtë tavolinës se mos kishte ndonjë 'hafije' pastaj fillonte të shfryhej. Kishte studiuar në Bolonjë dhe në Vjenë dhe kishte një ide të qartë se çfarë është dhe çfarë përfaqëson në thelb teoria dhe praktika komuniste."

Këto bindje të tij nuk e shpëtuan nga burgu, së pari në vitin 1950, për agjitacion dhe propagandë, së dyti, në fillim të viteve 60-të.

Një vend më vete zënë tregimet nga jeta e autorit si inxhinier ndërtimi. Me një modesti të veçantë autori tregon disa punë të tij ndërtimore, të cilat kanë lënë gjurmë në jetën e kryeqytetit. Është rasti këtu të kujtojmë se Tiranën tonë të bukur e kanë projektuar disa inxhinierë të zot, por në ndërtimet e saj kanë derdhur djersën dhe kanë lënë jetën të burgosurit politikë.

Te tregimi "Historia janë ata", autori tregon se si në dhjetëra vepra ka qenë dora, djersa dhe sakrifica e të burgosurve. Le të kujtojmë: Aeroportin e Rinasit, dy stadiumet ("Q.Stafa" pjesërisht) dhe kompleksin sportiv Dinamo, Kombinatin ushqimor, Kombinatin e mishit dhe të qumështit dhe qindra apartamente banimi.

Duke lexuar tregimet e këtij autori na dalin para sysh shumë intelektualë të njohur të luftës dhe të jetës ndërtimore, dhe të tjerë, njerëz të thjeshtë, të përshkruar me dashuri dhe kujdes, të gjithë të përkushtuar në punët e tyre, të cilët i harroi koha, por nuk i harron kujtesa e shkrimtarit.

Në një nga tregimet e këtij libri, "Komandanti", ku autori flet për punën ndërtimore në Elbasan, ai tregon se midis nesh kishte dhe trima si Mehmetaliu, i cili e mori vdekjen në sy, duke treguar të vërtetën për E.Hoxhën, por ishte dhe solidariteti i atyre që nuk e hapën gojën për ta denoncuar.

Pa dashur të zgjatem në analizën e mëtejshme edhe të disa tregimeve të tjera, duhet të them se leximi i këtij libri me tregime ishte për mua një surprizë e këndshme. Autori Orhan Sakiqi, që pas viteve nëntëdhjetë do të bëhej një personalitet i politikës shqiptare, me profesion inxhinier. Ka dhe një talent të spikatur në letërsi dhe është pikërisht mundi dhe përkushtimi i tij për të na dhënë të gjalla mbresa të jetës së të tij dhe të njerëzve që i ka njohur.

Ka qenë një detyrim i heshtur i autorit, për të mos u harruar ato ngjarje dhe fakte nga jeta në diktaturë... E them me bindje se autori këtë detyrim të heshtur e ka realizuar me sukses. Edhe sikur një milion fjalë demaskuese të themi për diktaturën, ato nuk do të na linin mbresat e thella të një kohe mizore, e cila përbuzi, persekutoi dhe syrgjynosi qindra e mijëra intelektualë të ndershëm e patriotë të përkushtuar ndaj atdheut, të cilët e kuptuan qysh në gjenezë të keqen komuniste.

S'më mbetet gjë tjetër veçse ta falënderoj autorin për ndriçimin e një kohe, qëllimi i saj është, siç thotë dhe vet autori në parathënie, "brezi i ri duhet të mësojë diçka nga kjo e kaluar e hidhur."

Janar 2019

"Një jetë maleve",
Kujtime 2, me autor
Bashkim Lleshin



Në këtë libër përshkruhet aktiviteti i inxhinierit gjeolog Bashkim Lleshi në Gjeologjinë e Bulqizës në vitet 1969-1976, në fillim në Ekipin e Lurës të Ekspeditës gjeologjike të Peshkopisë e më vonë në Ekspeditën gjeologjike të Bulqizës, përpjekjet si gjeolog i ri në vendburimin e kromit të Bulqizës dhe më vonë si kryegjeolog i kësaj ndërmarje. Në faqet e këtij libri pasqyrohet puna shumë të madhe që është bërë në ato vite për kërkim zbulimin e shfrytëzimin e mineralit të kromit në vendburimet e Bulqizës, Batrës, etj. dhe mineraleve të tjerë të dobishëm në rethet e Dibrës e tw Matit. Përshkruhet jo vetëm puna e madhe e bërë në Ndërmarjen Gjeologjike nga kolektivi i kësaj ndërmarje por edhe interesimi i madh i organeve të Partisë e të Pushtetit në rreth e në qendër për realizimin e detyrave për kërkim zbulimin dhe shfrytëzimin e mineralit të kromit i cili për nga rëndësia vinte pas naftës në zhvillimin e ekonomisë tonë kombëtare.

Për të pasqyruar këtë punë të madhe autori i librit ka shfrytëzuar ditarin e tij personal duke i pasqyruar pothuajse të gjitha aktivitetet e kryera në ndërmarje e ministri, aktivet e ndryshme të organizuara nga organet qëndrore për kromin, takimet, mbledhjet e analizat e punës mujore, tremujore, 6 mujore e vjetore për realizimin e detyrave, përpjekjet e bëra në organizatat e masave të Rinisë e Bashkimeve profesionale dhe analizat e kryera në drejtori e në organizatat bazë të Partisë për realizimin e tyre, duke dhënë edhe detaje të kryerjes së këtyre aktiviteteve në kohën kur janë zhvilluar, pjesëmarrësit dhe problemet që janë diskutuar, pa shtuar dhe interpretuar asgjë, që lexuesi të marrë njoftim për punën e madhe që bëhej nga Ndërmarja e Rrethi deri në Ministri e Qeveri për realizimin e detyrave të planit të kërkim zbulimit e shfrytëzimit të mineralit të kromit dhe mineraleve tjerë të dobishëm të rretheve Dibër e Mat, si dhe përpjekjet e mëdha për rritjen e planit të prodhimit të kromit, sidomos të Minierave të Bulqizës e Batrës ku realizohej mbi 70% e prodhimit të kromit në shkallë kombëtare, i cili në vitet shtatëdhjetë i kaloi mbi 1 milion ton në vit.

Në fund përshkruhet puna e madhe e kryer në Seksionin e Industrisë në Komitetin Ekzekutiv të KP të rrethit të Dibrës për realizimin e detyrave të Ndërmarjeve të Industrisë së rëndë e të lehtë të këtij rrethit, si dhe mbështetja e madhe e organeve të Partisë e të Pushtetit në rreth për realizimin e këtyre detyrave, duke arritur që për herë të parë në vitin 1977, të plotësohen detyrat e ndërmarjeve të industrisë së rrethit në të gjithë treguesit.

cyan magenta yelloë black

intervistë

Një bisedë me shkrimtarin Agron Tufa është gjithnjë shumëdimensionale, janë angazhimet dhe ritmi i jetës së tij, që e diktojnë këtë: shkruan prozë, poezi, përkthen me po aq intensitet sa ç'përpiqet të krijojë një mundësi komunikimi mes lexuesit dhe autorëve të tjerë, sidomos bashkëkohorë, të gjeneratës të tij. Është ndër shkrimtarët e parë të pas '90-s i cili theu kanonet skematike të realizmit socialist, që e vazhdoi letërsinë si vokacion e ndërgjegje intelektuale, bashkë me detyrat "politike" në zbardhjen e krimeve të komunizmit, në krye të Insitutit të Studimeve të Pasojave dhe Krimeve Komuniste, reflektuar në botimet që dëshmojnë e rrëfejnë diktaturen

AGRON TUFA: Historia e letërsisë sonë më mirë të mos shkruhet njëherë

Sepse është e sigurtë që do të manipulohet, cilidoqoftë kriteri, qasja, metoda. Përsëri do të thirreshin kumbarët e kumbareshat, xhaxhot e byrazerët, nunat e ndrikullat që i prekin thuajse të gjitha punët, duke i ndotur ato. Le të presim them dhe nja 20 a 30 vjet të tjera... dhe le t'i bëjnë këto detyra të tjerë njerëz, të shpëlarë nga zgjyra e shijes, koniukturat, hatëret e tarafet. Ne e kemi humbur besimin. Dhe akoma më keq: kemi humbur respektin për punën e tjetrit. Dallojmë veç të zezën tek përpjekja e tjetrit. E nëse nuk ka të zezë, e nxijmë vetë më zi se kukudhi.



Një peisazh letrar kombëtar, pa infrastrukturë, si i yni, nuk të lejon të shohësh vlerat e vërteta. Janë vite të gjata këto dhe gjendja ka ardhur duke u përkeqësuar. Infrastruktura letrare është sociologjia e komunikimit me lexuesin. Janë revistat, periodikët, almanakët dhe gazetat javore. Të gjitha këto media letrare, që tek ne mungojnë, duhet të jepnin një dinamikë të komunikimit. Ne jemi një kulturë pa revista, pa gazeta. Pa Festivale Letrare. Pa studio me emisione të posaçme, që t'i kushtohen cilësisht artit letrar. As rubrika të librit. Por edhe kur kanë qenë në ndonjë TV të madh, të kallte krupën era e qokave.

Intervistoi: **VIOLETA MURATI**

- Ndonjëherë ia vlen të niset nga e para, ku kujtesa mban ngjarjet më të rëndësishme të jetës, e në rastin tuaj atë të shkrimtarit: cilat kanë qenë kujtimet tuaja me të para ala prustiane?

Agron Tufa: Ndoshta ka vlerë për gjithkënd vargu i T.S. Eliot në poemën "Katër kuartetet": "Në fillimin tim është fundi im" (dhe anasjelltas). Në rastin tim nuk mendoj se ka ndonjë gjë të pazakontë. Fëmijëria, adoleshenca dhe rinia e parë kaloi në një nga provincat me të humbura verilindore të Shqipërisë, treva e Kastriotit të Dibrës, në një familje krejt të zakonshme fshati. Me vëllezër e motra, nënë, gjysh e gjyshe. Kozmosit shtëpiak i mungonte një njeri i rëndësishëm, që përmendej shpesh nga të rriturit, por nuk ishte i pranishëm fiziksht: im atë. Me kohë u mësuam, derisa ai u kthye nga burgu politik i Spaçit, kur unë isha 9 apo 10 vjeç. Në kujtesën time kanë mbetur perceptimet dhe qëndrimet e ndryshme që mbanin njerëzit jashtë shtëpisë ndaj nesh dhe familjarët brenda shtëpisë. Jashtë, me kohë, kemi dëgjuar të na thërrasin (ndër to edhe ndonjë mësues) "reaksionar", "bir i armikut të partisë e të popullit", ndërsa brenda, sidomos gjyshja, sa herë qortonte, tundte gishtin e bënte apel: "dhe kurrë, kur mos harro, bir i kujt je!" Jashtë, në rrugë, në shkollë, na shihnin "ndryshe", aq sa një ditë të zakonshme shkolle të klasës së parë e kuptova shkakun, kur një bashkëmoshatare, e nxehur me mua shpalli, duke bërë një gjest dëbues me dorë: "iiiii, ik, ik, ik! Ju jeni 'të prekur'!". U trondita. Nuk e kuptoja se ç'kuptim kishin ato fjalë, ndaj sapo hapa derën e madhe të oborrit i thashë tim vëllai më të madh se unë: "Ylber, pse na quajnë ne 'të prekur'? A na ka prekur kush me duar me pis?". "Jo mor budallë, - ma preu ai, - na quajnë kështu për shkak se baba jonë është në burg". "Po pse është në burg? Çfarë ka bërë?", - këmbëngula ta di. Im vëlla, që vazhdimisht gjuante një top llastiku duke e përplasur pas mureve të shtëpisë, mezi m'u përgjigj shkurt e thatë: "sepse ka qenë kundra!". Unë doja të di diçka më shumë se kaq, dhe e pyesja vazhdimisht të dija: "si ka qenë kundra?". Im vëlla vazhdoi të gjuante më me tërbim topin pas mureve, por kur pa se nuk i shqitesha, i la gjuajtjet dhe m'u kthye: "Ka folur kundra pra, bashkë me disa shokë... me ata shokë, sa herë inatoseshin me shtetin, mblidheshin fshehtas dhe flisnin kundra". "Po si e dinin ata se duhet të flisnin kundra?", - ka qenë pyetja ime e fundit. Por im vëlla, me sa dukej ishte shumë më i ndriçuar se unë, sepse m'u përgjigj: "Ata kishin një parrullë. I afroheshin njëri-tjetrit te puna dhe i thoshin të veshi: xhundra-bullundra, a flasim kundra?". Kjo përgjigje më bëri edhe më shumë konfuz, dhe nuk guxova ta pyes më; im vëlla i ishte kthyer gjuajtjeve të topit për mur me një furi të re.

Gjithmonë, jo se e kam vuajtur, por e kam ndjerë se, në lidhje me tim atë, kujtesa ime fillon pas ardhjes së tij nga burgu, kur unë isha relativisht i rritur. Ndjeja boshllëkun e peridhës para arrestimit. Motra dhe dy vëllezërit më të mëdhenj e mbanin mend, unë jo. Unë nuk i kisha mbushë tre vjeç, ndërsa vëllau i vogël, ferrishte në djep, s'kishte asfarë shansi ta mbante mend. Kështu e kisha lënë... por kujtesa ka kapriçot e veta. Sesi një ditë, në një nga qindra pasditet e shëtitjeve të mia, pas mësimit, në Institutin e Letërsisë "A.M. Gorki", ndërsa endesha nëpër rrugët e Moskës, filloi të më vizatohej në kokë një si tablo, e gjitha nën ndikimin e të kënduarit nën vete të një kënge të vjetër. Sa më fort merrja e rimerrja melodinë dhe fjalët e këngës, aq më e qartë bëhej tabloja, e mandej nisi edhe të lëvizë, si një kuadër i stërvjetëruar filmi. Kur dola në krye të rrugës ku hapej sheshi "Patriarshie prudi" (Gjolet e Patriarkut), hyra në barin e parë me pamjen që shihte në një pistë akulli ku luhej hokej. Ishte diçka fare pa lidhje pamja që kisha përballë, përtej xhamave, disi të avulluar, dhe tablosë që kishte ndaluar në kokën time. Sërish motivi i këngës dhe tabloja e marrtë nisi të kjarohej, madje të lëvizte. Një gjysmërreth burrash me kësula, të ulur këmbëkryq në sofër, ndanë zjarrit të oxhakut, kokat e të cilëve projektoheshin në murin kundruall nën dritën e butë të dy llampave me vajguri, ndërsa në anën tjetër të sofrës, përballë burrave, qëndron tek, një burrë tjetër, me kësulë e mustaqe të holla spic. E njoh: ai është im atë. I bie çiftelisë dhe këndon për njëfarë Mahmud Daci. Është pikërisht kënga që këndoja nën vete atë pasdite shëtitjeje dimërore. Një këngë trimërie, pabesie dhe amaneti. Ndërkohë që i bie çiftelisë dhe këndon, ka në fytyrë një shqetësim, një bezdi, ngase fëmija që vrapon rrotull nëpër dhomë po ia prish solemnitetin e këngës, duke lëshuar gjithë e më fort britma të forta: "E Daci, more Daci! Daci bre, Daci!", - i çuditur, me gjasë, se si mund t'i këndohej me aq përkushtim një maçoku, sikundër quhej maçoku në dialekt. Im atë ka rrudhur vetullat vertikalisht mbi hundë dhe kërkon me vështrim ta parandalojë fëmijën, t'i kanoset, por kalamani rrotullohet e bërtet, derisa i afrohet te vegla muzikore dhe ia kap. Atëherë i ati e zë për veshi, ia tërheq fort dhe e shtyn, duke i bërtitur: "përjashtë, edepsëz! Hyn në dhomë e ëma dhe e heq djalin prej andej.

"Kur ka ndodhur kjo?" – pyesja veten, - dhe "a është e vërtetë?" E fiksova përshkrimin e kësaj ndërmendjeje në letër, por nuk isha i sigurtë. Mos ndoshta është ndonjë kujtim i simuluar, një nga ato kujtime "mashtruese", një rreng i kujtesës nën ndikimin e ndonjë ëndrre? Por kisha nga ana tjetër një siguri, që ma jepte pamja e tim eti, instrumenti, vetullat e mbledhura vertikalisht. Kur ktheva për pushimet e verës e pyeta tim atë, sa i vërtetë është ky kujtim. Ai qeshi: "është krejt i vërtetë, nuk është rrenë. Burrat me kësula janë Allamanët e Matit, që kanë pasë ardhë miq, me rastin e hymjes në shpinë e re. Janë ata, me të cilët jam dënuar mandej në të njëjtin proces politik. Këngën e këndova pas darkës në shenjë nderimi, ndërsa llampat kanë qenë me vajguri, sepse ende nuk ishin kryer instalimet elektrike. Edhe veshin ta tërhoqa se ma prishe qejfin e këngës së Mahmud Dacit". U ndjeva shumë mirë. Kisha mundur të riktheja një kujtim, para se baba im të arrestohej. Kisha zgjeruar mbretërinë time të kujtesës, duke e bërë atë të pavdekshme. Dhe dihet se kujtesa është e vetmja që lidh skajet e identitetit të njeriut. Këtë gëzim e ngazëllim ndjejnë dhe personazhet e Marsel Prustit, kur i luftojnë Harrimit copëza të vogla nga përjetësia e kujtimeve.

Si ka nisur ideja, shkrimi, botimi i parë...? Si e zbuluat zërit tënd?

A.T: Kam qenë një lexues i magjepsur nga librat. Leximin e kam nisur nën ndikimin e vëllait të madh. Ai lexonte libra të trashë, kur unë ende nuk dija të lexoj, por kur e shihja të veçuar, të shtrirë përmbys tek lëvrinte në heshtje buzët, i përpirë nga ato mistere të veshura me shkronja, e ndjeja veten të privuar rëndë. Im vëlla më tregonte ndonjë histori dhe unë ua tregoja moshatarëve të mi, duke i zbukuruar shumë ato. Pastaj vetë, shumë shpejt, krijova një varësi të tmerrshme nga leximi. Një varësi e cila krahasohet me atë të duhanxhiut, alkoolistit apo të narkomanit. Kjo ishte ana e keqe, sepse në shtëpinë tonë të varfër, nuk kishte libra. Kështu, që për t'i siguruar ato, kam ndërmarrë një sërë aksionesh: grumbulloja shishe të boshatisura vaji, i laja me ujë të nxehtë me një shkop që kishte në majë një shtupë lecke me sapun dhe pasi i shisja, blija libra në Peshkopi, e më vonë në Kastriot. Një burim tjetër ishin vezët, që i mblidhja të shtëpisë, apo nëpër plevicat e lagjes. Sepse pula ta bën me dije kur lëshon vezën... Pastaj ka pasur burime të tjera: bimët mjekësore, grumbullimi i lekëve të dhuruara, shokët, më të rrallë në bibliotekën e shkollës, dhe kur nuk më kanë dhënë as në bibliootekë, edhe i kam vjedhur, duke qenë i ndërgjegjshëm se kjo aventurë është e dënueshme. Ëndrrat e mia të fëmijërisë, që kanë vazhduar gjatë (e ndonjëherë më shtiren dhe sot), janë parajsa bibliotekash të larmishme. Shkurt, një njeri që ka varësi të tillë nga leximi, heret a vonë do të shkruajë. Nuk kisha vendosur të bëhesha shkrimtar, por një ditë (duhet të kem qenë në klasën e gjashtë), më doli krejt papritur e solemnisht pohimi. - A ke menduar se çfarë do të bëhesh në jetë mor djalë? – më foli i pezmatuar im atë një pasditeje, kur pa se nuk e kisha fare mendjen në zejen që po më mësonte. Asokohe im atë mendonte t'i mësonte zanatin e marangozit, të paktën njërit prej nesh. Na e kishte thënë shpesh: "Ju shkollë nuk ju japin. Të paktën mësoni zanatin, se do të kalbeni në punët pa bereqet të kooperativës. Nuk do t'ju hiqen nga duart kazma e lopata dhe nuk do të bëni dy jaka bashkë". Nuk e di pse ma kishte vënë mua syrin si "marangoz i ardhshëm". Tash më vjen keq njëmend që nuk e dëgjova. Në Shqipëri, më besoni, është shumë herë më mirë të jesh marangoz, se shkrimtar. Po ja, që e humba këtë mundësi të artë... Pra, atë pasdite kur im atë më pyeti se "çfarë e ke ndërmend të bëhesh", i përqendruar në një radiodramatizim të romanit "Djaloshi zezak" të Riçard Rajt, pa e pritur as vetë, thashë: "shkrimtar!". Ka shumë gjasë që përgjigja ime të ketë qenë një nga replikat e ndonjë personazhi, por këtë më duhet ta verifikoj.

Megjithatë, pasi e thashë, vërtet mendova se s'ka gjë më të bukur se të bëhesh shkrimtar. Si nuk më paska shkuar ndërmend më parë?

- Si the, si the... ? – pyeti prapë im atë, që tashmë kishte lënë zdrukthin dhe më shihte i habitur, me duar në mes.

- Shkrimtar do bëhem... ke për ta parë, - thashë, sikur të ishte ky një kërcënim.

Nuk po e kuptoja. Im atë filloi të qeshë graflueshëm, në fillim pa zë, pastaj shpërtheu në një të qeshur, që nuk mu duk normale për atë, që qeshtë rrallë.

- Çfarë ka, - thashë. Por ai vazhdoi të qeshte. Ndalej e vazhdonte sërish.

- Shkrimtar! Posi... shkrimtar, zotnija jote! Shkrimtar si Gjergj Fishta?

Unë ngrita supet. Tani nuk qeshte më.

- A e di ti ku e kanë vendin shkrimtarët?

- Në libra... – thashë, i pasigurtë.

- Jo në libra! Ta them unë se ku, - tha, duke m'u avitur misteriozisht, me gishtin tregues ndër buzë: në burg! Kam pasur plot atje... shkrimtarë... Ishte njëri, i katandisur, vesveseli. Sapo i afrohej ndonjëri, bërtiste: "Iiiik! largohu! Të ka sjellë Sigurimi i shtetit!" Dhe askush nuk i afrohej. Tani më thuaj, çfarë shkrimtari do bëhesh? Se ka dy rrugë për shkrimtarët: o do të shkosh në burg, o do t'i këndosh Partisë. Ti në burg nuk do të shkosh, kështu?

Jo, nuk është ndonjë qejf i madh nga sa na ke treguar vetë...

- Atëherë do t'i këndosh Partisë... S'ke rrugë tjetër!

- Po mirë, e pastaj? – thashë i revoltuar.

- Pastaj!? Ti mund t'i këndosh Partisë, po a të zë besë kush...? Ta them unë, askush! Dhe kur nuk të besojnë, prapë në burg do përfundosh...

- Nuk e di.. Nuk e di, - mërmërita, - por unë do bëhem shkrimtar dhe pikë!

- Mirë, de mirë... ashtu e lëmë... po atë pikën, hiqe.

Unë kam shkruar, si shumë kush, në shkollën e mesme, nën ndikimin e rasteve, miqve të mi të ngushtë dhe nga ideja se mund të shkruaj më mirë nga sa botohej asokohe në shtypin letrar. Miqtë e mi, që gjithashtu ishin në fillimet e tyre, kanë qenë mbështetje e madhe. Sidomos miqësia me shkrimtarin Ramiz Gjini.

Në gazetën lokale të Dibrës nuk të botonin për arsye biografie, por botimet e vargjeve të para i kam pasur në gazetën lokale "Jeta e Re" të Shkodrës, ku redaktor i faqes letrare ka qenë shkrimtari Ridvan Dibra, me të cilin asokohe nuk njiheshim. Në shtator 1989 dhe 1990 kam botuar cikle të gjera poezish tek gazeta "Zëri i Rinisë", mandej dhe tek "Drita". Nuk mendoj se do të kisha botuar ndonjëherë në "shtypin qendror", pa ndihmën shumë dashamirëse e vendimtare të dy poetëve: Ilirian Zhupa dhe Preç Zogaj.

Mendoj se çështja e "zërit tënd", diksionit, nuk zbulohet menjëherë, sepse ai është një proces i vazhdueshëm, si i rritjes kulturore, aq dhe i përvojës me "zbutjen" e bishës së shkrimit. Sepse shkrimi është një bishëz e egër dhe ti duhet t'i avitesh me ëmbëlsinë e zbutësit, nëse do të të shërbeje me bindje e besnikëri.

(vijon në faqen 13)

Rruga e Arbërit nr. 155

intervistë

Qëllimi i këtij projekti me tre vëllime, "Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX", që shkon mbi 1000 faqe, shtrihet dhe përtej auditorit të studentëve, ngase synon një lexim të gjerë, intelektual, për gjithkënd që interesohet për letërsinë moderne të shekullit XX.

AGRON TUFA: *Historia e letërsisë*

Kurrë nuk kam thënë se Dibra ime ishte një vend ideal. As i mirë, as i keq. Ishte një vend vuajtje. Një trekëndësh Bermude i komunizmit shqiptar. Sigurisht është tjetër të flasësh për traditën, virtytet, zgjuarsinë, me të cilën Dibra ka krijuar një identitet të veçantë, por mos harrojmë: ishte një realitet persekutues. Me plot njerëz të ligj, përndjekës, që më mësuan të njoh, para së gjithash, mungesën e zemërgjerësisë, vogëlsitë, fanatizmin absurd politik, servilizmin, pabesinë...

(vijon nga faqja 13)

-Të ikim pak në kohë, pse keni zgjedhur të jetoni këtu? Në Shqipëri, në Tiranë...e rrallë po të shohësh se si në këto 30 vite liri të gjithë (pothuaj shkrimtarët e artistët) jetojnë në kryeqytet, kanë braktisur qytetet e lindjes.

A.T: Nuk është çështje zgjedhjeje. Është çështje infrastrukture: puna, mundësitë, kushtëzimi pastaj, pas krijimit të familjes, etj. Në fund të ciklit 7 vjeçar të studimeve të mia në Rusi (1994-2001), kisha mundësitë të mos kthehesha në Shqipëri. Kisha një vend pedagogu në katedrën e Europës Juglindore ku jepej gjuhë, folklor e letërsi shqipe në Institutin e Marrdhënieve Ndërkombëtare (MGIMO, Moskë). U ktheva në atdhe, si shumëkush tjetër, besoj, i ngarkuar me ëndrra, besim e shpresa për të dhënë më të mirën që mendoja se di të bëj. Kjo ka ndodhur gjithmonë, që nga fillimi i shekullit XX, deri në fund të Luftës së Dytë Botërore: intelektuali që kthehet të shërbejë natyrshëm në vendin e vet. Se, ç'kuptim ka? Pse e more gjithë atë shkollim? Ndjej se dhe unë i përkas një kategorie të tillë. Do duket pak si patetike, por nuk di si ta formuloj ndryshe, përveçse kështu: nuk është se na tradhëtuan ëndrrat, na tradhëtoi realiteti. Realiteti shqiptar është një gjë e tmerrshme, e pistë, mosmirënjohëse. Edhe pas kaq vitesh, shohim se nuk shterr së gurgulluari jashtë e keqja. Do thoja, një realitet i "zgavruar". Dhe çdo zgavër është e mbushur me helm, të depozituar ndër breza, kohëra e tradita. Nuk është pra, se na kanë tradhëtuar ëndrrat. Janë po ata. Dhe unë po ai: realiteti shqiptar do sforcim e përpjekje të madhe të ndryshojë, do aleancë njerëzish të dituar e idealistë. Do solidaritet. Dhe ndonëse jetojmë në një nga fazat më dëshpëruese, që nga koha e diktaturës, edhe pse shumica e shqiptarëve ka ikur e në mendje ka të ikë, prapë mendoj se ky vend do të ndryshojë për mirë, për të kapur ritmin e vet të natyrshëm, pavarësisht gjithë katalogut rekord të veseve e skrupujve politike, historikë e shoqërorë. Dhe besoj se ka shumë shqiptarë që mendojnë se ky vend mund e duhet të mbërrijë përputhjen e nivelit të natyrës dhe klimës që ka me nivelin e ndërgjegjes njerëzore. Ideale, sigurisht, do të ishte të jetoje në vendlindje. Atë e kam shtyrë si projekt, ndoshta për të kaluar pleqërinë.

Çfarë ka mbetur nga Dibra jote, vendlindja?

A.T: Thuajse asgjë. Por kurrë nuk kam thënë se Dibra ime ishte një vend ideal. As i mirë, as i keq. Ishte një vend vuajtje. Një trekëndësh Bermude i komunizmit shqiptar. Sigurisht është tjetër të flasësh për traditën, virtytet, zgjuarsinë, me të cilën Dibra ka krijuar një identitet të veçantë, por mos harrojmë: ishte një realitet persekutues. Me plot njerëz të ligj, përndjekës, që më mësuan të njoh, para së gjithash, mungesën e zemërgjerësisë, vogëlsitë, fanatizmin absurd politik, servilizmin, pabesinë, në një kohë kur varfëria ishte shokuese, kushtet e jetës tepër të rënda dhe shpresat nuk ekzistonin në horizont. Dibra ishte një vend skllav, e tëra bujkrobëri komuniste me feudalët e kuq lokalë. Tani ekziston një Dibër tjetër, e përçudnuar si



më parë nga varfëria dhe emigrimi. Nuk vuan për mbijetesë ushqimore, por nga lumpenizimi, papunësia, varfëria, mungesa e perspektivës. Me se e mbajnë veten gjallë ato banorë? Me çfarë shpresash? Dibra është një vend i izoluar, si më parë. I pasur në prodhime e burime, por krejt pa mundësi t'i konvertojë ato në mirëqenie. Një popull i keqpërdorur nga politikanë lokalë e qëndrorë, të cilët i shëmbëllejnë një bande fantazmagorike: është krijuar një marrëdhënie shitje-blerje midis popullit dhe politikanëve, çka ka çuar në një alienim ekstrem të njerëzisë, e cila përpiqet të mbijetojë...

Nga një poezi e fundit e juaja, me nënshkrimin Prishtinë, 2018 ndajmë vargjet: Koha e mahnisë mbaroi.../dhe flaka që digjet, nuk djeg... Reflektimi? Po mendojmë mbi disa procese, ide e vlera që vijnë bashkë me kulturën masive, modernitetin...

A.T: Simitituda që e mban këtë poezi është shumë e ndërlikuar dhe unë jam i pafuqishëm të shpik një gjuhë tjetër, që të mund të rivalizonte vetë poezinë. Referencat dhe asociacionet janë nga shkurrja e famshme biblike që digjet, e s'mbaron së djeguri, e cila i shfaqet profetit Moisi në kullotë. Pra është një zjarr që flakëron, por nuk i djeg degët e shkurres. Ajo është një formë e shfaqjes së Zotit dhe Moisiu grishet përmes asaj flake të çuditshme të avitet për të hyrë në lidhje me Hyjin. Poezia ime shenjon procesin e desakralizimit total, e zbrazjes së shenjave nga kuptimet e tyre, e zhvlerësimit dhe inflacionit të fjalës si taksonomi ligjërimi, e alienimit gazmor e argëtues të Babilonit të ri bashkëkohor, rrjedhimisht, dhe e blasfemive të reja.

A mund të flitet, sidomos nga një shkrimtar si ju, se në cilën fazë të krijimtarisë e vendos veten?

A.T: Mendoj se po. Por fazat nuk zgjasin me vite. Mendoj se është diçka tjetër dhe kjo është fryma e një radhe veprash, në të cilën ke përmbushur disa ideale artistike e estetike. Unë e konsideroj veten në prag të një faze të dytë tashmë, me idenë se ka, në dashtë Zoti, një fazë të tretë, të fundit.

Është një punë voluminoze dhe impenjative çfarë keni bërë me monografinë "Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX", ku po përgatiteni edhe për dy volume të tjera. Kur institucionet përgjegjëse ende nuk kanë nisur procesin e shkrimit të historisë letrare, pse një nisme e juaja, çfarë varianti parashtron ky botim?

A.T: Po, por kjo është një punë e drejtpërdrejtë, shumëvjeçare, me auditorin e Letërsisë në Fakultetin Filologjik të Tiranës. Janë leksione të përgatitura ngadalë, ngeshëm, përgjatë 15 vjetësh, jo në stilin e thatë të leksioneve pedante. Përgatitja e çdo leksioni

Lexuesit nuk duhet t'i dorëzohesh, por t'i imponohesh me cilësi e veprave që shkruan. Lexuesi duhet "magjepsur" me atë çfarë e mban gjallë, duhet tërhequr me magjinë e letërsisë së mirë, ku ai të gjejë veten, jetën e vet shpirtërore e mendore, dilemat dhe dëshirat që e bëjnë të ngrihet nga banaliteti i përditshmërisë. Lexuesit duhet t'i ofrosh librin që atë e madhon, e bën të meditojë e të trandet thellësisht, të shkundet, të preket e të zgjohet nga përtacia shpirtërore. Duhet t'i ngacmosh sedrën. Diç të ngjashme me atë që thotë një personazh i Orhan Pamuk: "Sesi një ditë lexova një libër, që e ndryshoi tërë jetën time"

përfundimtar ka hëngër mesatarisht nga 6 muaj lexime e shënime intensive rreth një autori. Ideja ka qenë që të kishte një tekst me tre vëllime për ta njohur letërsinë e huaj të shek. XX në frymën e saj, në proces e rrjedhë, nga zanafilla e modernizmit (simbolizmi), e avangadës dhe postmodernizmit. Tre paradigma artistike, që përfshijnë krejt shekullin XX. Vëllimi i tretë do të jetë antologji me manifeste, traktate, fragmente poemash, novelash, tregime, poezi, drama – si një pasqyrë e shkrimtarëve dhe poetëve nga letërsitë e ndryshme moderne të kulturave kombëtare të Europës dhe Amerikës e më gjerë. Kam menduar se me këtë projekt plotësohet një boshllëk tradicional për këtë lëndë, e cila në vitet e diktaturës reduktohej nga 2 deri në 4 autorë (Gorki, Majakovski, më vonë dhe Fadajev, Furmanov), të gjithë të socrealizmit sovjet. Në vitet '80-të u shtuan dhe Bertold Brehti e Hajnrih Bëli. Sigurisht, gjatë viteve '70 – '80 ka pasur leksione speciale dhe kurse për letërsinë "dekadente borgjeze", është folur dhe për Xhojsin, Kafkën, Prustin, Kamynë e Sartrin, por si, për demonë e përbindësha. Ideja ime ka qenë që, me shqyrtimin e krijimtarisë së mbi 20 autorëve (modernistë, avanguardistëm, postmodernistë), ta vë studentin shqiptar në të njëjtat pozita komode, sikur ai të ishte natyrshëm, në çdocilin auditor të universiteteve të Romës, Berlinit, Parisit apo Nju-Jorkut. Por qëllimi i këtij projekti me tre vëllime, që shkon mbi 1000 faqe, shtrihet dhe përtej auditorit të studentëve, ngase synon një lexim të gjerë, intelektual, për gjithkënd që interesohet për letërsinë moderne të shekullit XX.

Kam përshtypjen se rrëfimi i "sagave" familjare nën trysninë e diktaturës ka kaluar tek ne nëpër një proces të shumëllojshëm shkrimi. Mbaj parasysh tri romanet tuaja si "Mërkuna e zezë", "Tenxherja" mbyllur me "Thembra e akcilit" që përballet me mitin urban, mbetjet nga totalitarizmi, njerëz me delire e paranoja. Larje hesapesh e keni qajtur, por pse kjo sagë?

A.T: Jo gjithmonë. Katër romane të mi "Dueli", "Fabula rasa", "Tenxherja" dhe "Gurit të varrit ia rrëfej" janë romane të shkruar me regjistra stilstikë krejt të ndryshëm. Ajo që kanë të përbashkët janë realet e kushtëzuara të diktaturës. Protagonistët janë përherë në kërkim të personalitetit të tyre në përditshmërinë totalitare. Shumica janë në kapërcyellin e adoleshencës dhe e ndjejnë se personaliteti i tyre kërcënohet nga makina shtypëse: para tyre zbulohet tërë lemeri njëfarë farë fuqie e errët, e epërme, që merr trajta satanike. Dhe si e tillë përjetohet. Ajo fuqi zhduk fshin, rrafshon, nivelon, deri në tjetërsim e shpërfytyrim këndet e personalitetit, siç ndodh me shumë prej tyre që rebelohen dhe kërkojnë të mbrojnë të pakompromentueshëm thelbin e tyre të brendshëm. Këto romane përbëjnë sagën e pjekjes në ag të burrërimit dhe ankthin se diç e keqe, e pabesë do të ndodhë me ta. Është një frikë që dhe i irriton, dhe i rebelon; një frikë e ngjashme si ankthi prej kastrimit. Ndërsa romani "Tenxherja" po, është një sagë familjare dhe është shkruar si larje hesapesh me shumë reminishenca që vinin prej së kaluarës. Ai ka mjaft nota biografike. Është shkruar vetëm për të hequr qafe një ëndërr të ankthshme, që përsëritej thuajse e njëjtë ndër vite, sikur donte të më shoqëronte për gjithë jetën. Këtë quaj "larje hesapesh". "Mërkuna e zezë", është një roman që s'ka lidhje më me realitetet komuniste, por me fanatizmat dhe frymën autoritare të sektit, cilado qofshin sektet fanatike, fetare, femërore, mashkullore, politike etj.

Gjatë një gjysmë shekulli diktaturë shkrimtarët shqiptarë lanë pa përjetuar në veprat e tyre gjithë frymën tragjike të epokës, duke u modeluar tërësisht pas "romantikës" rozë, që diktonte dogma zyrtare. A nuk ju duket absurde kjo, të cilën duhet ta sqarojë historia e letërsisë sonë? Kush duhej t'i përjetonte, nëse shkrimtari jo?

A.T: Historia e letërsisë sonë më mirë të mos shkruhet njëherë. Sepse është e sigurtë që do të manipulohet, cilidoqoftë kriteri, qasja, metoda. Dhe atë nuk duhet ta shkruajnë duar të pista. Gjithsesi ai do ishte një tekst kryesisht me karakter shkollor/universitar. Një tekst akademik. Duart e përlyera rrinë gati ta bëjnë edhe këtë ndotje të fundit. Ja pse nuk më shqetëson mungesa e një Historie të Letërsisë. Ne kemi gati 30 vjet pas rënies së komunizmit dhe nuk është hartuar një antologji për poezinë apo prozën shqipe. Rënia e ideologjisë totalitare komuniste, nuk shërbeu dot si një kufi i qartë i kriterit të lirisë artistike, që ndan dy epoka. Kihet dëshirë që gjërat edhe në letërsi të përlyhen, të përzihen, të llangosen e të zhyhen në emër të "vazhdimësisë", të "organicitetit". Sikur asgjë nuk ka ndodhur. Sikur çdo gjë vijon udhën e vet normale. Stop! Këto dokrra nuk i gëlltit më kush. Dhe kjo alibi, kjo apologji, bëhet për të legjitimuar socrealistët. Vërtet që periudhat letrare nuk kanë "dyer", që hapen e mbyllen prerazi, duke futur dikë brenda e duke lënë dikë jashtë, por kurrë, kurrësesi nuk mund të barabitësh si të njëllojtë një vetëdije krijuese që hyri e lirë në letërsi, me një vetëdije të cenzuruar e vetëcenzuruar në përshtatje me dogmën ideologjike, së cilës i është përshtatur dhe i ka dhënë haraçin. Prandaj e them prapë: mirë që nuk është shkruar një Histori e Letërsisë, se përsëri do të thirreshin kumbarët e kumbareshat, xhaxhot e byrazerët, nunat e ndrikullat që i prekin thuajse të gjitha punët, duke i ndotur ato. Le të presim them dhe nja 20 a 30 vjet të tjera... dhe le t'i bëjnë këto detyra të tjerë njerëz, të shpëlarë nga zgjyra e shijes, koniukturat, hatëret e tarafet. Ne e kemi humbur besimin. Dhe akoma më keq: kemi humbur respektin për punën e tjetrit. Dallojmë veç të zezën tek përpjekja e tjetrit. E nëse nuk ka të zezë, e nxijmë vetë më zi se kukudhi. Kam shkruar dhe më parë në lidhje me mungesën e përjetimit të realitetetit të vërtetë në Shqipëri për gjysëm shekulli. Pra, letërsie shqipe për gjysëm shekulli ka fshehur krimin dhe kufomat e krimit. Ka fshehur gjithçka, për t'i mbushur fletët e saj me hipokrizinë më të ndyrë të planetit. Idile socrealiste. Shtirje. Propagandë servile. Kjo bëri që të vdesë gjuha e natyrshme e shkrimtarit. Pak role episodike qëndrese pati dhe ndëshkimi për ta qe inkuizicionist. Nuk flasim për ndonjë përjashtim, që përforcon rregullin. Por kishte shkrimtarë shqiptarë jashtë Shqipëria, që nuk e luajtën rolin e palaços. Vepra e Camajt, për shembull, apo "Libri i burgut" i Arshi Pipës. E letërsia në kohë të zeza, kërkon kurajë, burrni, vetëdije flijimi, madje më shumë se çdo fushë tjetër. Por pikërisht kur Ora e letërsisë shqipe kërkonte burra për qëndresë, nga ata, që letërsisë nuk i kanë munguar në të gjitha vendet dhe kohët, letërsia shqipe pati burrecër. Ajo thjesht u zhburrnua. S'kam pse flas më qartë. Flasin tekstet e pambarim, librat, me të cilat sot mund të ngresh një piramidë gjigande turpi.

Lexuesi duhet "magjepsur" me atë çfarë e mban gjallë, duhet tërhequr me magjinë e letërsisë së mirë, ku ai të gjejë veten, jetën e vet shpirtërore e mendore, dilemat dhe dëshirat që e bëjnë të ngrihet nga banaliteti i përditshmërisë.

sonë më mirë të mos shkruhet njëherë



...Tani ekziston një Dibër tjetër, e përçudnuar si më parë nga varfëria dhe emigrimi. Nuk vuan për mbijetesë ushqimore, por nga lumpenizimi, papunësia, varfëria, mungesa e perspektivës. Me se e mbajnë veten gjallë ato banorë? Me çfarë shpresash? Dibra është një vend i izoluar, si më parë. I pasur në prodhime e burime, por krejt pa mundësi t'i konvertojë ato në mirëqenie. Një popull i keqpërdorur nga politikanë lokalë e qëndrorë, të cilët i shëmbëllejnë një bande fantazmagorike...

Dhe pyetja që kam shtruar unë është: ç'ndodh me "kodin gjenetik" të një letërsie kombëtare që ka gënjyer, mashtruar, falsifikuar, fshehur, që ka bërë palaçon, kur duhet të merrte kujën, ç'ndodh pra me genet, me ADN-në e saj, kur ka folur vetëm me gjuhën e gënjeshtrës? A do t'i vuajë vallë gjatë pasojat? Dhe cilat janë ato? Jo vetëm letërsia e ka këtë problem mospërjetimi të turpshëm gjysëmshekullor, por edhe artet e tjera. Nuk po flasim për atë epidemi kolerike që quhet film artistik shqiptar i Kinostudios "Shqipëria e Re", dhe këtë fytyrë turpi e gjeni non stop nëpër kanalet tona sot, me një mbrojtje të veçantë shtetërore. Po për këtë kam folur, sa jam ngjirur.

Flitet ndër shkrimtarë për natyrën pothuaj autobiografike të romanit, ashtu siç ju jeni shprehur: "Ndërsa romani im – jam unë. Cilat janë të vërtetat e tua, që nuk u përkasin gjesteve të jashtme?

A.T: Ka shumë teori mbi dobinë apo dëmin e madh të "autobiografizmit" në roman. Kur them "romani im – jam unë", kam parasysh atë çfarë kanë thënë mjeshtrit klasikë të romanit, Tolstoi dhe Floberi, në lidhje me heroinat e romaneve të tyre, Kareninë dhe Bovarinë. Po, romani është tejmase biografik edhe kur përshkruan një qenie imagjinare që nuk ekziston në të vërtetë, edhe kur ndërtohet si monolog i ndonjë sendi, ngjyre apo peme. Ky "biografizëm" është i pashmangshëm, përderisa jemi qenie antropomorfe, por nuk mund të bëhet çelës, madje çelës i vetëm shpjegimi e kuptimi për veprën. Kam bindjen se letërsia e mirë duhet të ushqehet nga imagjinata. Trilli artistik modelon një botë të vërtetash artistike, ndërsa biografizmi e ul vlerën letrare të veprës. I jep vlerë reportazhi apo fejtoni artistik. Gjyqi për një roman nuk shtrohet nëse ka gënjyer autori, nëse i ka mbetur besnik një realiteti të caktuar. Këto punë i përmbush zhanri i memuaristikës. Romani është projeksion i imagjinatës mbi të vërteta të brendshme, përmes "gënjeshtrave" sa më të guximshme, gënjeshtrave të "vërteta".

A mund të kemi një lexim "të fshehtë" të historive që shkruani, si i dëgjoni zërat e personazheve?

A.T: Nuk besoj se i vë vetes një detyrë të tillë kur shkruaj. Përpiqem që historia që rrëfej të më përfshijë vetë në radhë të parë dhe të mos jetë e deshifrueshme, e parashikueshme në asnjë moment. Të mos ia qëllojë lexuesi, se çfarë pritet në faqen tjetër. Përftohet vetvetiu njëfarë thellësie, pa e rënduar dhe sofistikuar tekstin me "dijet" apo "filozofimet". Përpiqem t'i jap lirshmëri personazhit, ta lë atë të veprojë e të sillet me lirinë që ka dhe kufizimet që ka. Të jetojë. Pa sforco. Ato flasin me veten dhe të tjerët, reagojnë, gjithmonë në përputhje me identitetin që kanë. Gënjejnë, ngrehin rrengje, thurin plane e shpresa, njësoj si çdo njeri normal në botën e madhe të vërtetë. Dhe të vdesin besueshëm. Nuk mund ta vdesësh kot, pa motivim një personazh, meqë ti je autori dhe kështu të teket. Në jetë edhe mund të çmendesh. Të kapësh çiftën dhe shtish mbi njerëz të gjallë në rrugë. Por kurrë nuk mund ta bësh këtë çmenduri të papërligjur në letërsi. Krimi në jetë edhe ndodh, por nuk mund të vrasësh në letërsi pa qenë e pashmangshme vdekja e personazhit. Floberi volli një javë kur i dha helmin Ema Bovarisë. Përgjegjësia në art është shumë më e madhe se në jetën e përditshme. Nisur nga këto shpjegime, kuptohet, që zërat e persanazheve të mi janë të dallueshëm në masën e çlirimit të personalitetit të tyre prej meje. Të paktën gjatë kohës që mendoj për ta dhe shkruaj "fatin" e tyre.

Për shumë arsye, këtu në Shqipëri (jo vetëm) mendohet se, shkrimtarët burra janë më të mirë se ato, gra, duke marrë një vel madhështie e rëndësie, çfarë mendimi keni, përse mund të ndodh kjo?

A.T: Unë nuk jam pjesë e atyre që mendojnë kështu. E di, si shumëkush, apo ndoshta më mirë se një pjesë e madhe, se ka prej kohësh një seri të studimeve "gender", letërsia feministe. Ekzistojnë kurse e programa të posaçme universitare e postuniversitare që trajtojnë "letërsinë feministe", duke plotësuar një gjenealogji historike të "shkrimit femëror". Unë mendoj se ka "problematikë femërore", por jo letërsi për meshkuj e letërsi për femra. Për mua letërsia nuk ka seks. Ose është letërsi e mirë, ose nuk është. Më duket absurde të provosh me indikator cilësinë "fëmërore" apo "mashkullore" të letërsisë. As nisur nga ndjeshmëritë "feminile" apo "mashkullore" nuk rezulton kjo. Jurij Lotman, një ndër semioticienët më të mëdhenj, krahason në një studim ndjeshmëritë "feminile" dhe "mashkullore" të dy poetëve rusë – Marina Cvjetajevës dhe Boris Pasternakut. Dhe e dini përfundimin e studimit? Lotmani argumenton ndjeshmërinë e spikatur burrërore të poezisë së Cvjetajevës, sikundërse ndjeshmërinë tejet femërore të poezisë së Pasternakut. E them edhe njëherë: letërsia e mirë nuk ka seks, d.m.th, gjini.

Cila është gjendja juaj mendore kur nisni të shkruani?

A.T: Pasiguria dhe dëshira. Cila do të fitojë? Varet nga koha. Shpesh mungesa e kohës. Alarmi i agjendës rrënon gjithçka. Madje për vite të tëra në jetën time, tash dhjetë vjet, ndoshta, mbizotëron alarmi dhe agjenda. Është luks të kesh një kohë të pahelmatisur nga radha e pafund e detyrimeve që të presin. Hija e detyrimeve e bën të pamundur të shkruarit.

Keni ndonjë shkrim të hershëm që nuk e keni botuar kurrë?

A.T: Disa dhjetra poezi, ca tregime dhe shumë fillime romanesh, tregimesh e novelash.

Çfarë pasojash mendoni se, ka lënë tranzicioni nga regjimi komunist, qoftë në temë por edhe në formë?

A.T: Në letërsi vërshoi një liri kaotike. U dynd një pluhurnajë e madhe kulturore. Gjithkush që pati mundësinë financiare të botojë apo të gjejë sponsorizim, botoi librin e tij. Vërshuan rrëfimet e gjithëfarë lloji: libra për fshatrat, krahinat, dyert e mëdha, kishat, xhamitë e teqetë, për burra të shquar e patriotë, që deri dje nuk njiheshin; libra për mësues, oficerë, ushtarakë, ish-sigurimsa; çdo gazetar nxitoi të botojë librat e vet dhe të imponohet si shkrimtar me vlera. Po kështu veproi çdo politikan, aktor, pensionist, etj. Romane e poezi të autorëve që nuk e kapërcenin nivelin e vetëshprehjes. Në një kakofoni të tillë, shtëpitë-shtypshkronja botuese u sollën si çdo lloj i rëndomtë tregu, duke bërë preventivin e librit, pa e vrarë mendjen se çfarë vlere ka ai. Me kohë vendin e parë e zuri letërsia masovike, përkthimet e këtij zhanri (romanit rozë, i damave, thriller, dedektiv, mistik, erotik, konjukturoro-politik, etj), një zhanër që asnjëherë nuk është konsideruar si letërsi, se njëmend nuk është. Po me kohë iu bashkangjitën edhe produktet e letërsisë masovike shqiptare, edhe ato duke u konsideruar si fjala e fundit e letërsisë, prej ndonjë burri konjuktural me mjekër kombëtare. Të pakta mbeten edhe sot shtëpitë e mirëfillta botuese që mbajtën nivelin dhe qëndrimin e rezervuar të përzgjedhës të autorëve. Lexuesi e krijuesi shqiptar e ka mundësinë të ballafaqohet sot me gjithë emrat e mëdhenj në poezi e prozë. Dhe ky është një shërbim i mirë i botuesve shqiptarë. Sigurisht kjo ka ndikuar për një rikuptimësim të idesë mbi letërsinë si art i fjalës. Ndikimi pastaj ka qenë i ndryshëm, nga epigonizmi tek eksperimentimi i kujdesshëm. Sfera e letërsisë së mirëfilltë vazhdon të elitarizohet. Autorët shqiptarë po krijojnë profilet e tyre individuale dhe mund të flitet për një peizazh mjaft interesant të letërsisë shqipe bashkëkohore. Mirëpo sërish "Thembra e Akilit" mbetet rrjeti i shpërndarjes, i cili është krejtësisht spontan e i gjymtuar. Instanca nga Botuesi tek shpërndarësi dhe librashitësi nuk funksionon, të paktën për autorët shqiptarë. Në fund të këtij zinxhiri, pret surrati vrarëlie i librashtësit, i cili porosit librat me të njëjtin tahmin, sikur zgjedh trangujt në treg. Dhe ne nuk na shkon mendja si autorë, se gjyqtari ynë suprem për ekzistencë në raft, është inteligjenca e librashitësit.

Keni thënë: Kontrata me djallin është një metaforë e vjetër e njerëzimit, që në mënyrën e vet i shtrohet gjithkujt. Letërsia nuk është se i zgjidh këto probleme dhe nuk përçon moral në kuptimin e drejtpërdrejtë: në kontekstualizmin e kësaj, a ka ç'të rrëfejë sot letërsia?

A.T: Letërsia ka ç'të rrëfejë gjithmonë. Temat madhore dominuese janë po ato të lashtat: kthimi i heroit në shtëpi, tema e labirinthit, ndërmarrja e pamundur dhe kontrata me djallin. Sigurisht, ka dhe tema të tjera. Shoqëria e sotme shqiptare është e kapërthyer me të gjitha problemet e këtyre variacioneve tematike. Letësia nuk bën moral, sepse morali është gjë e trashë. Letërsia e mirë fsheh një apel, që ta pështpërit, si një urdhër i brendshëm, në një vesh ende të pazbuluar: "Bëhu si unë!"

Ndërkohë mbani pozicionin e Drejtorit në Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, angazhim dimensional –politik e qytetar. Përveçse ngjarjeve tronditëse, çfarë ju shqetëson në këtë ndërgjegje sot?

A.T: Më shqetëson shurdhëria e politikës, parlamentit, komisioneve parlamentare dhe instancat e drejtësisë për të mos e ndëshkuar ligjërisht krimin komunist. Më shqetëson tejngopja e institucioneve qëndrore të shtetit me ish-Sigurimsa, një situatë flagrante kur shteti po drejtohet nga ish-Sigurimsat. E shkuara pasqyrohet në të sotmen: bashkëpunimi i ish-Sigurimsave me qarqet e ndryshme të mafies shtetërore. Ata i ke në Parlament, në Policinë e shtetit, në SHISH, në Prokurori etj. Madje dhe vetingu bëhet nga duart e tyre të ndyra, nga po ata ish-oficerë operativë të ish-Sigurimit. Shqetësuese është gjendja e kurrikulave mësimore në shkolla e universitete. Shqipëria ka probleme të rënda me ndarjen nga trashëgimia komuniste. Mungon ndjeshmëria dhe mirëkuptimi për ta bërë këtë ndarje. Shqipëria ka nevojë të zbatojë një Platformë Kombëtare të Dekomunistizimit dhe jo të riciklojë këto mbetje toksike sigurimsash në krye të institucioneve. Ata nuk e kanë më vendin në shoqërinë tonë demokratike. Efekti i kësaj ndotjeje të përgjithshme po na çon në ripërtëritjen e totalitarizmit.

Një kontribut është në atë që e quani letërsi e memuaristikës, që këtë vit pati sërish një fluks botimesh të reja mbi komunizmin, dëshmi e rrëfime...A ka kujtesë të mjaftueshme sipas jush?

A.T: Është bërë një punë e madhe nga Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit që drejtoj unë me botimin e këtij zhanri. Janë studime shkencore tematike e monografike të bazuara mbi arkivat, që evidentojnë harta krimi e gjenocidi. Janë mbi 100 tituj librash memuaristikë të qytetarëve që provuan burgjet dhe internimet. Disa qindra të tjerë që kanë mbijetuar i kemi marrë në rrëfime audiovizuale dhe po botohen të zbardhura nga Luljeta Lleshanaku në një kolanë që quhet "Zërat e kujtesës". Ka pasur dhe më parë përpjekje dhe ka edhe nga organizata të tjera, po prapë është e pamjaftueshme. Po përpiqemi të shpëtojmë kujtesën e të mbijetuarve, përgjithësisht breza të moshës së tretë, që po vdesin përditë.

Kur në vende të tjera leximet dhe performancat e tekstit poetik janë mjaft të përhapura, për t'i bërë vargjet më të arritshme, këtu për marrëdhënien poet-publik s'ka reflektim, dhe ishte tronditëse sondazhi në fundvitin e shkuar për lexuesit shqiptar. Nuk lexohet.

A.T: Një peisazh letrar kombëtar, pa infrastrukturë, si i yni, nuk të lejon të shohësh vlerat e vërteta. Janë vite të gjata këto dhe gjendja ka ardhur duke u përkeqësuar. Infrastruktura letrare është sociologjia e komunikimit me lexuesin. Janë revistat, periodikët, almanakët dhe gazetat javore. Të gjitha këto media letrare, që tek ne mungojnë, duhet të jepnin një dinamikë të komunikimit. Ne jemi një kulturë pa revista, pa gazeta. Pa Festivale Letrare. Pa studio me emisione të posaçme, që t'i kushtohen cilësisht artit letrar. As rubrika të librit. Por edhe kur kanë qenë në ndonjë TV të madh, të kallte krupën era e qokave. Pyetja është: prej çfarë duarsh na serviret libri? Nga goca konjukturale, nga dama të perënduara ish-hartuese akt-ekspertizash. Kështu nuk ke mundësi të kuptosh se çfarë idesh, prirjesh, tendencash e stilesh mbizotërojnë. Nuk ke mundësi të lexosh një shkrim recensional, cikle poetike, përkthime, studime, sepse mungojnë.

Kjo është shenjë e keqe. Këto lexues që ftohen, që i kthejnë shpinën librit, janë kontigjenti i nesërm i rekrutimit në turma demagogjike, që shoqëria të kridhet në horizonte totalitare.

Si duhet t'i dorëzohesh lexuesit, a e mendoni?

A.T: Lexuesit nuk duhet t'i dorëzohesh, por t'i imponohesh me cilësi e veprave që shkruan. Kurrë nuk ka ngjarë në historinë e letërsisë, që poetët e shkrimtarët t'i dorëzohen masës së lexuesit. Lexuesi duhet "magjepsur" me atë çfarë e mban gjallë, duhet tërhequr me magjinë e letërsisë së mirë, ku ai të gjejë veten, jetën e vet shpirtërore e mendore, dilemat dhe dëshirat që e bëjnë të ngrihet nga banaliteti i përditshmërisë. Lexuesit duhet t'i ofrosh librin që atë e madhon, e bën të meditojë e të trandet thellësisht, të shkundet, të preket e të zgjohet nga përtacia shpirtërore. Duhet t'i ngacmosh sedrën. Diç të ngjashme me atë që thotë një personazh i Orhan Pamuk: "Sesi një ditë lexova një libër, që e ndryshoi tërë jetën time" ("Jeta e re"). A ka mundësi t'i ofrosh një libër të tillë? Do të ishe fatale t'i dorëzoheshe shijes së masës. Do të përfundonim në një letërsi kitch-i. Nuk i është dorëzuar Pushkini, Dostojevski, Çehovi, Hygoi, Prusti apo Kafka nivelit të lexuesit, por ata e kanë ngritur lexuesin në nivelin e tyre. Gjithmonë është fjala për lexuesin elitar, i cili është thuajse bashkautor me shkrimtarin në aktin e leximit.

Së fundi, nëse ju mund të jepni disa këshilla për autorët që aspirojnë, cilat mund të ishin?

A.T: Të lexojnë shumë e vazhdimisht. Të njohin mirë mjeshtërit. E të gjitha traditave. Të ushtrojnë stilin e tyre duke fshirë e grisur sa më shumë. Të shkruajnë "për vete", pa llogaritur në do t'u përshtaten lexuesve. Gjithçka tjetër mandej, zgjidhet vetvetiu.

Marrë me shkurtime nga "Ex Librit", revistë letrare e Tiranës. Titulli origjinal: "Letërsia e mirë fsheh një apel, që ta pështpërit, si një urdhër i brendshëm".

SHËNIME PËR LIBRIN ME POEZI TË MIRANDA SHEHUT – XHILAGËS
“KJO DHIMBJE ËSHTË IMJA”, Tiranë, 2018

Poetja me një “penel” të hollë

Nga prof. dr. HAJRI SHEHU

Libri përmban 100 poezi në 159 faqe. Autorja shtjellon estetikisht meditimet e saj dhe ndjenjat e emocionet e saj. Libri nuk ka parathënie, siç ndodh rëndom në botime. Duket, autorja nuk ka dashur të ndikojë te lexuesi në receptivin e poezive të saj. Unë nuk jam kritik letrar. Thjesht, si lexues, do të them pak fjalë në trajtë shënimesh.

Te stili individual i aksh shkrimtari a poeti, domethënë, te mënyra si i shpreh mendimet ai, besojmë se përshfaqen veti të veçanta të karakterit të tij; p.sh., sinqeriteti, ndershmëria, thjeshtësia, ngrohtësia e shpirtit, ose të kundërtat e tyre. Natyrisht, këtu ndikojnë edhe botëkuptimi i tij, pëlqimet e mospëlqimet e tij, parimet e tij estetike, detyra që i ka vënë vetes, formimi i tij gjuhësor e letrar etj. E bëra këtë lloj hyrjeje për të thënë që te poezitë e Mirandës do të shihni jo vetëm stilin e saj individual, por edhe karakterin e saj të lartë. Poetesha do, për shembull, gjithnjë të çiltrën, të sinqertën, të tejdukshmen, sepse vetë është e tillë. Sepse ky është shpirti i poetes. Ndryshe, nuk mund të ishte poete e nuk mund të shkruante poezi. Ndryshe, nuk mund të ishte Miranda. Ja si shkruan ajo në poezinë “Fytyrën mbi ujë”: *Ajo që desha të them është / se më pëlqejnë të gjitha gjërat / të përshkueshme nga drita.* Ajo i thotë gjërat ashtu si i sheh, pa zbukurime. Lexuesi e përdallon këtë në të gjitha poezitë. “Si i kam sytë”, - e pyet ajo stërgjyshen e verbër. Pyetje dhe provë shumë e vështirë për një të verbër. Me shqisën (e zhvilluar) e të prekurit, ajo mund të dallojë duart, fytyrën, por jo ngjyrën e syve, që nuk i ka parë asnjëherë. Mençuria dhe zgjuarsia e poetes, vënë në përgjigjen e stërgjyshes së verbër vjen me vargun: *Si nuk ka të dytë.* Dhe kënaqet gjyshja. Kënaqet edhe poetja. Kënaqet edhe lexuesi.

Titulli i librit është shumë kuptimplotë: *Kjo dhimbje është imja.* Por nuk është dhimbje vetjake. Poetes i dhimbsen të tjerët dhe vuan për të tjerët. Ajo i do shumë të tjerët, më së pari prindërit, motrat, gjyshet e stërgjyshet. Prandaj tek *Ardhje e ikje* thotë*: Dashuri, ti më sjell këtu. / Duke ikur, nuk të lë pas, / të marr sërish me vete.* Ajo ka dhembje edhe për të tjerë më tej: për *njerëz të lodhur*, për *foshnja të panumërta në jetimore*, për *nëna pa fëmijë në gjinj, që rrjedhin qumësht, që hidhet në plehra* ... (Shih te poezia “Kam frikë nga era”). Dhe, në poezinë me titullin, që mban libri (“Kjo dhimbje është imja”) vjen postulati: *Kush mbjell dhimbje, mbledh lot (etja vijon). Kush ndien dhimbje, lëshon lot (paqja vijon).* Një poezi gjithë dhembje shpirti është “Klithma të heshtura”: Shtëpi të rrënuara, kalldrëme të vjetra, zjarre të shuara, djepe bosh, male të kërrusura, fusha shterpa, fjalë të pathëna, fjalë të lëshuara krejt shkujdesur, që kanë vrarë e vrasin jetë e mot, qielli i murrmë prej gjakut të tharë e korbat që vijnë rrotull, zogjtë që sjellin gjëmë e ëndrra në gjumë të përjetshëm – një tablo që të rrëqeth mishtë. Dhe klithmat duhet të shpojnë qiellin për këtë zezonë. Mu pse nuk ndodh kjo, poetja i quan *të heshtura.* Dhe poetes i dhemb zemra, sepse nuk do heshtje. Poezia “Net shkurti” është për një dhembje më të veçantë - për rrëmbimin e fëmijëve indigjenë (anas, rrënjës) të Australisë. Vite më parë, unë kam lexuar në anglisht një tregim, “The Curse of Maralinga” (Mallkimi i Maralingës). Maralinga është një krahinë bregdetare, sipas tregimit, e banuar nga aborigjenë (rrënjës). I zbuan prej andej për arsye kërkimi nafte e prova armësh. Po ta kishte lexuar, me siguri, Miranda do të kishte bërë një poezi mjaft të dhembshme, një elegji.



Poetja do gjithë të mirën për tjetrin. Poetja do sytë e qeshur. *E unë kurrë të mos i shoh të trishtë sytë e tu.* (“Mos më shiko me ata sy të trishtë”). E ku, më shumë se te sytë mund ta shohësh të mirën e ëndrrën e mirë, optimizmin e gëzimin? (“Ëndrra që mund të zgjasin” dhe “Karusel”). Poetesha i do njerëzit dhe ardhjet. Prandaj thotë: *Hijet të heshtura e të ftohta gjithnjë janë ... Edhe ata që kurrë nuk trokasin në derë, të ikur janë.* (Poezia “Diku, dikush pret”). Poetesha i do poetët dhe i merr në mbrojtje ata si pararendës të shoqërisë. Lexoni poezinë “Pak fjalë për ata ...”. Mua më ka entuziazmuar përmendja në poezi e poetëve Xhon Kiits (John Keats) dhe Përsi Shelli (Percey Shelly) sepse veprën e tyre e kam njohur qëkur.

Dhe poetesha beson te njerëzit, sepse ata janë *potencial dashurie.* Dhe do ura midis njerëzve: *Na duhet një urë.* Dhe beson tek e nesërmja e njerëzve. *Nesër, / nesër do të jetë një ditë më e mirë, / do të jetë një ditë tjetër nesër.*

Në shumë poezi, autorja përveçon femrën, gruan, binjaken e mashkullit. Në f. 156 ka një poezi me këtë titull: “Grua”. Është gruaja që solli në jetë botën dhe e mban botën. “*Të gjithë sytë janë mbi ty / nga mëngjesi në darkë”* janë dy vargjet e para. Lexoni më tej vargjet e tjera të shihni me sytë e mendjes, o burra. Gruaja është një Kronë, - thuhet në vjershën pasardhëse. Një njeri me përvojë të madhe në jetë, një mësuese e përhershme e brezave dhe e brezatarëve. Prandaj V. Hygoi thotë: “Dy janë nëpunësit kryesorë të shtetit – nëna dhe mësuesi”. Nëna është gruaja. Gruaja është nëna.

Poezitë për dashurinë janë të ëmbla, të ngrohta, të gjalla: *Folmë për dashurinë në ëndrrat e tua*, - thotë poetja. Dhe: *Të gjitha historitë e dashurisë rrjedhin si një lumë.* Dhe: *Të gjithë lumenjtë drejt detit rendin* (“Lumë që rend”). Në to ka edhe sentenca për dashurinë. Shih për këto, p.sh., te poezia “Çfarë do të bëje ti?”. Çfarë do të bëje (ti) për dashurinë?, - është pyetja që i drejtohet lexuesit në fund të çdonjërës prej katër strofave. Shih edhe te “Joshje”: ... *Kërkoja një zemër, një zemër që të mund ta mbaja në zemrën time* ... Kjo është dashuria. Lexoni poezinë “Në dashuri”, për ta njohur dashurinë: ... *Çelësi është të dashurosh një burrë, / për të cilin je mjaft, / një burrë që kur shkon, / mendjen e ka te kthimi, / një burrë që kur fle, mendon zgjimin me ty, / një burrë që kur trishtohet, / ngazëllimin e sheh vetëm në sytë e tu …*

Poezitë për dashurinë janë të ëmbla, të ngrohta, të gjalla: Folmë për dashurinë në ëndrrat e tua, - thotë poetja. Dhe: Të gjitha historitë e dashurisë rrjedhin si një lumë. Dhe: Të gjithë lumenjtë drejt detit rendin (“Lumë që rend”). Në to ka edhe sentenca për dashurinë. Shih për këto, p.sh., te poezia “Çfarë do të bëje ti?”. Çfarë do të bëje (ti) për dashurinë?, - është pyetja që i drejtohet lexuesit në fund të çdonjërës prej katër strofave.

Një i moçëm ka thënë: E nesërmja fitohet me të sotmen. Miranda e ka fituar edhe të nesërmen.

Poetja i ka të bukura të gjitha përshkrimet poetike. Sepse ka një penel të hollë. Sepse ka intuitë e sy për të depërtuar në thelbin e gjërave. Sepse di radhën e gjërave. Dhe nuk është fjala, thjesht për visoret (peizazhet). Më tej se për visoret. Shih, p.sh.: *Dita, një shall i mëndafshtë / që rrëshqet supesh të brishta* (“Muzg”). *Zogjtë fshihen nën krahë / e dyert të mbyllura fort janë.* (“Një i ftohtë skandinav”). *Toka e drobitur, / sillet rreth diellit rëndë-rëndë; / shpendët bëhen gati të lënë foletë* (“Net shkurti”).

Poetja është portretiste e shkëlqyer. Dhe është e tillë sepse është shumë vëzhgimtare dhe e do shumë atë, që do t’i bëjë portretin. Nuk ka nevojë ta shohësh të pikturuar a të vizatuar njeriun. Përbashko vargjet e Mirandës. Vetëm kaq. Në libër ka disa portrete. Shumë tipizues: “Im atë”. Një poezi e bukur për të atin. Një portretizim i bukur. I vërtetë. “Njëzet e dy mijë kilometra” është një poezi për nënën. 22000 kilometra mall e rrugë për të ardhur e për ta parë nënën e saj. “Në 55-vjetorin tënd” i dedikohet motrës. Janë tri motra si tri zana mali. Ja edhe sentenca për motrat: *“Nuk duam vetveten, / sa duam njëra-tjetrën, motra”.* Poezia për stërgjyshen është shkruar gjithë frymëzim e dashuri. Me atë përshkrim aq të gjallë fjalësh, na e ka dhënë portretin e gjyshes më të prekshëm sesa nga syri dhe dora e një piktori. Dhe na duket sikur ne vetë e kemi njohur atë. Më shumë se kaq: Na duket si gjyshja jonë. Poezia për stërgjyshen titullohet “Pa sy”. Sepse gjyshja ishte e verbër. Por dimitë i mbante të bardha e me lule e shaminë – të kuqe të marrë. A mund të krahasohet ndonjë nuse me këtë gjyshe për punë pastërtie? E verbër, por dimitë – të bardha si bora. Edhe shpirtin – të bardhë si bora. Dhe ledhatimet e gjyshes – të buta, të mëndafshta. Të paharruara. Të gjitha gjyshet janë të mira. Por gjyshja (mua më pëlqen te them gjyshja e jo stërgjyshja) e Mirandës është më e mira në botë.

Poetja jeton edhe me kujtimet e saj – të fëmijërisë, të adoleshencës, të rritës së saj. Dhe e çon lexuesin në përjetime të tilla. Shihni njërën nga këto poezi: “Rrugëve të fëmijërisë”. E edhe më e bukur e më kujtimndjellëse është poezia që ndjek të parën: “Një kronikë e shkurtër e 1967-ës”: Në fshatin larg rrugës banon e punon familja e dy mësuesve. Në këtë fshat të largët, i pari i familjes, mësuesi, krijoi grupin e estradës. Shumë e paqme, si në linjën e kujtimeve m’u duk poezia “Menyja e ditës”. Tek e lexoja, më dukej sikur isha ulur diku në atë kuzhinë dhe po e ndiqja me kureshtje e me lakmi gatimin e saj. Edhe shtrimin e tavolinës. Edhe ato *më the e të thashë.* Mua nuk më kishte shkuar nëpër mend që gabimet ortografike (drejtshkrimore) paskan një vlerë tjetër në letrën që ia shkruajmë dikujt me ngut: Ato ta ngadalësojnë ritmin e leximit, kështu që nuk i përpin dot fjalët. Dhe njeriu mediton. Por ajo nuk e bën gabimin e të thotë: Ani, s’ka gjë pse edhe mund të bëni gabime. Sepse thotë: *Letrat e tua shkruar me ngutje.* E, pra, pa ngutje nuk bëjmë gabime.

Miranda shkruan me një fantazi shumë të largët. Shih sa larg na çon poetja me poezinë “Okër”, për të kuptuar se çfarë i trazon mendimet e saj. Dhe e tëra kjo bëhet në një mjedis e me një mjedis të përjetuar nga të gjithë ne. Por puna është se si poetja i trazon mendimet tona. Shih sa larg rreh te poezia “Diku, dikush pret”, për të përcjellë mendimin poetik “si të bëhesh ardhja e dikujt që pret”. Shih, gjithashtu: “Historia e miut të Kafkës”. Poezia është si një fabul.* Por sjell koncepte të mëdha. Shih, p.sh., vetëm një: *Të gjithë ... u drodhën ... dhe përreth u mblodhën sepse* **skena e vdekjes na mbledh**. (Nënvizimi është imi – H.Sh.). Por, njëherësh me fantazinë, poetja ka mënyra të drejtpërdrejta të thëni. Dhe ato janë aksiomatike: *Magjia është luks për të tjerë, / Ka mbetur veç ylli i mëngjesit.* (“Një letër e thjeshtë”). Shih te “Lumë që rend”/III të gjitha vargjet dhe të fundit, përmbyllësin: “*Të gjitha fundet presin ...*”. Lexoni poezinë “Ndërrim stinësh” të merrni vesh poetikisht ç’janë stinët. Edhe mënyrat paradoksale të të thënit (paradoksi letrar, tipi: *klithma të heshtura* ose *dyer që për një trokitje në heshtje ulërijnë)*** vijnë te gjykimi i mësipërm: janë aksiomatike. Ditët dhe librat, - ka thënë një i moçëm, - e bëjnë njeriun të zgjuar. Libri i Mirandës, - na bën, vërtet të zgjuar.

Në çdolloj kumtimi, zgjedhja e fjalëve ka rol përcaktues. Ajo tregon çfarë je e çfarë dëshiron të jesh. Në poezitë e Mirandës, kjo zgjedhje e vetëdijshme e fjalëve (jo vetëm e poetizmave / tipi *ëndërrimtar*: *një natë e gjatë ëndërrimtare*) shoqërohet me një përmbajtje të hollë kuptimore – krejtësisht e motivuar dhe e pranuar gjuhësisht. Shih, p.sh., *po të mos isha* **strukur** *mes krahësh të gjerë sa* **arra e madhe** / arra i ka degët e hapta, jo, b.f., kumbulla; e arra e *madhe* i ka ku e ku degët; *gjoksin plot* **si lule dielli;** *si luga lugës* **do t’i ngjitet**; **të** *mos* **vaken** *shpirtrat* **e ndezur**; **regëtijnë** *veç sa një* **xixëllimë** / në parantezë: autorja ka parapëlqyer fjalën e së folmes së vet, ndoshta sepse në shqiptimin e saj – në krahasim me fjalën standarde, *xixëllonjë* ka një si motivim përmbajtjesor për të dhënë idenë e *regëtimit; zjarr* **i paflakë** // e kundërta do të ishte *zjarr* **flakadan;** krahaso edhe **troku** *i zemrës; ëndërr* **e trëndafiltë;** *lot më të* **njelmët se kripa** etj.

Në gjuhën poetike – në dallim nga gjuha e zakonshme – nuk ka fjalë dhe forma krejt të pamotivuara, me kuptim krejt të izoluar. Shih, p.sh., fjalën *këndoj.* Në poezi *këndon* edhe *mali,* edhe *shpirti* (në gjuhën e zakonshme – jo). Kjo ndodh për arsye se në poezi motivimi është artistik.

(vijon në faqen 17)

Para se Nevruzi të jetë Sulltan Nevruz, festë e bektashinjve, është "Ditë e re", është një festë pagane e lidhur me pemëtarinë dhe vreshtarinë, ashtu siç është Dita e Verës e lidhur me Lulet, ashtu siç është Dita e Shëngjergjit e lidhur me blegtorinë...

Bashkimi shqiptar në ritin e festimeve të Nevruzit

Nga **Abdurahim Ashiku**

Riti...
I pari: Ata pres?
I dyti: Me kalë e me thes.
I pari: A ta pres or gegë?
I dyti: Me kalë e me shegë.
I Pari: A ta pres or toskë?
I dyti: Me kalë e me plloskë.
I pari: A ta pres?
I dyti: Preje...

Dita e Nevruzit (Jetë e re) si festë pagane, e lidhur me pranverën, me "bukoliket" dhe "gjeorgjiket", bujqësinë dhe blegtorinë, me pemëtarinë e vreshtarinë në veçanti festohet nga banorë të krahinave të ndryshme të Shqipërisë në vlerë të kohëve të lashta mbushur me rite parakristiane.

Më poshtë do të merrem me Nevruzin në një vështrim të gjallë, në atë që e kam jetuar në fëmijëri dhe të paktën, edhe sot e vite në vijim, jeton në Dibër, në Topallti dhe në Male.

Do të merrem edhe me një rit që i fton shqiptarët, Gegë e Toskë, të jenë bashkë...

Nevruzi në Dibër festohet në varësi nga lartësia gjeografike e vendbanimeve - Nëntë ditë pas Ditës së Verës (Lugina e Drinit të Zi) dhe - Dymbëdhjetë ditë pas Ditës së Verës (në zonën malore), në të dy krahët e lartësisë mbi luginë.

Në kujtimet e mia Nevruzi, nga ritet, këngët dhe doket nuk është gjë tjetër veçse një festë popullore thjesht pagane, festë e lidhur me bujqësinë e në veçanti me pemëtarinë, festë e lidhur me thirrjen për t'iu përveshur punës në sektorin jetik të trevës (trevave) që lidhej me bujqësinë e blegtorinë.

Disa rite si mbledhje e luleve, të shkuarit mbrëmjen e natës së Nevruzit në mulli, ndezja e mullarëve me kashtë e dëllinja para shtëpive, peta (byreku) i Nevruzit dhe ushqime të tjera deri tek therja e gjelit të dytë më të madh të tufës (i pari theret natën e Ditës



Festime gjatë Ditës së Nevruzit në Peshkopi. © fb Dibra turizem dhe traditë.

së Verës), veshjet e lojërat popullore, veç të djemve e veç të vajzave, nuk ndryshojnë nga ato të Natës dhe Ditës së Verës.

Ajo që e dallon Nevruzin janë këngët dhe thirrjet e veçanta ndonjëra prej të cilave më është ngjitur në kujtesë dhe me gjithë vitet që më rëndojnë mbi supe nuk më shqitet edhe këtu, larg e larg në mërgim.

Kujtoj ndër të tjera mbrëmjet e Natës së Nevruzit, kohën kur me një sëpatë në dorë me një shuk kashte të njomur thekre bridhnim sa tek njëra pemë tek tjetra, sa tek një cung hardhie tek tjetri. Bridhnim bashkë, si familje e me mysafirë.

Njeri thërriste e tjetri i përgjigjej..
I pari: Ata pres ?
I dyti: Me kalë e me thes.
I pari: A ta pres or gegë ?
I dyti: Me kalë e me shegë.
I pari: A ta pres or toskë?
I dyti: Me kalë e me plloskë.
I pari: A ta pres?
I dyti: Preje...

Ai që mbante sëpatën në dorë, pasi e kthente në të kundërt të pjesës prerëse i mëshonte pemës me tunin e saj duke thirrur i ngazëlluar...

- E preva...

Thirrje në kor...

Riti vazhdonte me lagie të "plagës" së pemës me një përzierje të pekmezit me erëza e me qerasje me fruta të thata e vezë të ziera...

Kështu vazhdonte pemë më pemë e hardhi më hardhi, me këngë e romuze për të përfunduar rreth e qark mullarit të Natës së Nevruzit me këngë e valle, djemsh e vajzash, burrash e grash të fisit.

E veçanta e Nevruzit është se ajo shndërrohej në një festë masive njerëzish të një gjaku dhe miqsh që zbrisnin luginës së Drinit e ngjiteshin lartësive të maleve në ditët që e ndanin festën, në "Nëntë Ditë pas Ditës së Verës" (23 mars) dhe në "Dymbëdhjetë Ditë" pas saj (26 mars). Një festë e hershme, pagane, që festohej dy herë e mblidhte bashkë njerëzit e gjakut dhe të fisit shpërndarë në hapësirën dibrane.

Riti që përcolla më sipër, dialogu, të bën të mendosh e të arrish në mendimin se Nevruzi, si kohë që lidhet me pranverën dhe ftesën për punë, nga tubimi i njerëzve pranë pemëve dhe hardhive, nuk është gjë tjetër veçse një rit i pemëtarisë dhe vreshtarisë, një thirrje për ti krasitur pemët dhe vreshtat që ata të prodhojnë "me kalë e me shegë", me "Kalë e me plloskë", një thirrje e gjerë me përmasa gjithë Shqipërinë, me Toskë e me Gegë.

Këtu e meriton të ndalem, pikërisht atje ku kënga, riti hap krahët në të gjithë hapësirën shqiptare, tek "Toskët" dhe tek "Gegët"...

I pari: A ta pres or gegë ?
I dyti: Me kalë e me shegë.
I pari: A ta pres or toskë?
I dyti: Me kalë e me plloskë.
Sa i vjetër është ky rit?

Në ç'kohë të shoqërisë shqiptare është futur "Nevruzi i përbashkët shqiptar" kur ai, siç dëshmohet, është thellë historisë së njohjes së tij si "Nevruz" apo "Ditë e re"?

Në kohën e Skënderbeut kur për të parën herë shqiptarët, "Toskë e Gegë" u bashkuan në një shtet me Gjergjin e Gjon Dibranit në krye, kohë kur edhe u lidhën historikisht martesa të shumta mbarë shqiptare?

Më vonë në lidhjet e qëndresën shqiptare ku "Toskët" dhe "Gegët" ishin një?

Ka shumë gjëra që duhen studiuar, mbase edhe ky rit madhështor i bashkimit mbarshqiptar.

Jo mbase, domosdoshmërisht...

Koha, largësia fizike nga Dibra e treva ku Nevruzi është një festë e thjeshtë popullore, pagane, me krye në lashtësi, ma heq mundësinë të shkruaj më gjerë e më thellë. Ua lë lexuesve radhën që ta vazhdojnë meditimin tim...

Për mua, para se Nevruzi të jetë Sulltan Nevruz, festë e bektashinjve, është "Ditë e re", është një festë pagane e lidhur me pemëtarinë dhe vreshtarinë, ashtu siç është Dita e Verës e lidhur me Lulet, ashtu siç është Dita e Shëngjergjit e lidhur me blegtorinë...

Ja na erdhi vera
me dele e me shqerra...
Siç këndohet në Dibër e gjetkë...
Është e lidhur me Shqipërinë e bashkuar,
Toskë dhe Gegë. Atje ku bukës i thonë bukë
dhe ujit i thonë ujë...

Athinë, mars 2019

Poetja me një "penel" të hollë

(vijon nga faqja 16)

Por edhe në poezi, ky motivim nuk mund të shkojë jashtë caqeve të logjikës, domethënë, krahasimi, nga i cili lind metafora (rasti i mësipërm me *këndoj*) duhet të ketë bazë reale, objektive (b.f., nuk mund të thuhej *këndon krahu)*. Kjo do të thotë, atëherë që metafora duhet kërkuar e gjetur brenda kufijve të krahasimeve të motivueshme, "të zbërthyeshme", sido që ato (krahasimet) janë të pashprehura plotësisht (janë implicite). Me fjalë të tjera, rrafshi kuptim i drejtpërdrejtë, konkret / kuptim i prejardhur, i figurshëm duhet të jetë i tejdukshëm: të ruhet njësia (uniteti) e kuptimeve leksikore të fjalës (por, sigurisht, jo njëjtësia, jo identiteti). Ky ndërtim dhe ky motivim nuk mund të ndodhë në zbrazëti. Ai ndodh në atë rreth *bashkëlidhjesh të fjalëve* që janë të motivuara, reale, objektive brenda fantazisë metaforike; krahaso, p.sh., *ag* dhe *agu ia behu në derë; i kërrusur* dhe *malet e kërrusura; i njelmët* dhe *fjalë të njelmëta; i ëndërrt* dhe *buzëqeshje e ëndërrt; i bujshëm* dhe *e qeshur e bujshme; i mëndafshtë* dhe *zë i mëndafshtë*. // Togfjalëshat janë nga poezitë e librit. Po të ndodhë ndryshe, metafora a thënë në tërësi, figurshmëria nuk mund të motivohet a të zbërthehet kuptimisht dhe e humbet efektin e vet stilistik, për të mos thënë, që mund të mbetet një fjalë rastësore. E bëmë këtë "gjuhësi gjuhe" për të ardhur te përfundimi: Sipas këtij gjykimi, të gjitha kuptimet e përdorimet e figurshme në poezitë e Miranda Shehut (Xhilagës) janë të rregullta (por, sigurisht të lënë mendueshëm një copë herë). Shih, p.sh., te "Kthinat e dritës": *shkund peshën e natës; një gllënjkë kujtimesh; perëndimi shtriqet në barkun e paqtë të horizontit; të kuqen e pjekur në gri; të ngjyrosësh ëndrrat; një bulë zjarri; trumzë e artë mendimesh; përshkënditje e një loti të vetmuar*. Vargjet vijnë krejt lirshëm, edhe me krahasime (*Kujtime ... të largëta sa fillimi, / të reja sa dita që sapo iku)* e paralelizma të figurshëm. (Beduini – *pagurin në dorë,* poetja – *vargun në buzë* / "Kënga e beduinëve")

Autorja e njeh mjaft mirë leksikun e shqipes. Dhe e kërkon e e gjen fjalën në këtë leksik për thënien e saj. Cili do të ishte, p.sh., mbiemri me kuptimin "që nuk ka shumë dritë" (për një natë)? Nëse dikujt nuk i vjen në mend, e gjen te ky libër: *i vagët: net të vagëta*. Në përshkrimet e saj poetike, poetja është e saktë deri në detaje. Me fjalën e saj. *E bardhë mjellme,* thotë në një poezi, pra, e *bardhë* e *ndritshme*, jo një e bardhë dosido. Shih përdorimin e fjalës librore *bohem,* në dallim nga *endacak* (me konotacion mospëlqyes); krahaso vlerën stilistikore të fjalës popullore *lazdrak: gërsheta lazdrake,* në krahasim me *përkëdhelës;* shih vlerën ligjërimore të fjalës *fluturak: ëndrra fluturake,* në krahasim me *që kalon shpejt;* krahaso dallimin kuptimor te çifti: *humbem* / *përhumbem; gojërrudhur* / *gojëmbyllur; vdekatar* dhe *i vdekshëm* // janë njëlloj kuptimisht; por dallojnë nga vlera estetike / si *çlirimtar* e *çlirues*.

Autorja njeh mjaft mirë edhe leksikun popullor, kryesisht të së folmes së vendlindjes (tipi *fillikat, i njelmët, vringthi* etj.) që është asnjanësuar nga ngjyrimi vendor e kësisoj, është pasuri e leksikut të përgjithshëm të shqipes. Kjo njohje e ka begatuar vargun e saj. Dhe begatia leksikore e vargut të saj është një ndër vlerat e spikatura të librit. Ajo nuk bën libër me 100-150 fjalë. Libri i saj i ka të gjitha fjalët që do një poezi.

Autorja e di mjaft mirë si formohen fjalët e reja në gjuhën shqipe standarde e si përplotësohet leksiku i saj. Prandaj të gjitha fjalët e reja (që ia ka dashur vargu) i ka formuar sipas gjedheve normative të shqipes. Shih, p.sh., kompozitat *damarfryrë, qafëpërkulur, lëkurëpjekur,* fjalët me *pa-: i pathënë* / *fjalët e pathëna, i pandodhur* / *miqësi e pandodhur, i pafryrë* / *zjarre të pafryra, i pandezur* / *zjarre të pandezura, i paflakë* / *zjarr i paflakë, i palodhur* / *hapa të palodhur,* ndajfoljen *dëshpërueshëm* (sipas formimeve në gegërisht të ndajfoljeve me – *shëm*) etj. Edhe kjo njohje i ka dhënë mjaft dorë për ta zgjedhur e përzgjedhur fjalën për vargun e saj.

Një i moçëm ka thënë: E nesërmja fitohet me të sotmen. Miranda e ka fituar edhe të nesërmen.



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun:
https://tinyurl.com/lcc3e2f

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com


Rruga e Arbërit nr. 155

histori

Albert Kotini: Ali Maliqi në historinë e Dibrës dhe Shqipërisë
Botimet BOTART / 272 faqe, me fotografi.
ISBN: 978-9928-219-87-9
Çmimi: 1000 lekë
E GJENI NË ÇDO LIBRARI

Kontributi i *Ali Maliqit* në Luftën Antifashiste

Nga **ALBERT KOTINI**



Në Dibër njihnin Maliqtë, Lleshët, Ndretë e Kaloshët, ndërkohë, nga ana tjetër, shekujt u lyen me bojën kuq e zi, ku ekzistonte edhe "lënda e errët" që karakterizonte antikomunistët. Tashmë "reaksionarët" treteshin në pa historishmëri, edhe pse populli i Dibrës e kishte të kyçur në memorien e tij shekullore të vërtetën, kur heshtën për Maliqtë, Kërçshtit, Kaloshët etj., dhe, po aq u fol aq shumë për Lleshët. Ja pse fillimisht u duhet zgjuar kujtesa edhe atyre pak dibranëve të moshuar, që dëshmia e tyre të mos merret me vete, por të rifitohet drejtimi i duhur kombëtar, domethënë atje ku u ndërpre më 8 nëntor 1941. Duke folur në emër të popullit, kombit, historisë së vendit, Dibrës, idetë janë po ato të 8 nëntorit të vitit 1941, kur u përvetësua e drejta për një pushtet, për të dënuar kundërshtarët "reaksionarë" antikomunistë në emër të së tërës; dhe ky spekulim ideor sajoi historinë që gjoja i përkiste Shqipërisë.

Bisedat e Avniut çuan në mënyrën e të menduarit për t'iu përqasur, me tërë thelbin e qenies ekzistencës së Maliqve të plagosur prej realitetit, dhe për realitetin duhej rrëmuar përtej vetë Dibrës. Asgjë s'do të më kishte lejuar të krijoja një pamje të qartë dhe komplekse rreth "amaneteve" të Maliqve, vetëm duke hapur një sërë shtigjesh që e afrojnë mjaft ndjeshëm te lexuesit. Kjo, me synimin për të ofruar disa të vërteta faktike të padiskutueshme. Nuk janë pak 50 vjet terrorizim për shpirtin njerëzor të ashtuquajtur "reaksionar". Kompromisi i Lleshëve, Ndreve, Strazimirëve, Jegenëve me bolshevizmin sllav e serb, që përpiqet të na mbushë mendjen dibrane në Dibër, merr fund nga qëndresa stoike dhe përpjekja jashtëzakonisht e thellë e Maliqve për ta vështruar në thelbin e këtyre pozicioneve të ndryshme se kush ishte atdhetar. S'ka pikë dyshimi që e tërë historia e luftës, e lidhur me Lleshët, nënkupton për Dibrën e më gjerë, në vetvete, një shtrembërim të fakteve. Informacioni serb në jetën shpirtërore shqiptare është më i kahershëm sesa ardhja e Enver Hoxhës, Koçi Xoxes dhe Haxhi Lleshit në pushtet. Dibranët i kanë vuajtur në kurriz bëmat serbe dhe kanë legjitimitetin historik në integritetin e mohimit të vëllazërimit që iu imponua gjatë luftës.

Maliqtë, pas vitit 1945 praktikuan një heshtje mrekullisht të qëlluar e të mençur e nuk folën hapur ndaj akuzave bajate, se e dinin stisjen e tyre amorale, ku Sigurimi i Shtetit krijonte menjëherë modelin e "vdekjes së individit" brenda kuadrit ligjor. Avniu jetoi për të treguar si mund të dekonstruktohen shpifjet dhe struktura e atij sistemi të dështuar që në lindje. Janë tipike tre qëndrime të parisë dibrane në Luftën II Botërore, por nuk ka pikë dyshimi që trajtimi i njëanshëm haset edhe në vulgaritete e zhvleftësime të padrejta. Këto tre grupe të parisë dibrane e kanë të vështirë edhe sot e kësaj dite të pohojnë prishjen shekullore të miqësive e krushqive të tyre për Lleshët – Ndretë – Kaloshët – Maliqtë nga anarkia që solli lufta për të zgjedhur rrugët e tyre, por, nga ana tjetër, koha provoi se cila pari ishte më fisnike e më atdhetare. Në këtë pikë, para interesave të vendit nuk mund të dilnin dot lidhjet farefisnore apo krushqish, për të cilat lexohen këndvështrime të ndryshme, por e vërteta u mbetet Maliqve e Kaloshëve. Lleshët, Strazimirët, Ndretë janë të djegur tashmë e të pabesueshëm për veprën e tyre, të paktën ndaj Dibrës.

Në një mënyrë thuajse fatale, pavarësisht se në mënyra dhe forma që tani për tani vazhdojnë të mbeten ende të errëta e të padepërtueshme, shoqëria shqiptare e Dibrës u dramatizua nga faktori sllavo-komunist deri nën një tension të skajshëm psikologjik, si p.sh. Haxhi Lleshi heshti ndaj dënimit të Dali Ndreut brenda llojit dhe Ali Maliqit në anën tjetër klasore, edhe pse me fije të lidhura familjare. Deri në ato momente krahina e Dibrës ka qenë e bashkuar fis më fis, pari më pari, në një përballim ndaj çdo okupatori. Ndërsa e vetmja luftë që i gjen të përçarë ishte ajo partizane dhe "reaksionare". U hodh baltë mbi të vërtetën, nën nofkën e bashkëpunimit me okupatorin, kur koha vërtetoi përsëri se armiku kombëtar ishte Serbia, e cila mori territore, hoqi identitete e toponime dhe i sllavizoi ato si maqedonase apo si shtrati i saj i vjetër. Pavarësisht nga vitet e kaluara traumash dhe patologjish të pashpjegueshme në çdo aspekt, në fund të fundit, mësimi – amanet i të paktën tre brezave të Maliqve, ka qenë: një Dibër e bashkuar dhe harrimi i përçarjes, si një vetëvrasje e së kaluarës, drejt një vështrimi të ri kombëtar. Që të flasësh për Maliqtë, duhet patjetër të zbulosh memorien shekullore dibrane, për të qenë me të vërtetë i hapur dhe një zë që rrahu të shprehë rrugën e vet. Ali Maliqi mund të flasë për këdo në emër të Dibrës së vet, që aq shumë e donte.

SHTËPIA E AGOLLËVE NË KËRÇISHT, BAZË E REZISTENCËS ANTIFASHISTE

Ndër të tjera, Avni Agolli kujton: "Nuk më shlyhet nga kujtesa dita e 7 prillit 1939, kur atë ditë erdhën nga Fushë-Kruja në Dibër babai dhe Feriku, të cilët u pritën në shtëpi nga tërë farefisi. Isha në klasën e dytë fillore kur, sapo mora çantën e po shkoja në dhomën time dëgjova që po qanin nëna e gruaja e xhaxhait, ndërsa gjyshja thoshte për mua: "Shyqyr, është i vogël e nuk di gjë!". Aty kuptova se kishte ngjarë diçka e rëndë. Të nesërmen babai shoqëroi në kufi Abaz Kupin dhe Myftar Kaloshin, ndërsa për vete nuk u largua. "Jo,- u tha babai,- kufirin ja ku e kam e në çdo kohë mund të largohem". Ai qëndroi në Shqipëri për të luftuar ndaj pushtimit fashist. Italianët filluan të sillen mirë, por arrestimi i babait dhe i Ferikut u bë për të evituar ndonjë kryengritje prej tyre. Mbas lirimit të Aliut dhe kur u kthye në shtëpi, kujtoja se kishte të njëjtat mendime me Dali Ndreun, Esat Ndreun, Haxhi Lleshin, Ahmet Jegenin, Shaban Strazimirin etj. Mirëpo kur mbas disa ditësh në shtëpinë tonë erdhën edhe Pajo Islami, Zoi Themeli, Ramadan Çitaku, Sotir Vullkani, Qazim Prishtina, si të thuash, delegatët e parë të PKSh-së në Dibër (janar 1942) dhe ndenjën 10 ditë e pastaj ikën, aty filloi debati i hapur me nacionalistët.

Sotir Vullkani e Pajo Islami shkuan në Sllovë, Zoi Themeli, Qazim Prishtina e Haxhi Lleshi në Kërçisht, në shtëpinë tonë. Influenca e Dali Ndreut ishte për faktin se motrën e tij e kishte Feriku për grua, ndërsa halla ime, Nazmija, ishte martuar tek Ymer Lleshi dhe këto familje gjatë luftës italo-serbe (1941-'43) u rreshtuan në anën e serbit. Mbas një arratie në Serbi, u kthyen në ilegalitet duke u strehuar në Kërçisht, te shtëpia jonë, për të luftuar bashkë kundër fashizmit. Gjatë luftës 7-ditore, më 5 prill 1941, midis serbëve dhe italianëve, për mua ka qenë e paharruar letra e Haxhi Lleshit, i cili më porosiste t'u thosha njerëzve të njohur të familjes në Dibër që të organizoheshin për t'u rënë trupave italiane nga mbrapa, në ndihmë të serbëve. Këtë ngjarje e kam treguar në "Bllokun e zi", por, faktikisht, përgjigjen e letrës e shkroi motra ime më e madhe, Nike Agolli, që kishte mbaruar shkollën fillore. Ajo që unë gjykoj sot ka të bëjë me logjikën e drejtë që disa forca të zonës ishin pro italianëve kundër serbëve sesa e kundërta, si për shembull Halil Alia, S. Kaloshi, Beqir Sina e, mbi të gjitha, do ta pësonte e tërë Dibra nga divizioni "Firence". Por Haxhi Lleshi nuk mori përgjigjen e kërkuar. Megjithatë, mareshal Zino, mbi 50 vjeç, i thinjur e çalaman, mbas mbarimit të asaj lufte më erdhi në shtëpi në Kërçisht. Ajo ngjarje dihet, se si 20 gjermanë i vunë përpara serbët. Nga gjithë kjo ndodhi me mareshalin italian, nuk më harrohet kur pas pëllëmbës së Zinos e shtyva përtokë dhe u largova me vrap, pastaj u fsheha mbi 4 ditë si i arratisur nëpër njerëzit e afërt të familjes sime. Të gjithë këtë e bëra që të mos dilte motra në skenë, se ne dibranët e kishim për turp, edhe pse dy vjet më e madhe se unë, ishte veçse 13 vjeçe. Mirëpo kur një ditë vjen një i deleguar i Haxhi Lleshit tek unë në shtëpi, se do të vinin me Ymer Lleshin, me sa më kujtohet më 12-13 prill 1941, për t'u strehuar nga arratia, i futëm natën, nga ora 2200 brenda. Aty ia tregoj Haxhiut ngjarjen e freskët, se kisha ngrënë një pëllëmbë. "Ç'ke ore ti, se do ta vras unë mareshal Zinon", më tha serbes Haxhiu. Më hyri garant Haxhiu se do ta vriste, por kur kaluan 2-3 ditë, dy kushërinj të tyre nga Dibra e Madhe, Iljaz dhe Hysen Karameta, vrasin një maqedonas, i cili dikur u kishte vrarë babën. E vranë për gjakmarrje dhe erdhën edhe këta të dy në shtëpinë time. Pra, u bënë katër. Domethënë u erdhi mirë se u bënë një bërthamë. Kjo ishte si me thënë lëvizja e parë antifashiste, jo komuniste, asnjeri nuk e kuptonte komunizmin, asnjëri nuk e dinte çfarë ishte ai. Jo më ideal komunist, por vrasës, dhe të tjerët që u bënë bërthama e parë, domethënë gjeneza e asaj lufte. Unë atëherë u topita, sepse po grumbulloheshin shumë vrasës, si për shembull Gani dhe Lutfi Greva, që kishin vrarë një kushëri të tyre për prona në Grevë dhe erdhën aty. Lutfi Greva është vjehrri i Besnik Mustafait, i ka dhënë vajzën. Qazim Reçi po për gjakmarrje ka vrarë, shto dy mirditorë, Frroku e Zefi, që ishin karabinierë e vodhën armët, si dhe të tjerë të kësaj natyre të arratisurish, 20-22-vjeçarë të akuzuar, iknin se mos i arrestonin. Pasi erdhën edhe këta u bënë jo pak, por 40 e ca veta, që u strehuan nëpër stane, në shtëpinë tonë me 3-4 dhoma e në mal ku veronin bagëtitë. Jo vetëm kaq, por përditë u çonim ushqime e çdo gjë. Ndërsa, nga ana tjetër, as mareshalin italian Zino nuk e vranë, derisa ai u larguan në Tiranë, edhe pse u lajmërua se do ta vrisnin. Kaloi viti 1941, kur na patën ardhur në shtëpi dy kalabrezë, Luixhi dhe Xhinoja, që dinin pak shqip, me origjinë të hershme shqiptare e që u larguan nga ushtria. Ne dyshonim për spiunllëk. Jo, ata e ndienin veten shqiptarë e silleshin shumë mirë. Nuk ishin si këta të parët, jo të një ideali komunist që, në fakt u bënë të tillë, nga vrasës, hajdutë, përjashtuar Haxhi Lleshin, që nuk njihej si i tillë.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Marrë nga libri "Ali Maliqi në historinë e Dibrës dhe Shqipërisë", botim i Shtëpisë Botuese BOTART.

arsim

Në kuadrin e 92 vjetorit të hapjes së shkollës së parë shqipe në Grevë, Dibër

Arsimi në rrjedhën e viteve për qëndresë dhe përparim

Nga **NEHAT DACI**

Këtë muaj, fshati i Grevës dhe fshatrat rreth e qark,së bashku me nxënësit e mësuesit, kujtojnë një ngjarje të rëndësishme për arsimin,edukimin dhe kulturën e kësaj zone,pasi në mars të vitit 1927 u hap për herë të parë shkolla e shqipe e Grevës, e cila për 92 vitet e funksionimit të saj,ka lënë gjithsesi gjurmë në historikun e arsimit në Dibër.

Të evokosh ngjarje që zanafillën e kanë në fillimet e viteve të shekullit të kaluar është paksa e vështirë,sidomos për ngjarje e evenimente që kanë të bëjnë me përhapjen e diturisë dhe dijeve në gjuhën amtare shqipe. Historia e arsimit tonë është një histori luftash, përpjekjesh, histori e një populli të vogël në numër, por të madh në botën e tij shpirtërore , në vullnetin e tij për të qenë i lirë dhe i pavarur. Në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare çështja e arsimit dhe shkollës shqipe u vu në qendër të vëmendjes së rilindësve tanë. Ato përcaktonin: "Në ka gjë për të cilën shqiptarët duhet të përkujdesen më tepër,ajo padyshim është DITURIA". Nuk ka më keq ,nuk ka fatkeqësi më të madhe për një komb nëse nuk komunikon e shkruan gjuhën e tij, sepse ai komb shumë shpejt shkërmoqet e shuhet. Për ta mbajtur të nënshtruar, Bizantinët dhe Osmanët në më shumë se 5 shekuj,jo vetëm nuk u interesuan për zhvillimin e brezave të ardhshëm të shqiptarëve por u munduan me të gjitha format për të shuar gjuhën kombëtare,traditat,zakonet ritet që ky popull kishte trashëguar që në kohën e Ilirishtes. Pra shtrohej problemi: Do të bëhej shtet Shqipëria apo do të zhdukej në vorbullën e historisë,duke u përpirë nga lukunia e fqinjëve.Pra një komb kursesi nuk mund të bëhet nëse nuk ka gjuhën e tij,kulturën e tij, shkollën e tij. Ndaj ishte pikërisht gjuha dhe shkolla ,ato që u bënë idhulli i shpresës,sofra e parë që do të bashkonte shqiptarët e do ti përgatiste ato njëherazi edhe për betejat e ardhshme.



Drejtori M.Xhembulla,mësuesi S.Muglica, D.Shehu me rrethin e biologëve dhe kimistëve te rinj.

GURTHEMELET E SHKOLLËS SHQIPE...

Falë të parëve tanë, gjysh pas gjyshi e brez pas brezi me guximin dhe fanatizmin më të madh ruajtën dhe trashëguan gjuhën , zakonet e traditat shqiptare. Në trojet shqiptare,tek tuk, tinëz hapej ndonjë shkollë ,mejtep ku mësohej turqisht dhe shqip pa lejen e autoriteteve turke ,por ato mbylleshin sapo të merrej vesh nga qeveria osmane.Pas viteve 1800,filluan përpjekjet për identifikimin e gjuhës shqipe. Identifikimi i shqipes kishte të bënte me identifikimin e kombësisë. Pikërisht pas këtij fakti u kapën fort patriotët tanë. Lanë mënjanë dasitë fetare,krahinore,bindjet,idetë,u benë një për çështjen më të madhe të kombit për hapjen e shkollave shqipe në mbarë Shqipërinë. Kështu u krijuan mjaft organizata patriotike, si federata:"Atdheu", "Lidhja e mësuesve",e më vonë shoqëria "Bashkimi" etj., veprimtaria e tyre u fokusua përveç çështjes së formimit të shtetit shqiptar edhe përhapjes së shkollave në gjuhën shqipe. Në këtë kuadër u bënë përpjekje dhe u botuan një varg abetaresh; si ajo e Naum Veqilharxhit (1844, 1845), e Konstandin Kristoforidhit (1867, 1868), e Daut Boriçit (1869), "Allfabetarja e Stambollit" (1879) etj. Një kontribut të rëndësishëm zhvillimit të arsimit dhe të shkolles shqipe i dha edhe "Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip" e Stambollit në krye me Sami Frashërin. Edhe Luigj Gurakuqi evidentonte:

"Çështja e arsimit,ka rëndësi kryesore në rilindjen e kombit shqiptar, pse vetëm me një mësim të shëndoshë, me një arsim të vërtetë mund të ngjallet e mund të mëkëmbet kombi ynë e mund të fitojë të drejtën për me hymun në radhën e popujve të qytetëruar","Gjuha e ndriton kombin- thoshte Naim Frasheri- e ndriton dhe e nxjerr nga errësira".

Ashtu si në gjithë Shqipërinë në fillim të shekullit XIX, edhe në krahinën e Dibrës mori hov lëvizja arsimore me hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Rezulton se shkolla shqipe në Dibër janë hapur shumë herët : si në Dibër të Madhe (Shehër), Zerqan, Bllacë e Homesh,por u mbyllen shpejt sapo u diktuan nga autoritetet turke. Dhe s'reshte së theksuari Said Najdeni "që shqiptarët të shpëtojnë nga rreziku ka vetëm një rrugë: me u zgjua kombi, me mësue gjuhën e tij, me i dalë zot vetes".

Hapja e shkollës së parë shqipe në Korçë, më 7 mars 1887, u bëri të qartë shqiptarëve se gjuha dhe shkolla shqipe ishin kërkesa reale, se rruga drejt shkollës shqipe dhe alfabetit shqip nuk ishte më një utopi, por një gjë krejt normale; e realizueshme dhe e prekshme. Në vitin 1887 edhe në Rekë(Verbian) të Dibrës u hap një shkollë shqipe, por u mbyll shpejt nga autoritetet turke.

Me inisiativën e tyre patriotët dibranë zhvilluan disa kuvende e takime për çështjen e arsimit. Më 1 nëntor 1889 Kongresi i Arsimit i Dibrës i dërgoi Sulltanit një promemorie të firmosur nga 31 vetë, ku kërkohej hapja e një shkolle shqipe në Dibër. Në këtë kërkesë ndër të tjera thuhej :"Meqenëse në qytetin tonë Dibër flitet vetëm shqip dhe fëmijët e popullatës nuk kanë patur mundësi që të marrin mësim në gjuhën tonë amtare, kërkojmë që të na lejohet hapja e një shkolle me shqipen si gjuhë mësimi,dhe të gjitha shpenzimet do ti paguajnë patriotët vetë".

Dhe nuk vonoi, e shkollat e fshehta të Said Najdenit në Dibër të Madhe, (1888), Shaqir Daci Homesh (1893), Hamdi Ohrit në vitin 1901 lëshuan metastazat e njëherazi hapen edhe dhjetë shkolla shqipe në fshatrat e Dibrës së sipërme e të Dibrës së poshtme. Në vitin 1899, në Dibër kishin mësuar të shkruajnë e të lexojnë në shqip më shumë se 300 persona. Fëmijët e Dibrës Madhe, Peshkopise, Gollobordes, Zerqanit, Homeshit, Bulqizes, Kastrotit, Dohoshisht, Brezhdan, Trojak, Zogjej, Bllacë etj.,filluan të belbëzojnë e shkruajnë të bukurën shqipe. Pra hapja e shkollave në gjuhën shqipe ishte një luftë,një luftë që duhej të fitohej me çdo çmim e me çdo kusht, se përndryshe shkollat turke, greke e serbe kishin nxjerrë kthetrat për gllabërimin e shuarjen e shqipës e në çdo moment villnin helm e vrer antishqiptar,me synim asimilimin total të kombit tonë.

Shkollat e hershme shqipe edhe në Dibër ,kishin karakter fetar. Ato kishin edhe lëndë fetare dhe në to përdoreshin edhe tekste me përmbajtje fetare. Ishte ajo kohë kur konceptet gjuhë, fe, atdhe, ishin të pandara.

Arsimi shqip në Dibër mori dritën jeshile vetëm më 10 mars 1912, kur valiu i Manastirit lejoi të hapej shkollë shqipe në Dibër të Madhe.

Qeveria e Vlorës për kushtet dhe rrethanat e saj, bëri përpjekje modeste fillestare për ligjshmërinë arsimore. Gjuhën shqipe e shpalli gjuhë zyrtare të shtetit shqiptar, shkollës i dha karakter shtetëror, bëri përpjekje për arsim fillor të detyruar etj.

U hap shkolla shqipe e lejuar nga autoritetet shtetërore në qytetin e Peshkopisë, më 14 prill 1914 në shtëpinë e Sheh Besimit, me mësues të parë Haki Sharofn, dhe shkolla e Trebishtit në Gollobordë më 15 prill 1914, nga mësuesi Ramiz Qatja.

Golloborda është krahina që ka dhënë edhe tre martirë të gjuhës e të arsimit shqip: Vasil Mlladen Pleushku, Haziz Lila dhe Hoxhë Moglica, të cilët vunë jetën e tyre në themelin e arsimit e të gjuhës shqipe.

Në vitin shkollor 1915- 1916 u hap shkolla në Dohoshisht me mesues Kamber Spahiu. Më 1916 u hap shkolla në Trojak të Sllovës nga Haki Sharofi. Shkolla e Sohodollit u hap në vitin 1916 me mësues Aqif Pasholli. Në vitin shkollor 1916-1917 u hap shkolla në Allajbegi me mësues Hebip Bajram Golja. Në Homesh shkolla u rihap në vitin 1918. Në po këtë vit shkolla u hap edhe në Sopot . Shkolla e Okshtunit u hap në vitin 1922 me mësues Osman Muglicën. Shkolla e Sllovës, te Kepi i Gjatë (Depoja e vjetër) është hapur në vitin 1922-23 me mësues të parë Abdulla Çangën. Më 1922 u hap për herë të parë shkolla shqipe në Lurë, në shtëpinë e Dali Koçekut nga Musa Kuqi (Shehu). Shkolla në Kala të Dodës u hap në vitin 1922 nën kujdesin e patriotit Hasan Prishtina. Shkolla e Luznisë u hap me 1923 me mësues Shaban Ostrenin.

Me shkresën datë 5/XI/ 1924 kërkohet hapja e një shkolle në Herbel, ku të mësonin fëmijët e Popinarës, Erebarës, Grazhdanit, Dovalanit, Trepçës, Pjeçës e Pejkës.

PRAGSHKOLLA E GREVËS...

Fshati ynë, Greva,ndër vite e në breza ka evokuar histori,ka luftuar për identitet,dinjitet,përparim e shkollim. Grevasit gjithmonë kanë qenë krenar e kryelartë(vetë emri Grevë është mjaft sinjikativ). Kanë qenë tepër kompakt, të panënshtruar e tepër luftarak ndaj pushtuesve të huaj.

Akoma ruhen në kujtesën e etërve tanë qëndresa ndaj turqve. Selë Daci u vra në përpjekje me turqit në Ravna. Thirrjes së turqve për tu dorëzuar(lidhur) iu përgjigj me nagant, por turqit të shumtë në numër e vranë, ndërsa Hasan Fidën e internuan dhe e burgosën në Manastir. Dy herë fshati ynë është djegur e bërë shkumb e hi nga shkjatë serb. Vlen të theksohet qëndresa heroike të gjithë fshatrat e Grevës ndaj serbëve, në vendin e quajtur "Kepi Shehut" ku thyen taboret serbe dhe nuk u lejuan që të futeshin në fshat.Gjatë këtyre luftimeve ra në fushën e betejës : Alush Bunguri, u kapën dhe u ekzekutuan: Tufik Baruti,Shqir Korumi,Karahman Hoxha, u plagosën Maliq e Dalip Kryemadhi. Për trimëri u dalluan: Hasan Fida,Rifat Rexhepi etj.

Greva është bombarduar nga gjermanët ,nga Moranica e Dibra së Madhe, dhe nga gjylet e topave është vrarë Riza Kryemadhi,Shahin Merdani. U plagos Hajrullah Kaba. Si baza të strehimit të partizanëve në fshatin Grevë duhet të përmendim : Fiqiri,Ilmi,Fuat Baruti, Zeqir e Shahin Bunguri, Zabit Hoxha, Rifat Rexhepi, Sami Deshati, Rushem e Alush Tifeku etj. Për çlirimin e vendit nga ky fshat rrokën armët e luftuan mbi mbi 30 djem e burra. Në këtë luftë dhanë jetën për liri,dy djem të kësaj shkolle;Mustafa Bunguri e Haki Zerja .

Greva, ndër vite e në breza ka evokuar histori, ka luftuar për identitet, dinjitet, përparim e shkollim. Grevasit gjithmonë kanë qenë krenarë e kryelartë (vetë emri Grevë është mjaft sinjikativ). Kanë qenë tepër kompakt, të panënshtruar e tepër luftarakë ndaj pushtuesve të huaj.
Akoma ruhen në kujtesën e etërve tanë qëndresa ndaj turqve. Selë Daci u vra në përpjekje me turqit në Ravna. Thirrjes së turqve për t'u dorëzuar (lidhur) iu përgjigj me nagant, por turqit, të shumtë në numër e vranë, ndërsa Hasan Fidën e internuan dhe e burgosën në Manastir.

Të parët tanë janë përpjekur për progres,zhvillim, dije e kulturë në ndërtimin e një jetese sa më të mirë. Si fshat shumë afër qytetit të Peshkopisë, Greva kishte jo vetëm lidhje miqësore por dhe ndikime nga jeta dhe formimi arsimor e kulturor qytetar.

Në Dibër,Greva është njohur e njihet si fshat me tradita jo vetëm me tradita patriotike atdhetare,por edhe për mënyrën e jetesës,me bujarine, mikpritjen, besën,ndihmën e ndërsjelltë me mjaft njerëz të shkolluar e intelektuale.

Qysh në kohrat e hershme,mjaft nga djemtë më të mirë të fshatit, në përpjekjet e tyre për përparim e zhvillim, filluan të emigrojnë në dhera të huaja, Atje filluan të njihen me kulturën e Evropiane e më gjerë.Lindi nevoja e komunikimit e letërkembimit,me familjarët dhe të afermit e tyre.

Më tregonin të moshuarit: Zabit Hoxha,Tosum Fida, Qazim Daci, edhe ato pak letra që mund të dërgonin kurbetlinjtë e fshatit ishin në gjuhën turke,arabe e familjarët duhej të ecnin me ditë të tëra me gjet ndonjë njeri që dinte për ta përkthyer e lexuar diku letrën.Kushtet dhe rrethanat evoluan, lindi nevoja e leximit dhe shkrimit të gjuhës shqipe.

Ja çfarë shkëputa nga kujtimet e plakut Adem Fida. "Bashkë me Hysen Zeren e Muharem Shabanin shkuam në Peshkopi, në prefekturë. Krahas shumë problemeve të fshatit u interesuam edhe për ndonjë mësues për të hapur shkollen shqipe në Grevë. Falë fatit,rastësisht muarëm vesh se në fshatin Herbel ishte caktuar një mësues nga Kosova, por herbelasit ishin pishman për hapjen e shkollës. Rasti na erdhi kubalem në derë, shpejt dhe papritur. Aty për aty vendosëm menjëherë e iu drejtuam autoriteteve të prefekturës, me lutjen që këtë mësues ta sillnin në fshatin tonë ,pasi ne ia siguronim fëmijët,strehimin etj. Mirë na thanë. Shkoni në Herbel, bisedoni me fshatarët atje, dhe nëse bini dakord na njoftoni dhe merreni mësuesin. Po atë ditë vajtëm në Grevë, mblodhëm fshatin dhe kryepleqësia ngarkoi: Rifat Iljazin(Rexhepi), Riza Kryemadhin dhe mua ,Adem Fidën që të shkonim në Herbel. Shkuam në Herbel- vazhdon tregimin-Ademi- . Jo vetëm që na pritën me shumë respekt por dhe me shumë kënaqësi pranuan kërkesën tonë. Na sajdisën me një drekë të mirë e na përcollën duke u shprehur nën zë me shprehjen; shyqyr që na e hoqët mësuesin qafe, (fshati ishte me dy fe,myslimane dhe ortodoks),se duke hapur shkollën fëmijët do t'na beheshin kaur".

(vijon në numrin e ardhshëm)

Njerëzit që e kanë njohur si dhe nxënësit e tij, e kujtojnë me respekt Hafiz Xhemalin për veprën e tij, për aftësitë e tij intelektuale e fetare që i vuri në shërbim të Atdheut dhe Islamit.

Hafiz Xhemal Dibra, intelektual, teolog dhe patriot i shquar

(vijon nga numri i kaluar)

Në klimën e pasigurisë për jetën, në muajve mars, prill, maj të vitit 1924, ai qëndroi në krye të detyrës dhe këtë kërkonte prej të gjithë parlamentarëve që nuk paraqiteshin, e kërkoi të lajmërohen të gjitha Bashkitë dhe Asamblistët se *"Asamblea asht e hapun tue pasë shumicën legale, se këtu nuk ka anormalitet,"* dhe propozonte masa administrative për asamblistët që banonin në Tiranë dhe nuk paraqiteshin në detyrë.

Hafiz Xhemali karakterizohej nga një tolerancë fetare dhe politikë shembullore. Në periudhën janar-qershor 1924, Hafiz Xhemali dhe Fan Noli, njeri hoxhë e tjetri prift, njeri i popullores e tjetri i përparimtares, pra "kundërshtarë politikë", në parlament qëndronin në krah të njeri tjetrit, e respektonin dhe e donin njeri tjetrin. Ata bisedonin shpesh për tema shoqërore dhe fetare, që kishin lidhje me ngjarjet e kohës dhe gjenin gjuhën e përbashkët për zgjidhjen e problemeve gjithmonë me zgjidhje institucionale dhe jo me dhunë, sepse kjo e fundit binte ndesh edhe me besimet fetare, përfaqësues të të cilave ata ishin.

Të shtunën e datës 17.05.1924, në ora 15 ^{00} hapet mbledhja e Asamblesë e cila fill pas hapjes, Hafiz Xhemali i kërkon kryetarit që, përpara se me hy në bisedim, propzoj pesë minuta heshtje për të nderue të ndjerin Avni Rustemi (propozimi pranohet). Theksojmë se, me Avniun ai ishte në parti kundërshtare. Shtëpia e Hafizit në Tiranë priste e përcillte shumë miq e hallexhinj, të cilët ai përpiqej t'i ndihmonte me çdo mënyrë, e shumë prej të cilëve ishin me pikpamje të ndryshme politike. Ai nuk i dallonte njerëzit nga pikpamjet e tyre politike, e aq më pak t'i shpërfillte kundërshtarët. Njerëzit ai i vlerësonte nga virtytet, patriotizmi, morali, dhe sjellja e tyre shoqërore e jo nga postet apo pasuritë, që edhe mund të mos përputheshin me virtytet e më sipërme. Ditën e Pashkës apo të Bajtamit, që në mëngjes herët ai fillonte vizitat te të njohurit dhe miqtë e tij të shumtë, duke filluar nga më të varfërit, sepse si thosh ai, *"ndaj tyre kam më shumë detyrim, e te ata ndjej më shumë gëzim."*

Një shembull tipik i shpirtit liberal dhe tolerant të tij është ai i vitit 1927, gjatë qëndrimit disa ditor në Selanik, në rrugën e kthimit nga Turqia, ku së bashku me patriotin Rauf Fico, nënshkruan marrëveshjen për mos pranimin e kosovarëve në Turqi, ku serbët kërkonin t'i shpërngulnin për t'a pastruar Kosovën prej shqiptarëve, gjë që ndikoi edhe në ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar të trojeve shqiptare në Jugosllavi. Gjatë kohës që Hafizi qëndroi në Selanik, kohën e lirë e kalonte me të dënuarin me vdekje në mungesë nga regjimi i kohës, me patriotin Hasan Prishtina.

Pavarësisht se Hafizi nuk pajtohej me format dhe mjetet e përdorura nga Hasan Prishtina dhe shokët e tij, për arritjen e qëllimeve politike, ai vlerësonte lart vlerat atdhetare të Hasanit, për të cilin ruante një respekt dhe vlerësim të lartë, si një patriot i madh. Hafiz Xhemali, një njeri i thjeshtë që kishte mbrritur të arsimohej për hir të inteligjencës dhe vullnetit të tij të hekurt, ishte arsimdashës dhe përkrahës i flaktë i të rinjve që e donin arsimin dhe kulturën. Ai, si intelektual, si besimtar e kishte kuptuar se një popull e një shtet nuk mund të përparojë pa njerëz të arsimuar.



Nuk janë pak ata të rinj të dalluar për rezultatet e tyre në shkollat e mesme, që u nxitën e u përkrahën nga Hafiz Xhemali, për të thyer së pari mentalitetin e prapambetur që i kundërvihej nevojave, si luftës për dije, kulturë e përparim.

Ai vlerësonte dhe inkurajonte shkollimin e të rinjve brenda e jashtë shtetit, u kundërvihej me forcë zvarritjeve burokratike për miratimin e kredisë për pagesat e bursistëve dhe këkon të miratohet ajo urgjentisht, sepse për ndryshe studentët do të mbeten rrugëve të Europës pa të holla.

Një tregues tjetër që flet se sa e vlerësonte ai dijen dhe kulturën ishte biblioteka e tij e pasur me libra fetare, juridike, letërsi turko-arabo-perse, pos sidomos shqipe, për të cilën ai thoshte se kishte shpenzuar rreth gjysmën e rrogës së tij mujore, që për funksionet që kishte pasur, nuk duhet të kishte qenë e vogël.

Po këtë kërkonte edhe për senatin, sepse thoshte : *"Shpesh na duhet të bredhim lart e poshtë , madje edhe të mos gjejmë literatutë për t'u konsultuar për probleme ligjore-juridike që na lindin gjatë hartimit të legjislacionit shqiptar"*.

Gjithmonë në mbrojtje të së drejtës, ja se **ç**'thotë ai mbi ligjin e shpronësimit të pasurive në kryeqytet, duke kundërshtuar mendimin e disa kolegëve që thoshin se tiranasit të mos kërkojnë shumë, se ata shpërblimin e kanë marrë që në çastin kur Tirana u bë kryeqytet dhe ai thotë : *"A asht e drejtë që për këtë të dënojmë disafëmijë me ju prishë shtëpitë e me i qitë familjet në rrugë. Pra, për të mos me i thye zemrat që do të apin mallkime, them se ma parë duhet me u marrë vullneti i tyre tue ju pague **ç**mimi i sotëm. Zbukurimi i kryeqytetit nuk mund të bëhet vetëm me sakrificën e disa pperasonave dhe me të ardhurat e bashkisë, por si**ç** e kanë ba të gjitha shtetet, zbukurimin e kryeqytetit ja kanë ngarkue buxhetit të shtetit, kështu duhet të veprojë edhe qeveria jonë. Ç'do kujt që i shembet shtëpia i duhet ba pagesa kesh nga nji kredi shtetërore"*.

Si intelektual dhe teolog i shquar, pjesëmarrës në kongrese ndërkombëtare të shkencëtarëve islamë, si njohës i thellë i fesë islame që i dëgjohej fjala midis muslimanëve shqiptarë, ai mori pjesë në përpilimin e raportit justifikues dhe të fetvasë për zbulimin e fytyrës, duke deklaruar se : *"... dogma fetare myslimane nuk ka të bëjë me mbulimin e fytyrës së gruas"* dhe e mbyll ligjëratën e tij me këto fjalë : *"Ç'do shqiptar mashkull duhet t'a konsiderojë femrëm si mëmë, motër, bijë, e kështu duhet ta konsiderojë mashkullin si babë, vëlla, bir, ashtu sikur e ka zakon shqiptari ta ruajë nderin."* Për këtë qëndrim përparimtar e të emancipuar, ai mori me qindra letra, kartolina e telegrame përgëzimi nga gratë shqiptare.

Në të gjitha diskutimet e tij ndjehet kërkesa për respektimin e ligjeve themelore të shtetit, të rregullave të proçedurës parlamentare, të sensit të arsyes dhe të masës, i drejtësisë shoqërore. Në çdo detyrë që iu ngarkua, ai ka dalë faqebbardhë dhe ka treguar një ndershmëri të admirueshme. E tillë qe edhe detyra delikate për mos lejimin dhe denoncimin e abuzimeve gjatë shpërndarjes së ndihmave qeveritare në kohën e krizës botërore të viteve 30-të, që u shoqërua me zinë e bukës në Shqipëri. Puna dhe ndershmëria e tij u shpërblyen me dekorim. Për një periudhë kohe, ai ka dhënë kontributin e tij si drejtor përgjegjës i gazetës "Besa".

Kur qeverisë shqiptare iu dorëzua ultimatum fashist në prill 1939, ai mbajti një fjalim të zjarrtë në Parlament, duke kërkuar *"arrestimin e të gjithë italianëve që ndodheshin në vendin tonë"* si kundërpërgjigje. Ai u bëri thirrje kolegëve të tij, *"të veshin opingat, të ngjeshin pushkën në krah e të dalin të presin armikun ashtu siç e ka zakon shqiptari"*.

Fjala e tij ishte e sinqertë e dilte nga shpirti i një atdhetari të sprovuar. Fjalime patriotike pati edhe nga ndonjë koleg tjetër në Parlament, por për çudi, pas disa kohe ato morën poste të larta në qeveritë kolaboracioniste, ndërsa Hafiz Xhemali burgosej dhe internohej në Itali, me porosinë që të vendosej në një vend ku nuk kishte studentë shqiptarë. Kjo sepse dihej botërisht se gëzonte dashuri dhe respekt të veçantë midis popullit të thjeshtë e, sidomos, midis të rinjve. Internimi për 4 vjet motivohej me fjalët : *"Njeri me influencë në Shqipërinë e mesme dhe veriore. Armik i betuar i fashizmit."*

Qëndrimi dinjitoz i një besimtari të devotshëm islam, efektet që krijonin te njerëzit fjalët e tij, i mahnitën qytetarët e Bergamos, që e dëgjonin dhe e përcillnin nga afër jetën e tij dhe për këtë, i dërguan një lutje Papës, ku kërkohej ndërhyrja e tij për lirimin nga internimi të Hafizit duke përdorur shprehjen: *"Qeveria ka internuar një njeri të shenjtë"*. Kur afati i internimit të tijmbaroi, Bashkia e Bergamos i bëri thirrje që Hafizi me familje të qëndronin, duke marrë përsipër edhe sistemimin e tyre. Pas kthimit nga internimi, në vite 43-44, Hafizi, edhe për moshën që kishte (63 vjeç), nuk u aktivizua në politikë, duke iu përkushtuar vetëm fesë si mësues në Medrese. Në vitin 1947, iu shtetëzua shtëpia e ndërtuar më 1934, në të cilën nuk banoi asnjë ditë, sepse u detyrua t'a lëshojë me qira, për të shlyer borxhet që kishte marrë për të. Më pas, e nxorrën nga shtëpia ku bananin me qera dhe përdhunisht u vendosën në Laprakë.

Lutja që Hafizi drejton për shfuqizimin e vendimit të shtetëzimit, shoqërohet me dokumentet që vërtetojnë burimet financiare të përdorura për ndërtimin e shtëpisë, si : shitja e shtëpisë në Stamboll, të ardhurat nga shitja e tokave të së shoqes në Greqi, huatë e bankës, si dhe të hollat e fituara me djersë. Në përgjigjen e Komisionit të Komitetit Ekzekutiv thuhet : *"Hafiz Xhemali ka pas qenë Deputet i Dibrës, të cilin vend e pat monopolizue për vehten e tij, senator në regjimin antipopullor dhe shtypës të Zogut, anëtar i grupit të besaxhinjve, organ ky që në vend që të nepte dritë e kulturë popullit, shpërndante errësirën... e më tej dhe për djersën që Hafiz Xhemali përmend në lutjen e tij, kjo ishte helm për popullin..."* E kështu përveç shtëpisë i sekuestruan edhe kambalecat e cigareve, dollapet e librave, radioja dhe gjithçka tjetër që i ndjeri i kishte sjellë prej Stambolli. Me që Lapraka ishte shumë afër Tiranës, u urbanizuan në Durrës, pa i siguruar as banesë, as mjete jetese. Të njohurit e morën në shtëpinë e tyre dhe besimtarët e ndihmuan për të jetuar. Me që në Durrës u bë tepër popullor, e urdhëruan të rikthehet në Tiranë , përsëri në mëshirë të fatit.

Komuniteti Mysliman, personalisht kryetari i saj, Hafiz Musa Basha, e emëroi disa herë si mësues, si kujdestar konvikti, madje edhe si drejtor të Medresesë, por shpejt, me urdhër nga lart e nxirrnin në rrugë të madhe. Më kujtohen takimet e Hafiz Xhemalit me Hafiz Ali Korçën, patriot që përveç se me penë, luftoi edhe me pushkë për lirinë e Shqipërisë, i internuar në Kavajë, që qanin hallet e Atdheut e të besimtarëve islamë të mbetur pa barinj, sepse pjesa më e kulturuar e hoxhallarëve ose ishin ekzekutuar, ose ndodheshin në burgje e internime.

I mbetur në rrugë të madhe, në pamundësi ta mbante, bibliotekën e tij të madhe ia dhuroi Medresesë, që u shpërdorua dhe u dogj pas ndalimit me dhunë të veprimtarive fetare në vitet 60-të. Po të njëjtin fat pësoi edhe fondi shqip i bibliotekës së tij, e shpërndarë lart e poshtë, së bashku me të humbën botime të rralla të rilindasve, koleksione të gazetave e revistave që ishin botuar në Shqipëri.

Me gjithë persekutimet e padrejta që pësoi, ai nuk u ankua kurrë, nuk u pendua për kthimin në Atdhe, sepse udhëhiqej nga sentenca *"T'i kthesh shpinën Atdheut është faji më i rëndë"*. Ai gjente ngushëllim te kontributi i tij i madh për çështjen e Atdheut dhe te kontributi për edukimin e të rinjve të Medresesë së Tiranës. Në shkurt të këtij viti mbushen 60 vite të ndarjes nga jeta të këtij atdhetari të shquar e të përkushtuar për kombin. Njerëzit që e kanë njohur si dhe nxënësit e tij, e kujtojnë me respekt Hafiz Xhemalin për veprën e tij, për aftësitë e tij intelektuale e fetare që i vuri në shërbim të Atdheut dhe Islamit. Më 2016 u dekorua me medaljen "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës. Në shkurt të këtij viti ne kujtojmë me nderim

Astrit Daci


Tiranë janar 2019

BURIMET E INFORMACIONIT

1. *Bisedimet e Kuvendit Kushtetues 1924, Tiranë*
2. *Bisedimet e Asamblesë Legjislative 1925-1926 , Tiranë*
3. *Bisedimet e Asamblesë Konstituente 1925-1926, Tiranë*
4. *Bisedimet e Senatit 1925-1926, Tiranë*
5. *Koleksioni i Gazetës "Paqja" 1923-1924, Stamboll*
6. *AQSH, Letra dhe dokumenta për shoqërinë "Bashkimi"*
7. *Kujtimet e znj. Triumfe Hoti (e bija e Hafiz Xhemalit)*
8. *Kujtimet e z. Astrit Daci (nipi i Hafiz Xhemalit)*

Mallkimi i sheh Murat Begut

Nga **OSMAN XHILI**



Historia që po tregojmë ka ndodhur këtu e pesqind e ca vite më parë, në fshatin e Allejbegisë. Sheh Murat begu, njeriu që ndërtoi xhaminë e këtij fshati, ka qenë në atë kohë njeri me shumë influencë, jo vetëm në fshatin ku banonte, por dhe në rrethinat për rreth. Thuhej se kishte miqësi të ngushtë me Agollet e Kërçishtit dhe me gjithë paritë e zonës dhe thirreshin për çdo sebep.

Duhet të ketë qenë atë mot, e shtunë apo e diel, ditë pazari. Zakonisht, sheh Murat begu shkonte në Dibër të Madhe, jo vetëm për të bërë pazar, por dhe për të takuar shokë e miq të shumtë, që kishte atje. Ashtu kishte bërë dhe asaj dite, duke u kthyer pak i lodhur në shtëpi. Sheh Murat begut i kishte ndërruar jetë gruaja e tij e parë, duke lënë një djalë, diku te tetëmbëdhjetë vjeç. Me gruan e dytë kishte një djalë tjetër motak. Djali i ri me njerkën nuk i kishin marrëdhënjet shumë të mira, por prania e babait ishte e mjaftë, që ndonjë flakë e vogël zemërimi të fikej menjëherë nga të dyja palët.

Me të dëgjuar hingëllimën e kalit dhe patkonjtë e tij që u përplasën në kalldrëm, nusja e re i doli përpara të shoqit dhe e përshëndeti. Pak minuta më vonë u shtruan të hanë drekën dhe më tej akoma një kafe të freskët, nga ajo që kishte sjellë i shoqi nga pazari. Mungesa e djalit të madh i ra në sy dhe e pyeti zonjën se ku ishte. – Nuk e di ku ka dalë, u përgjigj ajo. Vetëm nga zëri, sheh Murat begu e kuptoi se diç kishte ndodhur. – U zutë prapë me të, pyeti sërish i shoqi. - I kërkova të priste pak dru, foli gruaja me një zë të ulët, dhe ai nuk i preu. Kur i thashë se do ti tregoj babait tënd, ai u nxeh dhe ma hodhi djepin, bashkë me fëmijën poshtë shkallëve.

Sheh Murat begu u ngrit në vrikth, duke lënë filxhanin e kafes pa pirë akoma. U afrua tek djepi, që ishte vetëm pak metra më tej dhe e tërhoqi mengadalë napën e bardhë, që ishte mbi krye të fëmijës. Një fytyrë engjëllore u shfaq përpara syve të tij. Ai kurrë nuk e kishte parë me shumë vemendje djalin e tij të vogël. Burrat e asaj kohe nuk duhej të jepeshin shumë pas fëmijëve të vegjël. Kapakët e syve të mëdhenj notonin në një gjumë të thellë dhe ai besonte se vetëm engjëjt e kishin ruajtur djalin motak, pa pësuar as gjënë më të vogël. Përherë të parë e puthi djalin e tij të vogël dhe ngriti duart lart, në shenjë falenderimi ndaj Zotit, që kishte bërë njëmrekulli të madhe me djalin e tij.

E përfundoi kafen dhe doli në telis të kullës dykatshe. Hodhi sytë në oborrin e mbushur me pemë, por nuk e dalloi djalin e madh asgjëkundi. E thirri dy tre herë dhe më së fundi ai u përgjigj. Pak minuta më vonë, erdhi dhe vetë, qëndronte duke qëndruar para të jatit, me kokë të ulur nga faji dhe frika, të bëra bashkë, në pritje të ndonjë ndëshkimi të fortë. Babë e bir, qëndruan kështu për disa minuta, por i jati nuk e ndëshkoi këtë rradhë dhe pse faji kishte qenë më i madh se herët e tjera. Ndoshta kishin qenë dy arsye që nuk e lanë. Djali ishte zgjatur jo pak dhe i kish kaluar 18 vjeç, nuk mund të rrihej më si fëmijë. Nga ana tjetër i erdhi keq për të, një fëmijë që ishte rritur shumë vite pa nënë. Dhe ai vetë si baba, shpesh i kishte munguar, duke u angazhuar në luftra, në miqësira, në vizita dhe në takime të ndryshme. Mungesa e të dyve e kishin bërë pak nervoz, gjë që e kishte shprehur ndonjëherë në veprimet e tij.

-Laju e ndërroju, se do të shkosh në dasëm , në Kërçisht, te Agollet. Djali ngriti pak kokën, të shohë nëse babai e kishte seriozisht, por në fakt nuk dukej asnjë lloj dyshimi për këtë. Nuk i ka treguar mjerka për ndodhinë, apo si është puna?

-Nuk shkoj, se nuk më njeh mua njeri, atje.

-Do të shkosh, se je në emrin tim, në emrin e sheh Murat begut. Na këto lekë dhe do ti lesh në kafe. Na dhe një paqetë, që do t'jua japish njerëzve për ta shpërndarë në konak. Merre kalin dhe shko! Djali nuk po lëvizte. Sheh Murat begu nuk e ndëshkoi fizikisht, por zemra e tij ishte bërë gur.

-Shko o djali im! Shkofsh shëndoshë e mirë dhe bëfsh qejf. Kur të kthehesh, tu pengoftë ati (kali). Ku të raftë kria(koka) u bëftë xhamia, ku të raftë medisi(mesi) mbiftë lisi. Ata qëndruan dhe pak kohë pa lëvizur, si statuja. As vetë njeriu që i nxorri ato fjalë, nuk e diti se si. Nuk kishin dalë nga goja, kishin dalë nga zemra. Do të dëshironte ti kthente prapsh ato fjalë, atë mallkim që kurrë nuk e kishte bërë, por e dinte që tashmë çdo gjë qe e kotë. Ata kishin dalë, në një dalje pa kthim, si një plumb që le armën dhe kërkon të arrijë në destinacion. Më pas djaloshi tërhoqi këmbët zvarë, sikur u kërrus nga pesha e mallkimit që i ra përsipër.

U la, u ndërrua me rroba të mira dhe u nis. Shkoi në dasëm dhe u kënaq. Bile për pak kohë harroi dhe atë skenën me babain e tij. Agollet bënin dasëm të madhe dhe kishte shumë të ftuar. Pasi kishte lënë paratë dhe paqetën duke i uruar në emër të të jatit, ai ishte bashkuar me të rinj të tjerë, duke luajtur e kërcyer. Erdhi koha e kthimit. Kali po ecte me një hap të shpejtë dhe djali ishte jo pak i stërvitur. Ja tek u dukën shtëpitë e para të fshatit në lagjen e Çiflikut. Kali nuhati diçka, një aromë, apo një zhurmë dhe u tremb. Flegrat e hundës i hapi fort dhe turfulloi. U ngrit në dy këmbët e para dhe u lëshua me revan. U tremb dhe djali. Mos vallë mallkimi i babait, që e kishte harruar si një ëndërr të keqe, po shfaqej pikërisht tani? I futi këmbët fort në yzengji, u shtrëngua akoma më fort në shalën e bukur dhe tërhoqi frerët. Kali u tremb akoma më shumë, sikur e kapën xhindet. Frerët ikën nga duart e djalit dhe u varën poshtë nëpër këmët e kalit. Duart e djalit u zgjatën në kërkim të frerëve, pa arritur ti kapnin dhe trupi u var poshtë kokës së kalit. Këmbët e djalit ishin zhytur fort në yzengji e nuk shqiteshin dot, duke qenë pika e vetme që bashkonin trupin e tij me kalin. Koka e djalit u var akoma më poshtë, duke takuar në tokë,ndërsa kali e shtoi akoma më shumë revanin duke turfulluar e hingëllirë me të madhe. Plasi gjaku nga hundët, u ça dhe balli, u thyen dhe dhëmbët, ndërsa sytë u mbushën nga pluhuri i rrugës. Dy tre persona e panë gjithë këtë tmerr, pa qenë të zotët të bënin asgjë, pasi kali parakalonte me një shpejtësi të frikshme. Lëndina e fshatit po shfaqej përpara dhe kali me trupin e djalit kaluan nëpër të si në një paradë mortore. Koka tani vetëm zvarritej nëpër tokë dhe qafa ishte holluar mjaft, gati për tu këputur. Aty sipër përroit, që thirret " Brraka e xhamisë", ku sot është xhamia pesqindvjeçare e fshatit të Allajbegisë, u këput koka e djalit të sheh Murat begut. Kali u ndal për një moment dhe pastaj bëri pesëdhjetë metër më tej, në të djathtë. Gjymtyrët e djalit, këmbë dhe duar u shkëputën nga mesi, që i mbante bashkuar dhe u shkërmoqën në pjesë, si për të vërtetuar profecinë e frikshme dhe tragjike të mallkimit të sheh Murat begut.

Ashtu veproi më pas sundimtari i zonës. Aty ku ra koka(kria) e djalit u ndërtua xhamia dhe atje ku u shkëput mesi(midisi), mbolli një lis, në përkujtim të djalit. Historia tragjike ka kaluar gojë më gojë, te banorët e fshatit, nga njëri brez në tjetrin, deri në ditët tona.

printime dixhitale

DUKE FILLUAR NGA 1 KOPJE E VETME

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme

libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Si e kam njohur Moisi Murrën?

Moisi Murra u përkushtua 30 vjet për të përfunduar studimin e historisë së Dibrës dhe shumë punime e studime të tjera, duke lënë pas një trashëgimi me shumë vlerë për të gjithë trevën e Dibrës. Dibranët e mendjes dhe të pushkës e bënë historinë e Dibrës. Ai e gjurmoi, e mblodhi, e shkroi dhe e përjetësoi historinë e Dibrës.





Nga **FASLI MERA**

Për shokun tim Mois Murra! E njoha si nxënës në shkollën 7-vjeçare, Shupenzë, Shtator 1954. Moisi erdhi në klasën e 5-të, unë në të 6-tën. Pas mbarimit të shkollës takoheshim rastësisht, përshëndeteshim si të njohur. Në vitin 1961 të dyve na dhanë të drejtën për të kryer Shkollën e Bashkuar të Oficerave. Sipas njoftimit më 17 Gusht ora 08:00 u paraqita në Shupenzë. Tek mani para shtëpisë së tij takova Moisin së bashku me familjarët e tij që kishin dalë për ta përcjellë. Pas pak ndaloi një makinë ushtarake, oficeri shoqërues doli nga makina me një listë në dorë. Pasi verifikoi emrat tanë, zumë vend në makinë pranë njëri-tjetrit, e së bashku me shokut që vinin nga Peshkopia vazhduam rrugën për në Shkollën e Bashkuar. Nga ai moment unë dhe Moisi do të ishim të pandarë pranë njëri-tjetrit. Në kohën e lirë dhe në çdo rast të mundshëm bisedonim për çdo problem që kishim, shpesh dhe me humor që nuk na mungonte asnjëherë. E kuptonim dhe e respektonim shumë njëri-tjetrin qoftë dhe pa folur. E derisa vdekja do të na ndante, asnjëherë nuk u pamë shtrembër, kritikat i pranonim qoftë dhe vetëm me buzëqeshje.

Moisi ishte i zgjuar, serioz, kritik, me një humor që jo çdokush mund ta kapte. Gjatë bisedës Moisi të vlerësonte, kur nuk i pëlqente e kthente në humor. Gjatë bisedës, shpesh fliste për Dibrën, për traditat, zakonet, të veçantat me krahinat e tjera, ngjarjet që kishin lënë gjurmë, personazhet e njohura dhe gjithçka lidhej me historinë e Dibrës ishin tema e preferuar. Çdo detaj e analizonte me hollësi. Shpesh shkruante poezi, por nuk i ekspozonte, recitonte, komentonte. Më pëlqenin shumë, ishte mjeshtër i fjalës. Moisi ishte dhe mbeti deri në fund "dyshues". Ai nuk pranonte asgjë pa faktuar dhe pa referenca. Grupi mësimor (klasa e Moisit) dhe pedagogët e vlerësonin për zgjuarsinë e tij. Pasi dhamë provimet përfundimtare, me 28 Korrik 1964, pas 3 viteve stërmundimesh u titulluam Oficer me gradën Nën/Toger. Pas ceremonisë na komunikuan emërimet në detyrë. Përsëri bashkë me Moisin, në Korpusin e Burrelit K7K. Në një repart në brigadën e Burrelit. Fillimisht komandant togash në Shtabin e Brigadës. Shumë shpejt jo vetëm oficerët por edhe ushtarët e dinin që ne ishim shumë shokë sa ndonjëherë na ngatërronin emrat me njëri-tjetrin. Moisi ishte oficer i përgatitur, mjaft i kujdesshëm dhe i përkushtuar në detyrë. Lëndët kimike nuk të lejonin të gabosh, ishte autoritar dhe korrekt. Eprorët e vlerësonin për zgjuarsinë dhe korrektësinë në punë. Edhe atyre u duhej të ishin korrekt me Moisin, se nuk ishte shabllonist, i paaftë e as servil. Me vartësit, korrekt u qëndronte pranë kujdesit si prind për çdo hall të tyre. Por askush nuk mund t'ia bënte fjalën dysh, gëzonte respekt.

Me Moisin më mirë të ishe vartës sesa epror i tij. Pas 2 vitesh si oficer Moisi u përzgjodh me një grup oficerësh që shkuan në Vietnam për eksperiencë në arenën e luftës. Para se të nisej më porositi: Të mos e dijë askush se ku ndodhem. Ata u nisën si specialistë të profesioneve të ndryshme. Pas disa javësh u takova me babin e tij Feritin, ishte i shqetësuar për të birin. Nuk e dinte ku është më tha. I hodha dorën në qafë dhe me të qeshur i thashë: Moisi është mirë. Pasi u kthye më tregonte për tmerret e luftës që kishte përjetuar atje. Për Moisin ishte një eksperiencë.

Në marrëdhënie me rrethin shoqëror ishte i kujdesshëm, shpesh protagonist me humorin e tij karakteristik dhe ngacmues. Ishte gjithmonë i vlerësuar. Moisi njihte mirë situatën politike në kohën që përjetonim. Pasi dilnim nga mbledhjet e format e edukimit ku propaganda ishte kryefjala, pasi veçoheshim më fliste: Jemi populli më i "lumtur".

Pas 8 vitesh bashkë jeta bëri të sajën e u ndamë. Në Shtator 1969 unë shkova për studime në Akademi për ndërlidhje. Sapo u ktheva në Burrel, 1971 shkoi Moisi në Akademi dhe pas përfundimit u transferua në Peshkopi. Gjatë kësaj kohe takoheshim sipas mundësive që na krijoheshin, në mbledhjet e përbashkëta ose me pushime. U bashkuam përsëri pas 10 vitesh. Më 1983 u transferova në Peshkopi. Tani Moisi merrej me historinë. Më fliste me pasion për punime të ndryshme që kishte në dorë, për mospërputhje mendimesh që kishte me studiues të tjerë. Ai ishte këmbëngulës, nuk e quante të përfunduar një punim që nuk kishte referenca, krahasimi i të dhënave (fakteve) është si bilanci i llogarisë që duhet të kuadroj, thoshte Moisi. Tregonte raste që nuk i dokumentonte pasi kishin vetëm një burim informacioni.

Në vitin 1992 u liruam nga Ushtria, dolëm në reformë. Moisi iu përkushtua plotësisht punës si historian së bashku me Shoqatën e Historianëve të Dibrës. E thelloi punën në gjurmimin e objekteve që përmbanin të dhëna historike të trevës së Dibrës. Studiuesi Adem Bunguri tregonte për punën dhe këmbënguljen e Moisit, që nëpërmjet objekteve të arkeologjisë të zbulonte të dhënat e historisë. Ndërsa njeri nga dibranët e Dibrës së Madhe Jakup Markja shprehet: Nga Dibra, në Rekë, Gostivar, Tetovë e deri në Strugë, nuk kemi lënë kala e vend që ka gjurmë të historisë pa shkelur me këmbë me historianin Mois Murra.

Krahas punës për historinë e Dibrës Moisi më fliste për figurat e njohura që kanë lënë gjurmë në historinë e Dibrës. Kishte studiuar e shkruajti libra për disa prej tyre, duke pasqyruar me realizëm veten dhe veprën e tyre për kohën që jetuan e u aktivizuan në veprimtarinë patriotike. Por nuk shkruajti për ata figura që veprimtarinë e tyre e patën të dyshimtë. Aftësitë e tij dhe puna e palodhur e vendosën Moisin në krye të Shoqatës së Historianëve të Dibrës.

Meritë të madhe në arritjen e Moisit si historian ka bashkëshortja, Xhari. Një grua e urtë, e mençur dhe shumë e përkushtuar. Moisi me Xharin u martuan në vitin 1990. Në dasmën e Moisit isha i ftuar nderi edhe unë. Nuk ishte e lehtë të qëndroje në krah të Moisit, Xhari e njihte mirë dhe ja doli. Ajo u muar me të gjitha problemet e familjes dhe Moisin e la të merrej me historinë. Moisi me Xharin lindën dhe rritën 2 djem të bukur Eridin dhe Denisin. U bënë djem të mirë e të zotët e vetes. Vitet e fundit erdhën në Tiranë për të nisur një jetë më të mirë. Moisi me Xharin vinin shpesh pranë fëmijëve. Takoheshim e u gëzuam se mund të kalonim pleqërinë sëbashku. E atëherë kur fëmijët u rritën jeta mori kthesë. Xhari u sëmurë e pas 4 muajsh ndërroi jetë (6 Janar 2017). Moisi e përjetoi me shumë dhimbje, sa herë përmendej Xhari përlotej. Gjatë kësaj kohe Moisi u diagnostikua me një sëmundje të pashërueshme. Moisi filloi të rëndohej fizikisht, kishte vështirësi në ecje. Fillimisht ecte me vështirësi, çdo ditë ngadalësohej

Krahas punës për historinë e Dibrës Moisi më fliste për figurat e njohura që kanë lënë gjurmë në historinë e Dibrës. Kishte studiuar e shkruajti libra për disa prej tyre, duke pasqyruar me realizëm veten dhe veprën e tyre për kohën që jetuan e u aktivizuan në veprimtarinë patriotike. Aftësitë e tij dhe puna e palodhur e vendosën Moisin në krye të Shoqatës së Historianëve të Dibrës.

hapi, shkurtohej distanca e lëvizjes. Pinim kafe e lëviznim bashkë derisa u ndal fare. Për një farë kohe e nxirrnin fëmijët me makinë deri te lokali i tyre. Pastaj zuri krevatin derisa më 18 Korrik 2018 mbylli sytë. Vuajti por nuk i mungoi shërbimi i të dy fëmijëve, Eridi dhe Deni i qendruan te koka për çdo nevojë. Në kushte të vështira, shtëpi me qera vetëm 3 meshkuj në shtëpi.

Çdo ditë takoheshin bisedonim deri ditët e fundit kur u rëndua shumë dhe së bashku me fëmijët shkuan në Peshkopi por nuk zgjati shumë. Që kur erdhi në Tiranë bisedonim për librin, e kam bërë gati, më thoshte, por më duhet ta ndaj. Është mbi 1000 faqe. E ndau në 2 pjesë: pjesa e pare "Dibra nga Antikiteti ne Monarki" u fut për botim dhe u botua. Pjesa e dyte: "Dibra nga Monarkia në Demokraci" mbeti gati për botim. Promovimi i librit "Dibra nga Antikiteti në Monarki" u bë nga Shoqata e "Grykës së Vogël" por salla te Muzeu Kombëtar u mbush plot nga gjithë treva e Dibrës.

Moisi Murra u përkushtua 30 vjet për të përfunduar studimin e historisë së Dibrës dhe shumë punime e studime të tjera, duke lënë pas një trashëgimi me shumë vlerë për të gjithë trevën e Dibrës. Dibranët e mendjes dhe të pushkës e bënë historinë e Dibrës. Ai e gjurmoi, e mblodhi, e shkroi dhe e përjetësoi historinë e Dibrës. Ndihem i nderuar që për 57 vite pata shok dhe mik historianin e Dibrës MOISI MURRA

nekrologji

Një jetë që ua përkushtoi të sëmurëve

25 marsi i këtij viti erdhi tamam si një ditë pranvere, me një diell tejet të shndritshëm e me një rritje temperature. Për natyrën, vërtetë qe një ditë e bukur, por për ne dibranët që banojmë në Tiranë, e për një grup shokësh që rrinim bashkë ,erdhi si një ditë e zymtë... Në orët e para të mëngjesit të kësaj dite, ndërroi jetë, në moshën 84 vjeçare, Dr. Xhavit Miftari. Ndërroi jetë miku dhe shoku i dibranëve, kuruesi dhe shëruesi i qindra e qindra pacientëve nga semundjet infektive . Dr.Xhaviti lindi në vitin 1935 në fshatin Çerenec Diber. Fshat ky që shtrihet buzë Zallit të magjishëm e të mrekullueshëm. Lindi aty "ku gurgullima e Zallit përzihet me cicërimën e laureshave duke krijuar një melodi hyjnore e sidomos netëve të verës, ku gurgullima e freskia bashkohet e përcillet me aromën e luleve shumëngjyrëshe ".

Dr.Xhavit Miftari, u lind në një familje t137 njohur me tradita atdhetare,kulturore dhe arsimdashëse.Si të gjithe bashkëmoshatret, e tij,edhe ai u rrit me hallet dhe problemet e kohës. Ngaqë babai e la shumë të vogël, për edukimin dhe shkollimin e tij u kujdes me një përkushtim të veçantë,nëna e tij Tushja ,e cila u bë shëmbëlltyra e humanistja e doktorit të ardhshëm; i modelit ,fjalëpaktit, korrektit e të papërtuarit. Qyshse fëmijë, u dëshmua si djalë i zoti, shumë "i gjallë" e mjaft kërkues. I dhënë dhe i etur për dije..Pasioni për shkollën, bëri që ai të vazhdoi studimet e larta për mjekësi dhe në vitin 1966 mbaroi fakultetin e Mjeksisë Tiranë në specialitetin, mjek infeksionist. Për dekada të tëra e derisa sa u pensionua punoi si mjek specialist në repartin e infektivit në spitalin e Peshkopisë.

Dr.Xhaviti është ndër mjekët e "gardës " së parë të spitalit të Peshkopisë që punoi e luftoi duke evidentuar e eleminuar shumë sëmundje infektive të kohës.Në sajë të punës dhe përkushtimit për vite e vite me radhë ,ai u përkujdes për qindra pacientë,që në ato vite të hershme të fillimit të punës së tij,sëmundjet infektive ishin mjaft të përhapura. U bë shembull si mjek në të gjithë spitalin për të gjithë kolegët, për korrektësinë, humanizmin, profesionalitetin. Nuk lëndoi kurrë njeri. Doktori spikati jo vetëm si mjek infeksionist por dhe : si pedagog në formimin e kuadrit të ri infermjer,si drejtues



dhe menaxhues shumë i mirë i repartit të sëmundjeve infektive.

Dr.Xhaviti ishte shumë i afërt dhe përherë solidar me njerëz që kishin nevojë. Mirënjojen dhe respektin ja shprehnin jo vetëm qytetarët e Dibrës, por edhe më gjërë. E vlerësonin për punën vetmohuese e plot pasion në ekzaminimin, kurimin e shpëtimin e sa e sa jetëve njerëzore nga sëmundjet infektive. Doktori nderohej e respektohej edhe për papërtueshmërinë e tij,për vitytet e tij si njeri i mençur,fisnik, i urtë, i thjeshte dhe dinjitoz, i drejtë e tolerant, kërkues ndaj vetes,po aq sa dhe ndaj të tjerëve.

Për humanizmin, punën e palodhur dhe kontributin ne fushën e mjeksisë, Dr.Xhaviti është nderuar në vitin 2009 dhe 2015 nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Peshkopi, dhe ai i Bulqizës me titullin "Qytetar nderi".

Jeta e tij tashmë u shua,u nis drejt amëshimit, duke lënë në hidhërim të thellë familjen, kolegët, miqtë, të dashurit dhe pacientët e tij të shumtë .Gjithësesi, humbja e njeriut të afërt e të dashur le një boshllek të madh në komunitet, në shoqëri e sidomos në familje. Ai iku duke lënë në pikëllim bashkëshorten Shahe, djalin Menduh(Dufin) me të shoqen Zana ,vajzën Alma me bashkëshortin Visar, nipërit e mbesat Besmir,

Dr.Xhaviti ishte shumë i afërt dhe përherë solidar me njerëz që kishin nevojë. Mirënjojen dhe respektin ja shprehnin jo vetëm qytetarët e Dibrës, por edhe më gjërë. E vlerësonin për punën vetmohuese e plot pasion në ekzaminimin, kurimin e shpëtimin e sa e sa jetëve njerëzore nga sëmundjet infektive. Doktori nderohej e respektohej edhe për papërtueshmërinë e tij, për vitytet e tij si njeri i mençur, fisnik, i urtë, i thjeshtë...

Ada, Sami e Jara. Doktorit ju bë një përkujdesje dhe shërbim i jashtëzakonshëm, nga e bija Alma e veçanërisht nga e reja Zana .

Dr.Xhaviti,do ti mungojë, jo vetëm familjes por edhe ish kolegëve mjekë, pacientëve të shumtë që i kuroi ndër vite , e sidomos ne , shokëve. Në këto ditë, ne miqtë e shokët e tij ndjejmë dhimbje e trishtim pasi në takimet e bisedat e përditëshme nuk do ta kemi më doktorin midis nesh . Dr.Xhaviti na la, por ai do të jetojë përherë në zemrat e të gjithë atyre që e njohën! Familja e të ndjerit është krenare për jetën dhe punën e përkushtuar të mjekut humanist. Sa shumë njerëz e deshën dhe e respektuan nga të gjitha anët e Dibrës e vendit.. Respekt e mallë që u dëshmua me rastin e ngushëllimeve dhe në ditën e varrimit .

Ndaj ,Doktor Xhaviti do të nderohet e kujtohet në breza,për kontributin dhe ndihmesën që ka dhënë në fushën e mjekësisë .

Të pastë dritë shpirti miku ynë Xhevit .

Respekt jetës ,përkushtimit, punës,dhe veprës humane të Dr.Xhavit Miftarit.!

I paharrar kujtimi për Ju!

Dr.Huzrie Kalia, Dr.Met Kodra, Rakip Dançe, Rustem Deva, Zabit Lleshi , Nehat Daci , Musa Riçku, Gani Çajka, Shaqir Skarra.

Elegji për një mik, Asllanin e Kambereve të Zimurit



Ibiri, Majvjeni, mesnatën duke u gdhirë 22 marsi 2019, më mori në telefon...

I dridhej zëri...

I mbahej fryma...

I derdhej loti nga liqeni njerëzor që shpërthen kur vjen e vozit dhimbja...

- Babai ndërroi jetë... Varrimi bëhet nesër në orën 3 pasdite...

Ma vrau gjumin...

Mbi mblodhi truc kujtimet...

Nisa ti shfletoj si një libër...

Ishte dhëndëri i parë i babait tim Hajredin Ashiku...

Martuar me Shamen, motrën time të madhe...

Ishte biri i Fari Kamberit, rrënjë e Kambereve të Zimurit...

Ishte babai i nipit tim të parë, Majvjenit lindur në maj prej nga daja i madh i dha emrin.

Ishte babai i dy mbesave të mija të bukura, Enkeledës dhe Arjolës.

Ishte gjysh i nipërve dhe mbesave nga djali dhe vajzat...

Familje e plotë...

E qetë, e bukur, në harmoni me të gjithë...

E takova në fundgusht, fundverë...

Sëmundja e rëndë e kishte lodhë...

Shpirtin e kishte plot...

Mbushur nga djali...

Mbushur nga vajzat...

Mbushur nga nipërit dhe mbesat që i vareshin përqafe si gjerdanë margaritarësh...

Nuk e mendova se do të ikte...

Nuk do të arrij ti hedh një grusht dheu të freskët.

Mërgimi na largoi, na e thau lotin, na e ndali hapin...

Kërkova një fotografi nga arkivi im...

Shkëputa një fiksuar në ditën kur fejoi vajzën e vogël...

Eh mik!

Lamtumirë!

Abdurahim Ashiku

Athinë, 22 mars 2019





www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose pwrmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

Visit Diber

Nëse nuk e ke vizituar ende Dibrën, nuk e ke parë ende Shqipërinë!

Turi i qytetit të Peshkopisë

Peshkopia është kryeqendra e Bashkisë së Dibrës, që ka 141 fshatra dhe e Qarkut Dibër, që ka në përbërje dhe 3 bashki të tjera: Matin, Bulqizën dhe Klosin. Mendohet që emri i Peshkopisë lidhet me ekzistencën e "Episkopatës së Stefanikës", që në vitin 1020. Emri Episkopatë = Peskopatë = Peshkopate = Peshkopajë = Peshk'pajë. Peshkopia ka qenë qendër dytësore për krahinën e Dibrës, pas qytetit të Dibrës së Madhe, e cila ka qenë qendër e njohur tregtare dhe e artizanatit në të kaluarën dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në historinë e gjithë rajonit. Roli i kësaj pozite zbehet me vendosjen e kufijve arbitrarë në 1913, ku jashtë kufijve mbeti Dibra e Madhe, që ishte qendra urbane dhe tregtare për kohën. Pas 1913 Peshkopia u bë qendër e Dibrës, ku u vendos administrata, u ngrit pazari dhe disa dyqane të zejeve të ndryshme. Në korrik 1920 u krijua administrata vendore në rang prefekture dhe bashkie. Po në vitin 1920 filloi shërbimi postar, u vendos linja telefonike dhe u ndërtuan gazermat ushtarake. Pas 1945 Peshkopia është qendra administrative e rrethit të Dibrës dhe u ndërtua si një qytet shumëfunksional si në aspektin administrativ, social, kulturor, arsimor, ashtu edhe në atë ekonomik, sipas modelit socialist të kohës.

Turi në qytetin e Peshkopisë njeh vizitorët me historinë, kulturën e trashëgimninë e qytetit, duke filluar me lagjen e vjetër, rrethinat e qytetit, muzeun, shëtitoren, pjesën urbane, administrative dhe sociale të tij.

"Shijo natyrën, historinë dhe ushqimin në qytetin e Peshkopisë

8:30 Eksperiencë në qytetin e vjetër të Peshkopisë.

Vizitorët nën drejtimin e guidës njihen me lagjen Pazar, teqen e Peshkopisë dhe historinë e vjetër. Teqeja e Peshkopisë, përveç shërbimeve të karakterit fetar, kryente edhe shërbime të asistencës mjekësore për gjithë banorët. Njerëzit e shkolluar në Stamboll, falë njohurive që kishin marrë dhe duke shfrytëzuar vetitë kuruese të ujërave termale, ndihmonin banorët në trajtimin e sëmundjeve si reumatizma, parazitoza etj. Vizitorët mund të shikojnë dyqane artizanale dhe punime me dorë në pazar. Ngjitja për në rrugicat e lagjes së vjetër si dhe ndalesë te shtëpia e Lavdërim Shehut, e cila shërbeu si zyra për Bashkinë e parë të qytetit (1920) dhe ngjitur me të është godina e Bashkisë ekzistuese.

Turi 1

9:30 Vizitë në lagjen e vjetër dhe ujërat termale të Peshkopisë.

Vizitorët me ecje kalojnë në rrugët me kalldrëm të lagjes së vjetër, anash së cilës kanë qenë shtëpi të shumë banorëve që erdhën nga Dibra e Madhe, kryesisht tregtarë dhe zejtarë. Shikohen ndërtime karakteristike, sokaku në Dublec bashkë me çezmën e ujit, shtëpia karakteristike e Sul Shehut, kryetarit të parë të bashkisë apo themeluesi I Peshkopisë moderne në kohën e Zogut.

11:00 Pikë vrojtuese e luginës së Shërimit.

Nga pika vrojtuese, sipër ish-HEC të Peshkpisë, ke mundësinë e vështrimit të Luginës së Shërimit, malin e Skërtecit, bjeshkën e Rabdishtit, malin e Zimurit, të cilat janë pjesë e parkut natyror Korab-Korritnik. Përballë është Boroviku i Begjunecit, një nga 41 monumentet natyrore të Dibrës. Vizitorët njihen edhe me Livadhet e Peshkut në Staravec, ku mendohet se kanë qenë qendrat kishtare, nga të cilat ka marë emrin dhe Peshkopia. Ujërat termale më parë menaxhoheshin nga kishat, të cilat siguronin të ardhura nga shfrytëzimi i tyre.

12:00 Vizitë në qendrën balneare të Llixhave të Peshkopisë.

Në kompleksin balnear të Llixhave të Peshkopisë vizitori njihet me historikun e kësaj qendre, shërbimet dhe trajtimet që kryhen. Mund të vizitohen vaskat me ujërat termale dhe burimi i ujërave të termale. Nga qendra informuese turistike tregohet edhe "gradishta e Begjunecit", me rrënoja historike.

12:30 Ndalesë tek mulliri i ujit të Saraçëve

Shikohet stili i veçantë i ndërtimit dhe puna që bëhet në mullirin e ujit. Në të njëjtën kohë mund të shikohen burimet e ujit të ftohtë, që gjithashtu përdoren për arsye kuruese.

13:00 Dreka mund të konsumohet te lokalet në lagjen Llixha ose restorantet e qytetit.

SHIJO DHE EKSPLORO ME ECJE QYTETIN E PESHKOPISË

KOHËZGJATJA:	1 DITORE (mund të jetë edhe dy ditore)
GJATËSIA E SHTEGUT:	4 KM ECJE NË DITË
VËSHTIRËSIA:	NIVELI I LEHTË











Turi 2

9:30 Vizitë në rrënojat e Gradishtës

Nga pjesa e Pazarit grupi i vizitorëve merr ngjitjen për në lagjen Dobrovë, një nga lagjet e qytetit me drejtim bujqësor. Në këtë lagje ndodhet Hoteli i Llixhave për pushuesit në kompleksin balnearë. Pas hotelit të Llixhave, në kodrën ngjitur janë rrënojat e Gradishtës së Peshkopisë, ku gjetjet arkeologjike tregojnë për një vendbanime të hershëme. Mendohet se edhe në zonën përreth ka pasur rrënoja të kishave të Shqefnit, fis I cili është akoma në Peshkopi. Nga Gradishta, është pamja shumë e bukur e Luginës së Shërimit, aty ku është kompleksi balnerarë I ujërave termale të Llixhave. Ngjitur është Boroviku I Begjunecit një nga 41 monumentet e natyrës në Dibër.

10:30 Vizitë parkun agro-bujqësor të Begjunecit.

Vizitë në parkun agro-bujqësor të Begjenucit kalon nëpërmjet fshatit i cili shquhet për prodhimet bujqësore, perimet, kodrat me pemë frutore. Ngjitja vazhdon deri në liqenin e Kuplanit, ku pamja e Luginës së Drinit të Zi dhe Peshkopisë është mahnitëse. Udhëtimi zgjat 2.5 orë dhe kthimi në këmbë deri në qytet zgjat 60 minuta.

13:00 Dreka tek agro-turizëm Dashe Zerja, restorant "Zerja" ose te restorant "Eiba".

14:30 Turi i qytetit dhe muzeut të Peshkopisë

Turi fillon tek godina e Bashkisë. Pastaj vazhdohet në bulevardin kryesor të qytetit, me ish-godinën e bashkisë, një objekt i vjetër karakteristik, me godinën e Prefekturës dhe institucineve të tjera si qendër e Qarkut të Dibrës. Shëtitja në bulevardin kryesor ose Bulevardi i Blineve, i cili është i famshëm për xhiron historitë e dashurisë, paradës së modës në vitet e socializmit.

Më pas vazhdon me bustin e Elez Isufit (Arusha e maleve), një nga luftëtarët dibranë, ikonë e luftës dhe qëndresës kundër serbit. Një vizitë tek Zyra e Informacionit Turistik, ku mund të njihen me atraksionet turistike të Dibrës dhe të blejnë ndonjë suvenir. Më pas një vizitë te Pallati i Kulturës "Haki Stërmilli", ku mbahen koncerte të ndryshme foklorike, si dhe festivali "Oda Dibrane", me pjesëmarje nga gjithë trevat shqiptare. Ky pallat mban emrin e shkrimtarit dibran Haki Stërmilli, i cili është romancieri i parë shqiptar, me romanin "Sikur të isha djalë". Haki Stërmilli ka qenë Kryetari i parë i Qarkut Dibër pas Luftës së Dytë botërore. Me kujdesin e tij, duke shfrytëzuar tullat e gazermave ushtarake, ndërtoi godinën e ish- Komitetit Ekzekutiv në fund të bulevardit.

Ndalesë te shëtitorja e Skënderbeut, i cili këtu është në këmbë dhe pa përkrenare. Kjo lidhet me vendorigjinën e tij, si bir i Dibrës. Një ndalesë para godinës së Gjimnazit, ku çeli dyert një ndër shkollat e para Pedagogjike në Shqipëri, e cila përgatiti mësues për gjithë Veriun e Shqipërisë. Përballë kësaj godine ndodhen bustet e dy prej figurave historike dibrane: Dom Nikoll Kaçorri dhe Haxhi Vehbi Dibra. Qëndrimi i tyre krah për krah dëshmon edhe njëherë për tolerancën fetare që e ka shoqëruar gjithnjë këtë komunitet. Raste të bashkëjetesës së komuniteteve të ndryshme fetare ka plot, që nga Kërçishti e deri në Lurë. Më pas një vizitë te Muzeu Historik i Dibrës. Në këtë muze ndodhet pavioni arkeologjik, etnografik dhe ai historik.

16:00 Kafe ose birë në një nga baret e shëtitores.

16:30 Vizitë në lagjet e qytetit;

Viztorët njihen me ndërtimet karakteristike të qyteteve në kohën e komunizmit, dhe organizimin social dh e shoqëror. Vizitojnë një qendër të fortifikuar, dhe deri tek stadium I qytetit.

17:00 Akomodimi

Sugjerohen:

BUJTINA "KONAKU"
0692053492 hsalkurti@gmail.com

AGRO-TURIZËM DASHE ZERJA
0699377337 fabianzerja@gmail.com

HOSTE "HYSEN UKA"
0673625835 udhetomegresin@gmail.com

KAMPINGU "KAPXHIU, PESHKOPI"
069-2258182 campingpeshkopi@gmail.com

HOTELET E QYTETIT. Adresat i gjeni tek www.visitdiber.al
Rekomandohen larmi darkash si në restorante dhe darka familjare si në shtëpi të përgatitura nga shtëpitë pritëse.

Ky projet u mbështet nga D2T "Dibra: Turizëm dhe traditë"

cyan magenta yelloë black